



Funded by
the European Union

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË



**NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19
NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR
NË KOSOVË**

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

Ky raport është hartuar nga:

Selim Mehmeti

Qershor 2021, Prishtinë

Publikuar nga programi një-vjeçar “Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021”

Për më shumë informata, vizitoni: www.kec-ks.org

Design: *envinion*:



**Funded by
the European Union**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar “Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021”, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE.....	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
1. HYRJE.....	7
2. QËLLIMI I STUDIMIT.....	9
3. METODOLOGJIA E STUDIMIT.....	10
4. ORGANIZIMI I MËSIMIT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR GJATË PANDEMISË COVID-19	12
4.1. Masat e ndërmarra për realizimin e mësimit në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë, në periudhën mars – gusht 2020	12
4.2. Planifikimi dhe përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie - viti shkollor 2020-2021.....	16
4.3. Koordinimi i institucioneve arsimore në organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë.....	25
5. KTHIMI NË SHKOLLË DHE ZBATIMI I KURRIKULËS NË RRETHANAT E ORGANIZIMIT TË MËSIMIT GJATË PANDEMISË	29
5.1. Organizimi dhe menaxhimi i mësimit në kushtet e pandemisë - kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimit sipas tre skenarëve.....	29
5.2. Mësimi dhe platformat mësimore të përdorura nga shkollat.....	35
5.3. Realizimi i kurrikulës në kohë pandemie dhe humbjet mësimore	38
6. PËRFSHIRJA NË MËSIM E FËMIJËVE/NXËNËSVE NGA GRUPET E CENUESHME GJATË PANDEMISË	47
7. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE GJATË PANDEMISË	51
8. MËSIMI NË KUSHTE PANDEMIE DHE ROLI I PRINDËRVE.....	55
9. MONITORIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE RAPORTIMI GJATË PANDEMISË	59
10. SFIDAT NË PËRBALLJE ME PANDEMINË DHE MUNDËSITË PËR ADRESIMIN E TYRE.....	62
11. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	67
11.1. Përfundimet.....	67
11.2. Rekomandimet	74
12. REFERENCAT	76
SHTOJCA 1: Lista e zyrtarëve arsimor, partnerëve dhe njohësve të arsimit të intervistuar	79
SHTOJCA 2: Lista e mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave pjesëmarrës në fokus grupe dhe intervista me shkrim.....	81

Lista e shkurtesave

AP	Aktivet/Departamentet Profesionale
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
COVID 19	CO (Coronavirus), VI (Viral), D (Disease)
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KKAP	Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PISA	Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Nxënësve
PSAK	Planin Strategjik i Arsimit në Kosovë
RNF	Rezultatet e të nxënit të fushë kurrikulare
RNL	Rezultatet e të nxënit të lëndës/temës mësimore
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
UA	Udhëzim Administrativ
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Përmbledhje ekzekutive

Pandemia globale e njohur si COVID-19, që nga fillimi i vitit 2020 ka sfiduar shoqëritë dhe sistemet arsimore kudo, ndërsa efektet e saj ende nuk dihen plotësisht. Në fillimet e saj, pothuajse të gjitha sistemet arsimore ndërmorën masa për mbylljen e shkollave me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit dhe ruajtjes së shëndetit të qytetarëve. Në përgjigje të rrethanave të krijuara, kështu veproi edhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila në bashkëpunim me drejtoritë komunale për arsim, partnerët ndërkombëtarë që mbështesin arsimin, organizatat jo-qeveritare dhe industrinë e teknologjisë informative, arriti të organizojë mësimin në distancë në kushtet e pandemisë dhe të përmbyllë vitin shkollor 2019-2020.

Mungesa e përvojës në menaxhimin e arsimit në rrethana të tilla, mungesa e platformës mësimore digjitale dhe materialeve mësimore digjitale të zhvilluara në mënyrë institucionale, por edhe e kompetencës digjitale në mesin e komunitetit arsimor, ishin disa nga sfidat me të cilat u përball menaxhimi i arsimit parauniversitar në Kosovë gjatë përmbushjes së qëllimeve të tij.

Situata pandemike me Covid-19, prezente dhe e paparashikueshme edhe në fazën e përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, detyroi sërish sistemet arsimore që të gjejnë modalitete të ndryshme të organizimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Po kështu u veprua edhe nga autoritetet arsimore në Kosovë, ku u vendos që organizimi i procesit mësimor të realizohet sipas tre skenarëve: Skenari A – mësimi në shkollë; Skenari B – mësim i kombinuar (në shkollë dhe në distancë/online) dhe skenari C – mësim në distancë/online. Organizimi i mësimin në kushtet e pandemisë është përcjellë me diskutime dhe debate të shumta, të cilat shërbyen si pikënisje për realizimin e këtij studimi.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë sfidat me të cilat përballet aktualisht arsimit parauniversitar në Kosovë për shkak të ndikimit nga pandemia Covid-19, të përshkruajë kuadrin e masave/politikave të zhvilluara gjatë kësaj periudhe dhe mundësitë për përgjigje më efektive drejt rrethanave të reja të krijuara në arsimin parauniversitar.

Studimi është realizuar përmes qasjes hulumtuese cilësore, e cila përfshiu një analizë gjithëpërfshirëse të kuadrit të masave/ politikave arsimore për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe raporteve për këtë periudhë të organizimit të mësimit, si dhe intervista gjysmë të strukturuar dhe fokus grupe të realizuara me përfaqësues të komunitetit arsimor që lidhen me arsimin parauniversitar. Përmes kësaj qasjeje hulumtuese është vlerësuar mbulueshmëria e kuadrit të masave dhe veprimeve për:

- aspektet e organizimit të mësimit në kushtet e pandemisë,
- kthimin në shkollë dhe zbatimin e kurrikulës në rrethanat e organizimit të mësimit gjatë pandemisë;
- përfshirjen e fëmijëve nga grupet e cenueshme në arsimin parauniversitar;
- zhvillimin profesional të mësimeve gjatë pandemisë;
- mësimin në kushte pandemie dhe rolin e prindërve;
- monitorimin e arsimit parauniversitar dhe raportimin gjatë pandemisë;
- sfidat në përballje me pandeminë, si dhe mundësitë që duhet shfrytëzuar në përgjigje më të mirë rrethanave të krijuara nga COVID 19.

Përkundër reagimit të shpejtë të institucioneve arsimore ndaj fazës së parë të pandemisë (mars-qershor 2020), përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021 dhe kthimin në shkollë përshtatën me angazhim institucional të pamjaftueshëm për reagim dhe vendimmarrje të duhur në rrethanat e krijuara, të cilat u reflektuan në shtyrjen e fillimit të vitit të ri shkollor. Megjithatë u arrit që edhe në këto kushte të zhvillohen plane dhe udhëzues për fillimin e vitit të ri shkollor, të vazhdohet me eMësimin, si dhe të realizohet kthimi në shkollë si arritje e madhe e mbështetur nga komuniteti i mësimeve, prindërve dhe nxënësve. Me kthimin në shkollë, mësimi u organizua sipas tre skenarëve të mësimit të miratuar nga MASHTI në bashkëpunim me IKSHP.

Në përgjithësi, kriza epidemiologjike nga Covid-19 nxori në pah **sfida dhe probleme** të shumta në sistemin arsimor në Kosovë, me të cilat sistemi vazhdoi të përballej gjatë pandemisë. Sfidat më të mëdha me të cilat është përballur arsimi parauniversitar gjatë pandemisë janë niveli i përgatitjes së sistemit dhe shoqërisë për ballafaqim me situata të jashtëzakonshme siç është pandemia, organizimi i mësimit në kushte pandemie, menaxhimi i situatës me personel gjatë pandemisë, cilësia e mësimeve, puna me orar mësimor të reduktuar në kohëzgjatje prej 25-30 minuta, ndarja e nxënësve në dy grupe, ngarkesa e mësimeve, cilësia e punës së mësimeve me grupet e dyta të së njëjtës klasë, puna e mësimeve me nxënës në skenarët e mësimit B dhe C, etj.

Sfida të tjera më të cilat është përballur arsimi parauniversitar gjatë pandemisë janë edhe mungesa e një mekanizmi institucional qendror që merret me digjitalizimin e arsimit, përshtatja e mjediseve të të nxënësve në kushtet e pandemisë në funksion të zhvillimit të kompetencave, përgjigjja në kohë dhe në mënyrën e duhur ndaj humbjeve mësimore, nevojave dhe kërkesave të grupeve të marginalizuara me masa mbështetëse për të siguruar qasje dhe përfshirje aktive në procesin e të nxënësve, mungesa e një sistemi mbështetës për prindër, shërbime të pamjaftueshme psikologjike në shkollë, mungesa e një kornize të monitorimit të institucioneve arsimore për procesin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe raportimit përmes të cilit do të mund të raportohej me indikatorë matës, etj.

Kapacitetet e pamjaftueshme për monitorimin e procesit mësimor në kohë pandemie, vendosja e fokusit kryesor të të gjithë mekanizmave mbështetës në aspektet logjistike dhe organizative, largimi i fokusit nga përmbajtja e


procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësia e mësimimit në kushtet e pandemisë ishin sfida të tjera që karakterizuan arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë.

Në anën tjetër, kriza epidemiologjike nga Covid-19 nxori në pah disa **mundësi** të cilat duhen shfrytëzuar për reagim më të mirë ndaj rrethanave të krijuara nga Covid-19, si dhe për të vendosur kuadrin e orientimeve dhe fokusin e reformës në të ardhmen, me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsimin parauniversitar.

Përvojat nga organizimi i mësimimit në kushtet e pandemisë, veçanërisht nga organizimi i mësimimit në distancë, përveç sfidave, përbëjnë një mundësi të mirë për të kuptuar rëndësinë dhe përparësinë e shfrytëzimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe për të ndërmarrë masa konkrete drejt ndërtimit dhe përfshirjes së mësimimit online në sistemin arsimor të Kosovës.

Vetë mësimet e dala nga kjo përvojë e organizimit të sistemit arsimor në reagim ndaj rrethanave të krijuara janë mundësi e mirë për të mësuar më shumë për përparësitë e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, për modalitetet e mësimimit në distancë dhe për ndërmarrjen e masave konkrete në ndërtimin dhe integrimin e mësimimit online në sistemin arsimor të Kosovës. Përvoja me pandeminë krijoi mundësi për të vendosur kuadrin e orientimeve dhe fokusit të reformës në të ardhmen, me qëllim ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Studimi ofron **rekomandime** të cilat ndërlidhen me aspekte të veçanta të plotësimit të kuadrit ligjor dhe të masave me qëllim të adresimit të sfidave dhe problemeve të shpërfaqura gjatë mësimimit në kushtet e pandemisë, përfshirë: rishikimin dhe përmirësimin e mekanizmave të këshillimit dhe mbështetjes së shkollave, fokusin në zhvillimin e kompetencave digjitale, identifikimin dhe adresimin e humbjeve mësimore, duke marrë për bazë edhe mjedisin e të nxënësve, përmirësimin e financimit në arsimin parauniversitar, bashkërendimin e masave dhe veprimeve në situata të rrethana të jashtëzakonshme dhe në proceset zhvillimore në arsim, përmirësimin dhe avancimin e sistemit për menaxhimin e informatave etj. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet e dala nga studimi tregojnë se sistemi ka nevojë për më shumë përgjegjësi dhe llogaridhënie, si dhe për bashkim të sinergjive për të përmirësuar cilësinë e arsimit parauniversitar.



Sfidat më të mëdha me të cilat është përballur arsimi parauniversitar gjatë pandemisë janë niveli i përgatitjes së sistemit dhe shoqërisë për ballafaqim me situata të jashtëzakonshme siç është pandemia, organizimi i mësimimit në kushte pandemie, menaxhimi i situatës me personel gjatë pandemisë, cilësia e mësimdhënies, puna me orar mësimor të reduktuar në kohëzgjatje prej **25-30 minuta**, ndarja e nxënësve në dy grupe, ngarkesa e mësimdhënësve, cilësia e punës së mësimdhënësve me grupet e dyta të së njëjtës klasë, puna e mësimdhënësve me nxënës në skenarët e mësimimit B dhe C, etj.

1. HYRJE

Në fillim të muajit mars 2020, në përgjigje të rrethanave të imponuara nga pandemia Covid-19, pjesa më e madhe e sistemeve arsimore nga vendet e rajonit, BE dhe vendet tjera të botës ndërprejnë mësimin në shkolla dhe në institucione të tjera arsimore. Në këto rrethana, edhe në Kosovë, nga data 12 mars 2020, në bazë të vendimeve dhe udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është ndërprerë mësimi nëpër shkolla dhe institucione të arsimit të lartë¹. Krahas ndërprerjes së mësimin, filluan përgatitjet për organizimin e mësimin në distancë, zhvillimin e dokumenteve dhe udhëzuesve mbështetës për realizimin e mësimin në distancë në kushtet e pandemisë globale.

Kështu, bazuar në udhëzimet e hartuara nga MASHTI gjatë marsit 2020, në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia, filloi mësimi në distancë në arsimin parauniversitar për klasat 1-9, i cili në periudhën mars-qershor 2020 është realizuar nëpërmjet transmetimit të mësimin të regjistruara në televizionin publik (RTK), përmes kanalit të MASHTI në Youtube, si dhe përmes mësimin të organizuar me aplikacione të ndryshme (Zoom, Viber, E-mail, Google Classroom, Skype) nga mësimdhënësit e klasave dhe lëndëve mësimore përkatëse, ku theksi kryesor është vënë në detyrat e dala nga mësimi përmes televizionit publik dhe informatat kthyes lidhur me detyrat. Ndërsa në nivel të shkollave të mesme të larta mësimi në distancë është zhvilluar në mënyrë të decentralizuar – në nivel shkolle, ku mësimdhënësit ishin bartësit kryesor të mësimin në distancë.

Referuar rrethanave të krijuara nga pandemia, në të gjitha udhëzimet e zhvilluara nga MASHTI për vazhdimin e mësimin dhe përfundimin e vitit shkollor 2019-2020, është potencuar se qëllimi primar i mësimin në distancë dhe i vlerësimit është mirëqenia e fëmijëve dhe nxitja e të nxënësve. Kjo bëri që të pranohet niveli i arritshmërisë së nxënësve deri më 11 mars 2020 dhe e gjithë puna me fëmijë/nxënës të fokusohet në mirëqenien e tyre dhe nxitjen e të nxënësve për arritshmëri më të lartë në mësim. Masa të tilla ishin vendosur nga shumica e sistemeve arsimore².

Krahas përfundimit të vitit shkollor 2019-2020, filluan edhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, përmes skenarëve të ndryshëm, pasi që aplikoheshin masa të ndryshme të izolimit, varësisht nga niveli i përhapjes së pandemisë. Në përgjigje të masave për parandalimin e pandemisë, sistemet arsimore në vende të ndryshme kanë planifikuar disa skenarë për zhvillimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021, me përparësi rihapjen e shkollave, por në varësi të përhapjes së virusit dhe të specifikave të shkollave edhe mësim në distancë ose kombinim i të dyja formave: mësim në shkollë dhe mësim në distancë³.

1 Qeveria e Republikës së Kosovës (11 mars 2020). Vendim për ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Republik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

2 Instituti Pedagogjik i Kosovës (2020). Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19. IPK, Prishtinë.

3 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) e Shqipërisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) (2020). Udhëzues në ndihmë të drejtuesve, mësuesve, prindërve dhe nxënësve të institucioneve arsimore parauniversitare mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021. https://www.academia.edu/43963044/Udhëzuesi_per_fillimin_e_vitit_shkollor_2020_2021



Pandemia Covid-19 pritet të ketë ndikim domethënës, afatshkurtër dhe afatmesëm në të gjitha fushat e jetës dhe në sektorët përkatës, përfshirë edhe sektorin e arsimit, me theks të veçantë në arsimin parauniversitar. Mbyllja e shkollave nuk ka penguar vetëm realizimin normal të procesit mësimor, por edhe mbështetjen për mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve, ndërkohë që ka shkaktuar edhe rritjen e pabarazive në mësim.

Edhe në Kosovë, organizimi i mësimin për vitin shkollor 2020-2021 filloi sipas tre skenarëve (A⁴ dhe B⁵ dhe C⁶) me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimit të procesit edukativo arsimor sipas Kornizës së Kurrikulës të Kosovës (KKK), kurrikulave bërthamë për tri nivelet e arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë Covid-19 në Republikën e Kosovës⁷ (MASH, 2021a).

Pandemia Covid-19 pritet të ketë ndikim domethënës, afatshkurtër dhe afatmesëm në të gjitha fushat e jetës dhe në sektorët përkatës, përfshirë edhe sektorin e arsimit, me theks të veçantë në arsimin parauniversitar. Mbyllja e shkollave nuk ka penguar vetëm realizimin normal të procesit mësimor, por edhe mbështetjen për mirëqenien psiko-emocionale të nxënësve, ndërkohë që ka shkaktuar edhe rritjen e pabarazive në mësim⁸. Prandaj, është e rëndësishme që të bëhen analiza gjithëpërfshirëse për ndikimin e Covid-19 në arsim, në mënyrë të veçantë në arsimin parauniversitar.

Nga sa u tha më sipër, ky studim dhe ky raport analitik për Ndikimin e Covid-19 në Arsimin Parauniversitar në Kosovë synon të identifikojë dhe pasqyrojë sfidat me të cilat përballet aktualisht arsimit parauniversitar në Kosovë për shkak të pandemisë Covid-19 si dhe masat/politikat e zhvilluara gjatë kësaj periudhe në përgjigje të rrethanave të krijuara nga pandemia. Gjithashtu, ky raport synon t'i kontribuojë sqarimit të arritjeve dhe identifikimit të mundësive kryesore për përgjigje rrethanave të krijuara dhe nevojave për të ardhmen, me qëllim që të ofrojë rekomandime për mundësitë që duhet shfrytëzuar për vazhdimin e mësimin në këto rrethana, zvogëlimin e humbjeve mësimore dhe ngritjen e cilësisë së mësimin në arsimin parauniversitar.

Nga sa u tha më sipër, ky raport nuk synon të eksplorojë vetëm gjendjen aktuale lidhur me masat dhe politikat e ndërmarra për referimin e situatës së pandemisë në arsimin parauniversitar, por synon të nxisë edhe debatin lidhur me mundësitë e ngritura për të përmirësuar dhe avancuar arsimin parauniversitar, i cili i përgjigjet në mënyrë efektive kërkesave të shoqërisë, përtej situatave emergjente.

4 Skenari A: Niveli i rrezikshmërisë i ulët. Mësimi me prezencë në institucionet parashkollore dhe shkolla - me masat parandaluese.

5 Skenari B: Niveli i rrezikshmërisë mesatar. Rikthim i pjesshëm - mësimi i kombinuar me prezencë në shkollë dhe mësim në distance.

6 Skenari C: Niveli i rrezikshmërisë i lartë. Mësimi në distancë - TV + e-mësimi.

7 Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2020). Udhëzues i përgjithshëm i MASH për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-final-file-10-09-2020.pdf>

8 UNICEF (2020). Korniza për rihapjen e shkollave. https://www.unicef.org/albania/media/2831/file/Frameørk_for_Reopening_Schools.pdf

2. QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë sfidat me të cilat përballet aktualisht arsimi parauniversitar në Kosovë për shkak të ndikimeve nga pandemia Covid-19, të përshkruaj kuadrin e masave/politikave të zhvilluara gjatë kësaj periudhe dhe mundësitë për përgjigje më efektive rrethanave të krijuara dhe ndikimeve nga pandemia.

Pyetjet hulumtuese që e kanë udhëhequr këtë studim:



- Cilat janë sfidat kryesore me të cilat është përballur arsimi parauniversitar në Kosovë gjatë pandemisë?



- Cilat janë zgjidhjet e mundshme për të adresuar sfidat dhe problemet në arsimin parauniversitar të shpërfaqura nga ndikimet e pandemisë?

Disa nga nënpyetjet që janë nxjerrë nga pyetja hulumtuese janë:

- Cilat janë masat e ndërmarra nga MASHTI në Kosovë për organizimin e mësimin në arsimin parauniversitar, në kushtet e pandemisë Covid-19? Sa janë relevante ato për përkrahjen e nxënësve? A i mbulojnë të gjitha nivelet dhe specifikat e arsimit parauniversitar?
- Cilat janë gjetjet nga analiza krahasuese e raporteve për organizimin e mësimin sipas tre skenarëve të vendosur nga MASHTI, dallimet në mundësitë e zbatimit të kurrikulës nga perspektiva e skenarëve me të cilët institucionet arsimore kanë punuar gjatë këtij viti shkollor, përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe grupeve të marginalizuara?
- Cilat ishin prioritetet dhe qasjet e aplikuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve në Kosovë gjatë pandemisë?
- Cilat ishin qasjet e aplikuara për monitorimin dhe raportimin e punës së institucioneve arsimore parauniversitare gjatë pandemisë?
- Cilat janë sfidat kryesore me të cilat është përballuar arsimi parauniversitar në Kosovë gjatë e pandemisë? Cilat janë zgjidhjet e mundshme për të adresuar sfidat dhe problemet në arsimin parauniversitar të shpërfaqura nga ndikimet e pandemisë?

3. METODOLOGJIA E STUDIMIT

Ky studim shfrytëzon një qasje hulumtuese cilësore. Studimi është i bazuar në modelin vlerësues zhvillimor, i cili është i bazuar në parimet se vlerësimi është i vazhdueshëm dhe se rezultatet tregohen për të gjitha palët e interesit⁹, në mënyrë që rezultatet e studimit të merren në konsideratë gjatë adresimit të sfidave dhe ngritjes së qëndrueshme të Arsimit Parauniversitar pas Pandemisë Covid-19.

NË KËTË STUDIM, ME ANË TË DESK RESEARCH, APO STUDIMIT KABINETIK, ËSHTË BËRË NJË ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE E KUADRIT TË MASAVE/POLITIKAVE ARSIMORE TË NDËRMARRA NGA MASHTI NË KOSOVË PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19 DHE TË RAPORTEVE E STUDIMEVE NË KËTË FUSHË, PËRFSHIRË:

- Kuadrin ligjor, dokumentet dhe udhëzuesit për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë, të publikuara nga MASHTI në platformën e-mësimi <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>;
- Raportet dhe informatat zyrtare të lidhura me mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë, në kushtet e pandemisë, të publikuara nga MASHTI në linkun zyrtar për publikimet <https://masht.rks-gov.net/publikimet>;
- Vendime lidhur me mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë, në kushtet e pandemisë, të publikuara nga MASHTI në linkun zyrtar për vendimet e ministrit <https://masht.rks-gov.net/vendimet-e-ministrit>; si dhe
- Raporte dhe dokumente të tjera që lidhen me mësimin në distancë, kthimin në shkollë në kushtet e pandemisë, etj.



⁹ Manninen, J. (2014). Evaluation report: Qualitative stakeholder evaluation of the first year of implementation of new Kosovo curriculum. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë.

Analiza dhe shqyrtimi i kuadrit të masave/ politikave arsimore për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe raporteve në këtë fushë, është plotësuar me realizimin me shkrim dhe me gojë të 21 intervistave gjysmë të strukturuar të realizuara me përfaqësues të komunitetit arsimor që lidhen me zhvillimet në arsimin parauniversitar, dhe me përfshirje të 15 mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave në dy diskutime me fokus grupe. Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia intervistat kryesisht janë realizuar me shkrim. Ndërsa, fokus grupet janë mbajtur online, përmes platformës ZOOM, në kohëzgjatje prej dy orëve. Të gjitha diskutimet janë incizuar dhe pastaj janë transkriptuar në dy raporte të ndara nga diskutimet me fokus grupe.

Protokollet për intervista gjysmë të strukturuar dhe për diskutim në fokus grupe kanë përmbajtur pyetje dhe nën-pyetje të ndërlidhura me pyetjet që e udhëheqin këtë studim. Pyetjet janë fokusuar në kuadrin e masave të ndërmarra gjatë pandemisë, zhvillimeve dhe proceseve në arsimin parauniversitar, pastaj në aspektin organizativ të vitit shkollor dhe të shkollës në përkrahje të nxënësve të shkollës, përvojat në menaxhimin e mësimit në kushtet e pandemisë, sfidat, si dhe zgjidhjet e mundshme për të siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri të arsimit parauniversitar, pas ndikimeve nga Covid-19.

Për analizën e të dhënave cilësore është përdorur metoda e analizës së përmbajtjes përmes së cilës temat janë koduar gjatë shqyrtimit dhe analizës së kuadrit të masave për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar në kushtet e pandemisë Covid-19 dhe pastaj janë riorganizuar brenda një strukture të temave që e karakterizojnë këtë raport të hulumtimit. Kjo qasje ka ndihmuar që të gjitha çështjet e lidhura me qëllimin e studimit, problemet që janë ngritur gjatë analizës kabinetike, intervistave dhe fokus grupeve, të klasifikohen, interpretohen dhe përshkruhen në kategori tematike dhe të lidhen me pyetjet që e kanë udhëhequr këtë studim.

Informacionet autentike të mbledhura përmes intervistave me shkrim dhe diskutimeve me fokus grupe dhe të integruara në raportin e studimit, janë koduar me shkronja të mëdha dhe me numër rendor të njohur nga autorët e këtij studimi¹⁰.



Analiza dhe shqyrtimi i kuadrit të masave/ politikave arsimore për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë dhe raporteve në këtë fushë, është plotësuar me realizimin me shkrim dhe me gojë të 21 intervistave gjysmë të strukturuar të realizuara me përfaqësues të komunitetit arsimor që lidhen me zhvillimet në arsimin parauniversitar, dhe me përfshirje të 15 mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave në dy diskutime me fokus grupe. Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia intervistat kryesisht janë realizuar me shkrim.

10 M/1: Mësimdhënës me numrin rendor 1; D/1: Drejtor i shkollës me numer rendor 1; DKA/1: Zyrtar arsimor nga DKA; NJA/1: Njohës i arsimit, përfaqësues nga organizatat që mbështesin arsimin.

4. ORGANIZIMI I MËSIMIT NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR GJATË PANDEMISË COVID-19

Për t'iu shmangur përsëritjeve dhe njëkohësisht për të organizuar me mirë gjetjet kryesore lidhur me organizimin e mësimit gjatë pandemisë, ky kapitull është organizuar në katër pjesë: (i) Masat e ndërmarra për realizimin e mësimit në distancë gjatë pandemisë, në periudhën mars-gusht 2020; (ii) Planifikimi dhe përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie (viti shkollor 2020-2021); (iii) Planifikimi i buxhetit për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, në kushte pandemie (viti shkollor 2020-2021); dhe (iv) Koordinimi i institucioneve arsimore në organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë.



4.1. Masat e ndërmarra për realizimin e mësimit në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë në periudhën mars-gusht 2020

Bazuar në rrethanat e krijuara nga pandemia Covid-19, Qeveria e Republikës së Kosovës në mars të vitit 2020, ashtu si të gjitha vendet e rajonit, BE-ja dhe vendet tjera të botës, ka reaguar në mënyrë të shpejtë sa i përket marrjes së masave dhe veprimeve në përgjigje të rrethanave të krijuara nga Covid-19. Masat e ndërmarra në periudhën mars-gusht 2020 ndërlidhen ngushtë me organizimin e institucioneve qendrore, lokale dhe institucioneve arsimore/shkolllore/për vazhdimin dhe përfundimin e vitit shkollor përmes mësimit në distancë në rrethanat e situatës së karantinimit të plotë të vendit, ku në të gjitha masat e ndërmarra në këtë periudhë mirëqenia dhe ruajtja e shëndetit ishin primare. Për fillimin e organizimit të mësimit online në forma të ndryshme, institucionet arsimore, prindërit, mësuesit, nxënësit dhe i gjithë komuniteti arsimor treguan mobilizim dhe angazhim të veçantë, një shembull që qytetarët e këtij vendi shpesh kanë ditur ta kthejnë në vepra pune. Me sfidë të ngjashme Kosova ishte përballur gjatë viteve të nëntëdhjeta, kur organizoi mësimin paralel, një shembull unik i mobilizimit qytetar për të mbajtur sistemin arsimor gjallë në kohë të konfliktit dhe luftës¹¹. Por, tani në kohë paqeje, një gjë e tillë po ndodh për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia.

Sipas raportit të studimit të IPK (2020): *Mësimi në distancë/e-mësimi në Arsimin Parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia Covid-19*, përgatitjet për fillimin e mësimit në distancë në kohë pandemie të papritur nuk ishin të lehta. Sistemi i arsimit parauniversitar nuk ishte i përgatitur për një modalitet të tillë të mësimit. Sfidat kryesore ishin mungesa e kompetencës digjitale të mësuesve për mësime online, mungesa e teknologjisë, koha e shkurtër, mungesa e strukturave përkatëse për mësimin në distancë, mungesa e përvojës së MASHTI, procedurat e komplikuar për prokurim në MASHTI, mungesa e një platforme të standardizuar për mësime në distancë, etj.¹²

Sipas raportit të studimit të realizuar nga IPK (2020), masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse për realizimin e mësimit në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë, në fazën e parë të pandemisë, janë të përafërta me ato të rajonit të cilat lidhen me nxjerrjen e vendimeve për ngritjen e mekanizmave për menaxhimin e mësimit në distancë, nxjerrjen e udhëzimeve dhe udhëzuesve për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi, modalitetet e organizimit të mësimit, zhvillimin e platformave online, si dhe angazhimin e televizioneve publike si transmetues zyrtarë të mësimit në distancë për arsimin bazë.

11 Bardha Qirezi (15.04.2020). Mbajtja në jetë e sistemit arsimor: Si po zhvillohet mësimi online në kohë pandemie. <https://d4d-ks.org/editorial/mbajtja-ne-jete-e-sistemit-arsimor-si-po-zhvillohet-mesimi-online-ne-kohe-pandemie/>

12 Më gjerësisht, shih raportin e studimit: *Mësimi në distancë/e-mësimi në Arsimin Parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID - 19*. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Maj 2020.

Referuar dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare të MASHTI-it dhe raporteve që pasqyrojnë mësimin në distancë në periudhën mars-gusht 2020, masat e ndërmarra për realizimin e mësimin në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë janë si në vijim:

- Krijimi i skicës së parë të mësimin të kërkuar dhe resurset e kërkuara për realizimin e tij;
- Krijimi i skicës dhe domeneve të para për realizimin e mësimin në distancë;
- Themelimi i Grupit Profesional;¹³
- Krijimi i platformës së mësimin në distancë <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>¹⁴;
- Negocimi me kompanitë me platforma të gatshme të mësimin online;
- Negocimi dhe vendimi për fillimin e transmetimit të video-materialeve në RTK ;
- Prodhimi i materialeve mësimore¹⁵;
- Transmetimi i video-materialeve në RTK dhe në kanalin e MASHTI-t në ‘YouTube’
- Lansimi i platformës së parë online në Kosovë: “Edukimi në distancë - Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç.”¹⁶
- Lansimi i platformës “Arsimi gjithëpërfshirës”¹⁷, si dhe
- Përgatitja e dokumenteve (politika arsimore dhe udhëzues) për realizimin e mësimin në distancë në arsimin parauniversitar në Kosovë.



- 13 Detyrat e grupit profesional për mësimin në distancë: (i) të hartojë udhëzuesin për rolet dhe përgjegjësitë e faktorëve mësimorë të mësimin në distancë; (ii) të hartojë udhëzuesin për vlerësim; (iii) të monitorojë mirëvajtjen e mësimin online me qëllim të sigurimit të cilësisë; (iv) të sigurohet që zgjidhjet e tanishme të inkorporohen në digjitalizimin e mësimin në Kosovë në plan afatmesëm; (v) të hartojë politikat për mësimin në distancë dhe digjitalizimin e mësimin në Kosovë.
- 14 Platforma E-mësimi përmban udhëzuesit, dokumentet tjera të hartuara nga MASHTI dhe materialet e video-ligjëratave. Platforma e MASHT-it nuk i ka në dispozicion librat shkollorë. Referuar intervistës së dhënë nga Zëvendësministri Xhavit Rexhaj për studimin e IPK (2020), i cili ishte përgjegjës për pjesën pedagogjike dhe për komunikimin me DKA – shkolla: Realisht, ne nuk kemi gjetur asgjë. Domethënë nuk kemi gjetur asnjë dokument që në mënyrë specifike i referohet mësimin online ose atij në distancë. Ne i kemi përdorur dokumentet ekzistuese që e rregullojnë mësimin në shkollë, si kalendari shkollor, UA për vlerësimin e nxënësve, kurrikula shtetërore (KKK), planet dhe programet mësimore, e të tjera. Po të mos ishin kompanitë e teknologjive të reja (Kallxo. com, Gjirafa, Microsoft, Link Plus), ne nuk besojmë se do të guxonim as të fillojmë të bëjmë as një hap në drejtim të realizimit të mësimin në distancë.
- 15 Prodhimi i materialeve mësimore është bërë me mbështetjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe të mësimdhënësve të shkollave të Prishtinës. Lidhur me materialet mësimore të prodhuara për mësimin në distancë, MASHTI me kohë informoi se ka vendosur që këto materiale të ofrohen si burim i hapur (open source) me kushtet në vijim: (i) Këto materiale dhe përmbajtje mbesin pronë e MASHTI-t; (ii) Këto materiale dhe përmbajtje nuk mund të modifikohen; dhe (iii) Këto materiale dhe përmbajtje nuk mund të përdoren për qëllime fitimprurëse.
- 16 MASHTI në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë dhe organizatën Save the Children, si dhe me përkrahje teknike nga organizata Open Data Kosovo, e ka përgatitur Platformën “Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 – 6 vjeç” <https://edukimihershem.rks-gov.net/>. Platforma u dedikohet fëmijëve të moshës nga 0 deri në 6 vjeç dhe është në përputhje të plotë me Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0 – 6 vjeç, si dhe ofron mbështetje për prindërit/kujdestarët ligjorë dhe edukatorët në realizimin e aktiviteteve ditore e javore me fëmijët në kushte shtëpie.
- 17 Platforma “Arsimi gjithëpërfshirës” e zhvilluar nga MASHTI, me mbështetjen e organizatës “Save the Children”, është lansuar më 29 prill 2020. <http://arsimigjithepershires.rks-gov.net/>

MASHTI për organizimin e mësimit dhe përfundimin e vitit shkollor 2019-2020, në rrethanat e pandemisë, ka nxjerrë dokumente (politika arsimore dhe udhëzues) të cilat janë publikuar në platformën e-Mësimi. Dokumentet e zhvilluara përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve dhe ofrojnë udhëzime për aspektet që mbulojnë realizimin e mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në dokumentet e zhvilluara nuk ofrohen udhëzime të detajuara për zbatimin e kurrikulës, përcaktimin e temave kryesore që duhet të realizohen gjatë mësimit në distancë, ose vendim për përqendrim vetëm në kompetencat kryesore. Kjo ka bërë që mësimi në distancë të vazhdojë nga aty ku është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë, për shkak të pandemisë COVID-19 (IPK, 2020). Disa nga dokumentet e zhvilluara janë si në vijim:

- Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimit në distancë¹⁸;
- Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta (SHML)¹⁹;
- Udhëzime për DKA-të për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës²⁰;
- Përdorimi i platformës Zoom - Zoom - us²¹;
- Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimit në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta²²;
- Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë²³;
- Vendimi 25/01B, për procedurat realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë²⁴.
- Informata, udhëzime dhe rregulla për kandidatët (Maturantët) për Provimin e Maturës Shtetërore (2020)²⁵;

Në fazën e parë të pandemisë, duke filluar nga marsi i vitit 2020, mësimi në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë është realizuar përmes e-mësimit - video-materialeve në RTK dhe në kanalin e MASHTI-t në YouTube, si dhe mësimit online të realizuar nga shkollat. Kjo për arsye të mungesës së një platforme unike mësimore dhe materiale mësimore të digjitalizuara.

-
- 18 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimit në distancë, https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-perjegjiesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distancë-mashti_1.pdf
- 19 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta (SHML). https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf
- 20 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për DKA për realizimin e mësimit online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf
- 21 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Përdorimi i platformës Zoom - Zoom - us. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti_1.pdf
- 22 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimit në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>
- 23 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distancë.pdf>
- 24 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Vendimi 25/01B për procedurat realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/vendim-procedurat-e-realizimit-te-vleresimit-te-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distancë-ne-te-gjitha-nivelet-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove-24042020.pdf>
- 25 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Informata, udhëzime dhe rregulla për kandidatët (Maturantët) - për provimin e Maturës Shtetërore 2020. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/05/informata-udhezime-dhe-rregulla-per-kandidatet-maturantet-provimi-i_1.pdf

Kështu, Kosova ashtu si edhe shtetet në Ballkanin Perëndimor është përpjekur t'i tejkalojë problemet me mungesën e platformës dhe materialeve mësimore digjitale, duke transmetuar mësimet e regjistruara paraprakisht në televizionin kombëtar, në të cilin ka qasje një përqindje shumë më e madhe e popullsisë. Megjithatë, për të ofruar mësimet televizive në masë, lëndët e shtjelluara dhe koha e mësimi u shkurtuan në mënyrë të konsiderueshme, që do të thotë se e drejta për arsimim për nxënësit që mbështeteshin në televizion ishte më pak e mbrojtur efektivisht sesa për ata që kishin infrastrukturën e duhur digjitale dhe shkathësitë e teknologjisë informative²⁶.

Ndërsa, në arsimin e mesëm të lartë, klasat 10-12 të, mësimi në distancë është realizuar në mënyrë të decentralizuar, nga vetë shkolla dhe mësimdhënësit e saj, me platforma dhe aplikacione që dallojnë nga shkolla në shkollë, nga mënyra e organizimit, përfshirja e lëndëve mësimore, etj. Realizimi i mësimi online në shkollat e mesme të larta në këtë periudhë të vitit shkollor, sipas udhëzimeve të MASHTI-it, ishte i fokusuar në disa lëndë të përgjithshme (Gjuhë, Matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore).

Referuar rezultateve të studimit nga IPK (2020), për mësimin në distancë/e-mësimin në arsimin parauniversitar në Kosovë, sfida kryesore për mësimin në distancë në periudhën e parë të pandemisë mbeten cilësia e mësimi në distancë, përfshirë cilësia e video-materialeve dhe cilësia e qasjeve të mësimdhënies gjatë mësimi në distancë, pastaj vlerësimi i nxënësve, mungesa e teknologjisë të mësimdhënies dhe të nxënësit (familjet), mungesa e kushteve shkollore në shtëpi, mospjesëmarrja në mësim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara dhe familjet me kushte të rënduara financiare.

Sipas studimit nga Qendra AIRE (2020) *Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut*, kur arsimit ofrohet kryesisht përmes platformave digjitale, me gjasë ai do të ketë impakt diskriminues mbi të drejtën për qasje në arsim për personat nga grupet me disavantazhe socio-ekonomike dhe ata që jetojnë në zona rurale ose të mbipopulluara. Sipas këtij studimi, nxënësit me disavantazhe socio-ekonomike kanë më shumë gjasa të jetojnë në një ambient shtëpiak jo të përshtatshëm për mësim në shtëpi, e më pak gjasa të kenë qasje në teknologji siç është laptopi, dhe mund të kenë vetëm një pajisje elektronike që përdoret nga tërë familja. Situatë e njëjtë është raportuar edhe në kontekstin e arsimit në Kosovë.

Në anën tjetër, mësimi në distancë, në këto rrethana, ishte një mundësi e mirë për t'i mbajtur të mobilizuar fëmijët, për të shpërqendruar vëmendjen e tyre nga aktualiteti i epidemisë etj. Po ashtu, është një mundësi e mirë për të mësuar për përparësitë e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, për modalitetin e mësimi në distancë, dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe integrimin e mësimi online në sistemin arsimor të Kosovës, i cili duhet të jetë në shërbim të të gjithë fëmijëve në Kosovë dhe në diasporë.

26 Qendra AIRE (2020). Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut (Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (f. 120 - 12). <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/10/covid-guide-alb.pdf>

4.2. Planifikimi dhe përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie - viti shkollor 2020-2021

Për të shqyrtuar gjendjen në arsimin parauniversitar dhe hapat që duhet të ndërmerren, MASHTI sipas raporteve informative që ka publikuar në faqen zyrtare ka zhvilluar takime të shumta me mekanizmat e brendshëm, DKA dhe partnerët që mbështesin arsimin parauniversitar. Pastaj, bazuar në masat dhe përgatitjet e zhvilluara nga MASHTI, janë bërë planifikimet dhe përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie - viti shkollor 2020-2021, në nivel komune dhe në nivel të institucioneve shkollore.

Për dallim prej fazës së parë të reagimit të institucioneve arsimore ndaj pandemisë, në planifikimin dhe përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie – viti shkollor 2020-2021, janë zhvilluar më pak dokumente dhe udhëzues, por brenda tyre janë integruar masa e orientime që mbulojnë aspektet e planifikimit, masat higjienike, orientimet për organizimin e mësimit sipas skenarëve dhe aspektet e monitorimit dhe inspektimit të punës së institucioneve arsimore.

Referuar dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare të MASHTI-it dhe raporteve që pasqyrojnë mësimin në distancë në periudhën mars-gusht 2020, masat e ndërmarra për realizimin e mësimit në arsimin parauniversitar gjatë pandemisë janë si në vijim:

- Udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 - në kushtet e pandemisë Covid-19 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-final-file-10-09-2020.pdf> ; dhe
- Master Plani për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi> (publikuar me 18.09.2020)

Referuar udhëzuesit të përgjithshëm të MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 në Republikën e Kosovës, sipas skenarëve A dhe B dhe C, bëhet me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënëseve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimit të procesit edukativo arsimor sipas dokumenteve kurrikulare, në kushte të pandemisë Covid-19.

Mësimi sipas skenarëve të vendosura në këtë udhëzues mundëson organizimin e mësimit sipas kushteve epidemiologjike në vend duke përfshirë edhe kushtet e rihapjes së institucioneve edukativo arsimore me masa të shtuara për shëndetin publik, kushte të mbylljes së pjesshme apo kushte të mbylljes së plotë për shkak të rrezikshmërisë së shëndetit nga pandemia Covid-19.

Udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 – në kushtet e pandemisë Covid-19, është i mbështetur në Kornizën për rihapjen e institucioneve edukativo arsimore të aprovuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara - UNESCO, UNICEF, Banka Botërore, WFP, dhe UNHCR²⁷.

²⁷ Organizata e Kombeve të Bashkuara (Prill, 2020). Korniza për rihapjen e shkollave. <https://www.unicef.org/sites/default/files/2020-06/Frameëork-for-reopening-schools-2020.pdf>

Udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-it është i organizuar në shtatë kapituj, ku trajtohen çështjet në vijim:

- Korniza e Planifikimit (Politikat, veprimtaria e sigurtë, përgjegjësitë e pjesëmarrësve, grupet e marginalizuara, dhe Financimi);
- Masat e përgjithshme për mbrojtjen nga Covid-19;
- Organizimi i edukimit/mësimit sipas skenarëve për të gjitha nivelet dhe udhëzimet metodologjike;
- Zbatimi i Kurrikulës dhe Udhëzimet Metodologjike;
- Digjitalizimi i edukimit/mësimit;
- Trajnimi i edukatoreve/ mësimeve për mësimin në institucionet edukative arsimore dhe online;
- Monitorimi nga Inspektorati i arsimit.

Udhëzuesi detajon skenarët e mësimit sipas niveleve të rrezikut/situatës pandemike dhe masat sipas skenarëve të mësimit (A - mësimi me prezencë në institucionet parashkollë dhe shkollë me masat parandaluese; B - rikthim i pjesshëm, mësimi i kombinuar me prezencë dhe mësim në distancë; C - mësimi në distancë (TV + e-mësimi), themelimin dhe detyrat për Task Forcat në MASHTI-it, DKA dhe në nivel institucionit parashkollor/shkollës.

Udhëzuesi, në mënyrën se si është shkruar dhe si janë dhënë udhëzimet, është shumë fleksibil ku lejon të vepohet sipas udhëzimeve, rrethanave epidemiologjike dhe vendimeve nga Task Forca përkatëse. Në mbështetje të këtij udhëzuesi, në të gjitha dokumentet dhe raportet nga takimet me përfaqësues të institucioneve arsimore, theksohet se vendimet për vazhdimin e organizimit të mësimit sipas skenarëve të përcaktuar varen nga situata epidemiologjike dhe rekomandimet e Bordit Këshillëdhënës për Covid-19.

Në kapitullin e tretë të Udhëzuesit të përgjithshëm kur i referohet **organizimit të mësimit dhe organizimit të punës së shkollës, sipas skenarëve A, B dhe C**, theksi vendoset në informacione të përgjithshme sipas niveleve të shkollimit, duke përfshirë orientimet për rikthim në shkollë në varësi të skenarëve, prioritetet, numrin maksimal të nxënësve në klasa, orarin mësimor të shkurtuar, mësimin online përmes TV e-Mësimin, përdorimin e platformave për e-mësim, kontaktin e rregullt me mësues, kujdestar klase, mësues lëndor, etj. Gjithashtu në këtë kapitull pasqyrohet propozimi për planifikim mësimor me reduktimin e përmbajtjeve për 25%, për shkollat që punojnë në skenarin A. Në anën tjetër, nuk ka orientime dhe propozime për reduktimin e përmbajtjeve për shkollat kur punojnë me skenarin B apo C, e cila le të kuptohet se shkollat pavarësisht me cilin skenar punojnë, të gjitha angazhimet duhet t'i bëjnë për të arritur 75% të programit mësimor, rezultateve të nxënësve dhe përmbajtjeve mësimore.

Në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, më disa raste iu referohen dokumenteve dhe udhëzimeve të hartuara për shkollat në mars – prill 2020, të cilat mbulonin mësimin në periudhën mars-qershor 2020 dhe përfundimin e vitit shkollor 2019/2020. Kështu për shembull në udhëzuesin për vitin shkollor 2020-2021, pavarësisht përshkrimeve në skenarët përkatës të mësimit, sugjerohet që zbatimi i kurrikulës në gjimnaze të jetë i kufizuar në lëndët kryesore (gjuhë, matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore) varësisht nga tipi i gjimnazit, pa dhënë orientime e udhëzime se si të vepohet me lëndët tjera që nuk mbulohen dhe si të bëhet angazhimi i mësimeve të këtyre lëndëve, etj.

Pjesë e udhëzuesit të përgjithshëm të MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 – në kushtet e pandemisë Covid-19, është edhe **edukimi parashkollor**. Kthimi i fëmijëve në institucionet parashkollore – me aktivitete të edukimit/mësimit në grupe me më së shumti 15-20 fëmijë, në distancë prej së paku 1,5 - 2m nga njëri tjetri, është përshkruar si një ndër prioritetet e para në udhëzuesin e përgjithshëm. Sipas përshkrimeve në platformën për edukimin në fëmijërinë e hershme, përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara në këtë platformë stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore, si: fizike, njohëse, emocionale, matematikore dhe kreativitetin, në varësi të moshës së tyre. Referuar statistikave që nga lansimi i platformës (të analizuar me 13.05.2021), platforma është vizituar nga 2,724,122 subjekt, 1,600 edukatorë janë trajnuar për përdorimin e platformës, janë gjeneruar 1,749 raporte digjitale, si dhe janë realizuar 1,075 aktivitete.

Referuar intervistës me shkrim të udhëheqëses së Divizionit për edukim parashkollor në MASHTI, lidhur me përgatitjet për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie - viti shkollor 2020-2021, është vazhduar me përditësimin e platformës online “Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç”, bashkëpunimin me partnerët për të siguruar material për prindërit, kujdestarët ligjor dhe stafin edukativ se si të flasim me fëmijët për Covid-19 dhe përkthimin e përmbajtjes së platformës në gjuhë Serbe, Turke, dhe atë Rome. Me mbështetjen e UNICEF-it, Bankës Botërore, Save the Children dhe Caritas të Zvicrës, në përgjigje të situatës së krijuar me Covid-19 në fushën e edukimit gjatë këtij viti janë pajisur me materiale didaktike 8,123 fëmijë, kryesisht nga komunitetet dhe familjet me asistencë sociale. Gjithashtu është arritur që në kuadër të masave mbrojtëse ndaj Covid 19 të sigurohen për institucionet parashkollore termometër laserik për matjen e temperaturës së fëmijëve, material higjienik dhe posterë me udhëzime për masat mbrojtëse.

Për qëllime të **arsimit gjithëpërfshirës** dhe adresimit të nevojave të **grupeve të ndryshme të marginalizuara**, në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, institucioneve arsimore iu sugjerohet që t’u kushtojnë kujdes të veçantë fëmijëve që vijnë nga grupet e marginalizuara, ata me gjendje të vështirë socio-ekonomike, atyre me nevoja të veçanta, fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian etj. për të cilët kërkohet qasje individuale, në mënyrë që ata të kenë qasje në arsim dhe të jenë pjesëmarrës aktiv në mësim. Megjithatë, udhëzimet janë të përgjithshme dhe mungojnë shembuj konkret se si të punohet me grupe të marginalizuara me qëllim eliminimin apo zvogëlimin e pabarazive në mësim.

Në anën tjetër, për nxënësit me nevoja të veçanta ofrohen udhëzime në udhëzuesin e veçantë për qasjen dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta për vitin shkollor 2020-2021, publikuar më 13 gusht 2020 (<https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>). Udhëzuesi përfshin masat, sigurinë, mbrojtjen dhe higjienën për nxënësit me nevoja të veçanta në qendra burimore, mënyrën e organizimit të procesit mësimor sipas tre skenarëve të mësimit për nxënësit, format e bashkëpunimit me prindër, platformat që do të përdoren, materialet etj. Udhëzuesi u **përshtatet specifikave të Qendrave Burimore me konvikte dhe atyre pa konvikte. Gjithashtu, udhëzuesi ofron informata për DKA-të dhe institucionet arsimore për të gjitha shërbimet, trajnimet, pajisjet dhe kontaktet se ku mund të merren shërbimet për nxënësit me nevoja të veçanta.**

Referuar intervistës me shkrim të realizuar me udhëheqësen e Divizionit për Arsimin Gjithëpërfshirës në MASHTI, masat kryesore që janë ndërmarrë për arsimin gjithëpërfshirës dhe grupet e marginalizuara për vitin shkollor 2020-2021, përfshijnë (i) aktivitetet e koordinimit të e-Mësimit në distancë me DKA, Qendra Burimore dhe partnerët tjerë që punojnë në këtë fushë; (ii) këshilla profesionale, edukativo-arsimore në baza ditore për prindër, mësimdhënësit mbështetës, mësimdhënësit dhe asistentët për qasjen ndaj punës me fëmijë me nevoja të veçanta, format dhe teknikat e punës në realizimin e aktiviteteve dhe detyrave individuale, përdorimit të materialeve didaktike, zbrërthimit të aftësive të fëmijës në hapa konkret materiale pedagogjike online, video; (iii)

trajnimin e 297 mësimeve për përdorimin e platformave Google Classroom dhe ZOOM mësimeve për përdorimin e platformave Google Classroom dhe ZOOM, trajnimin tregues të 180 anëtarëve të ekipeve vlerësuese komunale për PIA, etj.

Numri i madh i fëmijëve nëpër grupe edukative gjatë vijueshmërisë së fëmijëve në Kapitullin katër të udhëzuesit të përgjithshëm i referohet udhëzimeve për zbatimin e kurrikulës dhe udhëzimeve metodologjike. Në rreth tetë faqe janë dhënë udhëzime e orientime të cilat ndërlidhen me qëllimet e arsimit parauniversitar të Kosovës, kompetencat siç parashihen me kornizën kurrikulare, parimet e kurrikulës, si dhe me udhëzuesit didaktik-metodik për mësimeve të hartuar nga UNICEF. Në këtë kapitull nuk janë ofruar mjaftueshëm udhëzime lidhur me:

- Ndërlidhjen e planifikimeve mësimore me informatat paraprake për nivelin e arritjeve të nxënësve nga klasa paraprake;
- Mënyrën dhe hapat se si të bëhet përqendrimi i vetëm në përmbajtjet thelbësore për arritjen e rezultateve të të nxënësve, me shembuj ilustrues se paku për klasa të caktuara;
- Mënyrën se si të bëhet reduktimi i sasisë së përmbajtjeve mësimore, jo në dëm të cilësisë së përmbajtjes dhe rezultateve të të nxënësve;
- Qasjet në mësimeve në mënyrë që të sigurohet atraktiviteti i përmbajtjeve që shtjellohen, ashtu që t'i motivojnë nxënësit/et për të mësuar, në varësi të llojeve të skenarëve të mësimit,
- Kujdesin dhe mbështetjen e nxënësve të cilët janë raportuar që nuk kanë marrë pjesë fare në mësimeve online të organizuar në periudhën mars – qershor 2020, rreth 10 mijë nxënës; etj.

Sipas udhëzuesit të përgjithshëm, grupi i kurrikulës në MASHTI do të përcaktojë një version më të përmbledhur të RNF dhe RNL për mësimeve në kushtet e pandemisë, përfshirë edhe mësimeve në distancë. Përveç planeve mësimore të hartuara nga grupet profesionale të mësimeve të Komunës së Prishtinës për klasat 1-9, nuk është arritur të sigurohet ndonjë dokument/udhëzues nga grupi i kurrikulës në MASHTI i cili përmbledh RNF dhe RNL për mësimeve në kushtet e pandemisë.

LIDHUR ME VLERËSIMIN E NXËNËSVE, në udhëzuesin e përgjithshëm të MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19 ka pak udhëzime dhe orientime për shkollat, pasi që ato janë detajuar më shumë në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë, i cili është publikuar në faqen zyrtare të MASHTI-it (platformën e-mësimi) më 24 tetor 2020²⁸. Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve është organizuar në gjashtë kapituj, duke përfshirë udhëzimet për:

- Parimet e vlerësimit të nxënësve, në kushtet e pandemisë;
- Vlerësimin e nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës dhe skenarëve të organizimit të vitit shkollor 2020-2021, në kushtet e pandemisë;
- Metodatat e vlerësimit të nxënësve në kushtet e pandemisë;
- Format e vlerësimit të nxënësve në kushtet e pandemisë;
- Modalitetet e vlerësimit në raste specifike;
- Rolet dhe përgjegjësitë në vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë.

Përshkrimet, udhëzimet dhe orientimet e dhëna në udhëzuesin e vlerësimit janë një bazë e mirë për mësimdhënësit dhe akterët tjerë në shkolla. Udhëzuesi ka disa përshkrime të zgjeruara dhe përsëritje nga udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, të cilat referuar qëllimit të udhëzuesit janë të panevojshme. Në anën tjetër, në udhëzues nuk ka përqendrim në udhëzime më konkrete, të shkurtra dhe të ilustruara me shembuj për situata konkrete që lidhen me vlerësimin e nxënësve në këto kushte, siç është për shembull identifikimi i humbjeve mësimore përmes qasjeve të mënyrave të vlerësimit.

Publikimi me vonesë i udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve (me 24 tetor) dhe mënyra se si udhëzuesit dhe dokumentet tjera përcillen tek mësimdhënësit, pa ndonjë informim dhe diskutim të organizuar nga zhvilluesit e udhëzuesit dhe të dokumenteve të tjera, nuk sigurojnë informim të plotë për mësimdhënësit dhe komunitetin e shkollës dhe rrezikojnë mos përdorim apo mos referim gjatë organizimit të punës në shkollë dhe procesit mësimor.

Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, në një kapitull të veçantë përshkruan situatën lidhur me **Digjitalizimin e mësimit në shkolla - platformat, përgatitja dhe zbatimi i mësimit online**. Informacionet dhe orientimet janë të rëndësishme, mirëpo ato nuk ofrojnë udhëzime konkrete dhe të ilustruara me shembuj për situata se si shkollat në nivel të Kosovës të unifikojnë veprimet për të siguruar një platformë bazike në nivel shkolle e cila lehtëson punën e shkollës gjatë mësimit në kushtet e pandemisë, mundëson vendosjen e materialeve mësimore digjitale që zhvillohen në nivel të aktivave profesionale, eliminon përdorimin e aplikacioneve të ndryshme për mësim online nga mësimdhënësit e shkollës së njëjtë apo të një klase të njëjtë, e cila raportohet të jetë mjaft sfiduese për nxënës.

Në anën tjetër, sipas raportit për analizën e gjendjes paraprake për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026²⁹, sa i përket digjitalizimit të materialeve mësimore për nivelet e ndryshme të arsimit parau-

28 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020_01). Udhëzues për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/10/udhezuesi-per-vleresim-2020_1.pdf

29 Jusuf Thaçi (tetor, 2020): Analizë Paraprake e Gjendjes për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026. Instituti ATOMI, Prishtinë. Dokumenti është hartuar nga Instituti ATOMI në kuadër të Projektit "Mbështetje për hartimin e një strategjie

niversitar në Kosovë, thuhet se në aspektin institucional, nuk është bërë ende asgjë, meqë ende në Kosovë nuk ekzistojnë materiale mësimore digjitale të zhvilluara në mënyrë institucionale, në përputhje me kurrikulat shtetërore, me programet lëndore e me planet mësimore, të cilat kenë kaluar nëpër filtrat përkatës të kontrollit dhe të jenë miratuar nga MASHTI për përdorim nga institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Sipas raportit, të vetmet materiale mësimore të tilla janë ato që janë prodhuar gjatë periudhës së pandemisë Covid-19 (duke filluar nga muaji mars 2020 e deri më sot), me qëllim të ofrimit të mësimin në distancë për fëmijë/nxënës të niveleve dhe kategorive të ndryshme të arsimit parauniversitar. Situatë e njëjtë u reflektua edhe me 14 shtator 2020, kur filloi viti i ri shkollor 2020-2021.

Në Kosovë penetrimi i internetit është vazhdimisht në rritje. Sipas Kantar (2019), 97% e popullatës kanë qasje në telefoni mobile, 37% kanë Smart TV, 30% kanë tablet, 39% kanë kompjuter dhe 48% kanë laptop. Kosovarët qasen në internet më së shumti përmes telefonave mobil (74%), kurse arsyet kryesore të qasjes janë: komunikimi (93%), dëgjimi i muzikës (37%), leximi (35%), dëgjimi i lajmeve (22%), studimi dhe kërkimi (18%). Platformat më të përdorura janë Viber (85%), Facebook (67%), dhe Instagram (51%). Rrjedhimisht, mund të konstatohet që teknologjia në shumicën e rasteve përdoret për komunikim dhe media sociale duke treguar një përdorim të ulët për qëllime arsimore³⁰.

Në anën tjetër, sa i përket shërbimeve dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), sipas raportit për analizën e gjendjes paraprake për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026, qasja në internet dhe pajisja me mjete të TIK-ut në shkollat publike në Kosovë del të jetë në gjendje shumë të keqe. Në 125 shkolla publike të Kosovës nuk kanë qasje në internet (jo për shkak të pamundësisë teknike për qasje në internet, por për shkak të kostos mujore të internetit). Në shkollat që kanë qasje në internet, në shumicën e rasteve nuk ofrojnë internet në tërë hapësirën shkollore, por vetëm në zyrat e caktuara të personelit dhe eventualisht në kabinetet e TIK-ut.

MONITORIMI DHE INSPEKTIMI NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, përshkruhet në pak rreshta në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021. Sipas kapitullit të gjashtë të këtij udhëzuesi, Inspektorati i Arsimit i kryen detyrat përmes inspektimit të përgjithshëm, tematik, emergjent, ri-inspektimit si dhe inspektimit të cilësisë dhe vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Ndërsa, në përputhje me Planin për Rikthimin në Shkolla në Kohë të Pandemisë apo mësimin nga distanca, Inspektorati ka prioritetet në vijim:

- Shkollat dhe metodat e mësimdhënies respektojnë protokollin për siguri dhe shëndet dhe mirëqenien e fëmijëve;
- Nxënësit nuk mbeten prapa për shkak të statusit të tyre social, ekonomik apo rrethanave të veçanta;
- Mënyra e inspektimit i përshtatet kushteve në kohë pandemie dhe mësimin nga distanca.

të mirë-planifikuar për digjitalizimin e sistemit të arsimit në Kosovë”, i cili realizohet me fonde të Ministrisë Britanike për Punë të Jashtme dhe Zhvillim përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë dhe i cili zbatohet nga Institutit ATOMI.

30 Bardha Qirezi (15.04.2020). Mbatja në jetë e sistemit arsimor: Si po zhvillohet mësimi online në kohë pandemie. <https://d4d-ks.org/editorial/mbajtja-ne-jete-e-sistemit-arsimor-si-po-zhvillohet-mesimi-online-ne-kohe-pandemie/>

Bazuar në prioritetet e mësipërme, fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar, vihet tek aspektet logjistike dhe organizative, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësinë e mësimin në kushtet e pandemisë, etj. Disa nga aspektet përmbajtjesore të monitorimit, mbulohen në udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve, përkatësisht në pjesën e këtij udhëzuesi për monitorimin dhe raportimin lidhur me vlerësimin e nxënësve në kushtet e pandemisë, por ato nuk janë të mjaftueshme për monitorimin gjithëpërfshirës të organizimit të mësimin dhe cilësisë së tij në këto kushte.

Në kuadër të udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021, adresohen edhe **trajnimi i mësimdhënësve, personelit menaxherial dhe përkrahës të shkollave dhe akterëve tjerë**. Sipas udhëzuesit, veprimet më urgjente lidhur me trajnimet obliguese për mësimin online janë:

- Koordinimi i DKA lidhur me kërkesat dhe nevojat e trajnimeve për mësimdhënës;
- Trajnimi i mësimdhënësve për përdorimin e platformës mësimore nga ofruesi i platformës ose organizatë profesionale;
- Trajnimi i mësimdhënësve për metodologji të mësimin online si dhe i punës eksperimentale;
- Ofrimi i trajnimit të mësimdhënësve për mjete të TIK-ut;
- Ofrimi i këshillimit DKA-ve i mësimdhënësve dhe prindërve për përdorimin e mjeteve të TIK-ut;
- Trajnimet për metodat e mësimdhënies online dhe të kombinuar.

Referuar udhëzuesit të përgjithshëm, pjesa më e madhe e trajnimeve të propozuara ka mbetur të konfirmohen nga partnerët mbështetës, përfshirë edhe kohën e realizimit të tyre. Mirëpo, nuk ka ndonjë plan të detajuar për trajnimin e mësimdhënësve për këtë vit shkollor në kushtet e pandemisë, i cili është ndarë më DKA-të dhe institucionet tjera arsimore e organizata që merren me ZHPM.



Bazuar në prioritetet e mësipërme, fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar, vihet tek aspektet logjistike dhe organizative, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësinë e mësimin në kushtet e pandemisë, etj.

Planifikimi i buxhetit për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, në kushte pandemie

Lidhur me buxhetin për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, në kushte pandemie janë marrë tri vendime nga Qeveria e Republikës së Kosovës:

- (i) Me vendimin e Qeverisë nr. 01/27 të datës 26.08.2020³¹, është aprovuar Master Plani për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie për vitin shkollor 2020-2021, i hartuar nga MASHTI, ku shpenzimet kryesore të buxhetit për arsim janë planifikuar sipas skenarëve të mësimit që zhvillohet në shkolla, siç përshkruhet në pjesën në vijim.

SKENARI A: mësimi zhvillohet në shkolla.

Kërkohe investim në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim të shkollës – 2,582,000 euro (vlerësim në bazë të një praktike të mirë në Prizren), sigurimi i përkrahjes për DKA dhe shkollat për mbulimin e vëllimit të shtuar të punës si rezultat i riorganizimit të paraleleve për të siguruar distancën e duhur në mes të nxënësve. Përveç kësaj, duhet siguruar përkrahje për ruajtjen e shëndetit të mësime dhënësve me gjendje të rënduar shëndetësore duke i zëvendësuar sa herë që kjo është e domosdoshme dhe e mundur; kushtet e pandemisë kërkojnë mobilizim të shtuar për mirëmbajtje (e llogaritur në rreth 100 norma të punëtorëve teknik /të mirëmbajtjes); njëkohësisht kërkohe përkrahje e shtuar psikologjike, pedagogë e të tjerë (baraz me 100 norma të psikologëve shkollor), me një kosto të gjithmbarshme të shpenzimeve të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë në shumë prej € 4,444,200.

SKENARI B: mësimi i kombinuar (mësim në shkolla dhe mësim në distancë)

Kërkohe investim në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim të shkollës – 2,582,000 euro (vlerësim në bazë të një praktike të mirë në Prizren). Përkrahja e shkollave për mbulimin e vëllimit të shtuar të punës dhe për zëvendësimin e mësime dhënësve me gjendje të rënduar shëndetësore (baraz me 1300 norma për të gjitha komunat), përkrahja në mirëmbajtje, shërbime psikologjike, pedagogjike e të tjera (gjithsej kosto € 4,444,200).

- Kërkohe po ashtu zhvillimi i mësimit online dhe në distancë: € 1,003,440 (MASH) € 337,790 (donatorë).
- Kërkohe blerja e pajisjeve teknologjike në vlerë prej 1,100,000 euro.
- Platforma e e-mësimit vlerësohe në kosto prej rreth € 2,600,000.

31 Qeveria e Republikës së Kosovës (26 gusht 2020). Vendimi nga mbledhja e 27-të e Qeverisë për aprovimin e Master planit për zhvillimin e mësimit në kushte pandemie për vitin shkollor 2020-2021. <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/08/Vendim-nga-mbledhja-e-27-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>

SKENARI C: mësimi online dhe në distancë

- Kërkohet zhvillimi i mësimi online dhe në distancë: € 1,003,440 (MASH) € 337,790 (donatorë).
- Kërkohet blerja e pajisjeve teknologjike në vlerë prej 1,100,000 euro.
- Platforma e-mësimi vlerësohet në kosto rreth € 2,600,000.

Ndërsa për **opsionin D** (opsion rezervë) janë planifikuar 180,000 euro. Master Plani për mësimdhënie gjatë pandemisë në vitin shkollor 2020-2021 nuk ofron hollësi të tjera rreth buxhetit për opsionin D, opsioni rezervë. Nga përshkrimi i buxhetit sipas skenarëve, shihet se buxheti i planifikuar për Skenarin A dhe B të mësimi për dy zëra buxhetor është i njëjtë: (i) investim në pastërti, mirëmbajtje dhe dezinfektim të shkollës – 2,582,000 euro; dhe (ii) Përkrahja e shkollave për mbulimin e vëllimit të shtuar të punës (gjithsej kosto € 4,444,200).

Ngjashëm, buxheti i planifikuar është i njëjtë për Skenarët B dhe C, e po ashtu edhe zërat buxhetorë për zhvillimin e mësimi, pajisjet e TIK-ut dhe platformën e-Mësimi. Nuk ka prova të ndonjë baze mbi të cilën janë llogaritur kostot për Skenarët B dhe C, duke marrë parasysh se Skenari B i referohet mësimi të kombinuar – mësim në shkollë dhe mësim në distancë (jo të gjitha shkollat mbajnë mësim në distancë), ndërsa Skenari C i referohet tërësisht mësimi në distancë.

Planifikimi i dytë (Përkrahja e shkollave për mbulimin e vëllimit të shtuar të punës) dallon në përshkrim, në raport me skenarët e mësimi, ku për skenarin A të mësimi, buxheti është planifikuar për 100 norma të punëtorëve teknik / të mirëmbajtjes dhe për përkrahje të shtuar psikologjike janë barazvlerësuar me 100 norma të psikologëve shkollor. Ndërsa për Skenarin B të mësimi, në vend të normave të punëtorëve teknik / të mirëmbajtjes buxheti është planifikuar të ndahet për zëvendësimin e mësimdhënësve me gjendje të rënduar shëndetësore. Kjo, sipas komunave dhe drejtorëve të shkollave, pothuajse ka qenë e papërfillshme.

Sipas raportit nga Departamenti i Arsimit Parauniversitar për kabinetin e Ministres së Arsimit (prill, 2021), i cili mbulon periudhën e mësimi shtator 2020 – prill 2021, për vitin 2020 buxheti i ndarë për nivelin qendror është 1,864,647€ dhe nivelin komunal 2,960,000€ dhe është alokuar për vitin shkollor 2020. Ndërsa për vitin 2021, buxheti i ndarë për nivelin qendror (MASHTI) është prej 1,401,512 €, kurse për nivelin komunal në vlerë prej 3,700,800€. Gjithsej buxheti i ndarë për dy vite për nivelin qendror dhe komunal është 9,926,959 €. Këto shuma sipas raportit janë ndarë nga buxheti i rimëkëmbjes ekonomike.

- Vendimi nr. 06/58, datë 14.01.2021³², pika 1.2. - masa 2 në MASHTI- janë ndarë mjete në shumën prej 5 milionë për mbështetjen e sektorit të arsimit për të mundësuar mbarëvajtjen e mësimi gjatë vitit shkollor 2020-2021.
- Vendimi nr. 08/65 i datës 18.02.2021³³. Me këtë vendim, përshkruhen shpenzimet e buxhetit të ndarë me vendimin paraprak nr.06/58 të datës 14.01.2021. Lidhur me këtë riformulohet si në vijim “Për sektorin e arsimit ndahen mjete shtesë financiare në vlerë prej 3,000,000.00 euro për pagesën shtesë së pari për mësimdhënësit dhe personelin teknik/administrativ në sistemin e arsimit parauniversitar për angazhimin e shtuar dhe të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj pandemisë Covid-19.

32 Qeveria e Republikës së Kosovës (01/2021). Vendimet nga mbledhja e 58-të e Qeverisë. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/01/Vendimet-e-Mbledhjes-se-58-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

33 Qeveria e Republikës së Kosovës (02/2021). Vendimet nga mbledhja e 65-të e Qeverisë. <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2021/02/Vendimet-e-mbledhjes-se-65-te-Qeverise.pdf>

Sipas raportit të MASHTI-it (prill, 2021), bazuar në vendimin nr. 08/65 i datës 18.02.2021, është paguar shtesa e parë 100 euro për mësimdhënës, teknik/administrativ, ku gjithsej pagesa ka qenë 3,000,000.00 euro. Ndërsa pjesa prej 2,000,000.00 euro janë mjete të lira të pashfrytëzuara. Lidhur me mjetet e lira nga MASHTI kërkohet që të ndahet shuma prej 1,665,941.00€ për mbulimin e obligimeve që dalin nga Master Plani i vitit shkollor 2020/21. MASHTI, u është nënshtruar shkurtimeve të mëdha buxhetore si në vitin 2020, ku vlera e shkurtimeve është 10,221,643.00€ si edhe në vitin 2021, në mallra dhe shërbime, vlera e shkurtimeve është 2,000,000.00€ nga buxheti i aprovuar për vitin 2021. Kjo bie në kundërshtim me këshillat e institucioneve ndërkombëtare si OKB dhe Banka Botërore për rritje të fondeve në arsim për të përballuar kostot shtesë që ka krijuar pandemia.

Pandemia Covid-19, në raport me sektorin e arsimit, e në mënyrë të veçantë me arsimin parauniversitar, ka pasur ndikim negativ edhe në ekonominë familjare për shkak të transportit të fëmijëve në dy ndërrime, masave shtesë për mbrojtje nga infeksioni si dezinfektues, maska, sigurimi i pajisjeve të TIK-ut etj.

Në anën tjetër, orientimi i politikave arsimore që në vitet e ardhshme të ketë grante të veçanta për shkollat përbën një mundësi për të mbështetur shkollat në mënyrë direkte, siç e përshkruan raporti i Bankës Botërore, për të lehtësuar kufizimet financiare që ndikojnë negativisht në cilësinë e të nxënësve. Kështu do të mund të përfitonin shkollat me numër më të madh të nxënësve nga grupet e cenueshme.

4.3 Koordinimi i institucioneve arsimore në organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë

Tashmë është e njohur se sistemi arsimor i Kosovës ishte plotësisht i papërgatitur për organizimin e mësimin në distancë në fazën e parë të pandemisë, si në aspektin e legjislacionit, materialeve mësimore digjitale dhe pajisjeve të shkollave me teknologji të TIK-ut, ashtu edhe në aspektin e kompetencave digjitale të mësimdhënësve për një ndërrim të shpejtë të qasjes në mësimdhënie, siç kërkuan rrethanat e krijuara nga pandemia. Megjithatë, respondentët e këtij raporti vlerësojnë se masat e ndërmarra në përgjigje të rrethanave të pandemisë dhe sigurimin e kushteve për përfundim të vitit shkollor 2019/2020 ishin adekuate dhe konform situatës, sipas përvojave nga vendet tjera. Edhe pse të vonuara në disa raste, sikurse udhëzimet lidhur për vlerësimin dhe sigurimin e kushteve për mësim online, ishin të mjaftueshme për përmblylljen e vitit shkollor.

Siç është përshkruar në pjesën hyrëse të këtij kapitulli, për fillimin e organizimit të mësimin në *distancë në formë të ndryshme (mars 2020)*, *institucionet arsimore, prindërit, mësimdhënësit, nxënësit dhe i gjithë komuniteti arsimor, treguan mobilizim dhe angazhim që mundësoi brenda një kohe të shkurtër, të vendoset një kornizë e mësimin në kushtet e pandemisë. Në këtë fazë, MASHTI ishte e shtyrë që në fillim të merrej më shumë me aspekte logjistike të përmbushjes së kërkesave të shkollave dhe mësimdhënësve. Kështu erdhi edhe deri te një lloj stabilizimi dhe përshtatjeje me situatën.*

Për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimin në distancë, krahas zhvillimit të dokumenteve, platformave mësimore dhe udhëzuesve të përshkruar më lart, MASHTI në bashkëpunim me DKA-të dhe me mbështetje të partnerëve, zhvilloi takime, konsultime, punëtori online me përfaqësues të komunitetit arsimor, përfshirë zyrtarë arsimorë nga MASHTI dhe DKA-të, udhëheqës të institucioneve arsimore, mësimdhënës, prindër dhe nxënës. Kështu vetëm me mbështetjen e GIZ-it janë mbajtur 10 ngjarje të tilla gjatë vitit 2020, në formatin e debateve publike. Në secilin nga këto debate janë trajtuar tema të veçanta për arsim më të mirë, në kushtet e pandemisë.

Përpjekjet që mbështesin zhvillimet në arsimin parauniversitar nga partnerët si UNICEF, GIZ, British Coun-

cil³⁴, KE, Projekti ALLED 2³⁵, Save the Children, KEC, etj., në përgjithësi nuk kanë munguar. Mirëpo, njohësit e arsimit, vlerësojnë se ka munguar një qasje koordinuese e punës me partnerët mbështetës dhe me DKA. Kjo ka rezultuar që disa nënsektorë të arsimit të mbulohej në shumë me mbështetje nga partnerët e jashtëm, diku edhe në fusha të njëjta apo komuna të njëjta. Për pasojë nuk është arritur që të sigurohet një minimum i mbështetjes për të gjitha komunat dhe shkollat në Republikën e Kosovës.

Që nga fillimi i pandemisë, në Kosovë janë ndërruar tri qeveri të nivelit qendror. Kjo ka bërë që edhe koordinimi i aktiviteteve nga niveli qendror të përshkruhet me ngecje, shtyrje të aktiviteteve të planifikuara dhe shpesh edhe me masa të vonuara të cilat në raste të caktuara kanë nxitur debate dhe kundërshtime në mesin e komunitetit arsimor, prindërve, SBASHK-ut, etj., siç është rasti me shtyrjen e fillimit të vitit të ri shkollor, përfundimin e periudhës së parë të mësimit dhe tani me organizimin e mësimit plotësues për kompensimin e humbjeve mësimore.

Edhe mënyra e informimit të komunitetit arsimor, publikimit të politikave e dokumenteve të zhvilluara në përgjigje të rrethanave të krijuara nga Covid-19 ka ndryshuar. Deri sa në fazën e parë të përgjigjes së rrethanave të krijuara nga Covid-19 MASHTI të gjitha masat e ndërmarra i ka publikuar në linkun e veçantë të faqes zyrtare të MASHTI-it, e-Mësimi, një gjë e tillë nuk ka vazhduar pas datës 24 tetor 2020 kur është publikuar udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020-2021. Të gjitha informacionet dhe vendimet lidhur me masat e MASHTI-it në përgjigje të pandemisë janë publikuar në linkun zyrtar për publikimet dhe në linkun zyrtar për vendimet e ministrit. Nga data 24 tetor, në linkun e veçantë të faqes zyrtare të MASHTI-it e-Mësimi nuk ka të publikuara dokumente mbështetëse për shkolla dhe mësimdhënës lidhur me çështjet që lidhen me mësimin në kushtet e pandemisë.

Përkundër angazhimit në përgatitje më të mira për fillimin e vitit të ri shkollor, në kushtet e pandemisë, sipas njërës nga njohësit e arsimit të intervistuar, dolën në shesh disa mangësi në hierarkinë e koordinimit të veprimeve, pasi që nuk pati koordinim cilësor ndërmjet palëve MASHTI-DKA-shkolla lidhur me identifikimin e përmbajtjeve mësimore më të rëndësishme për t'u mbuluar dhe munguan udhëzimet në aspektin e mbështetjes për mësimdhënës të cilët kishin pak, ose aspak, njohuri mbi përdorimin e platformave mësimore për organizim e mësimin online. (NjA/1).

Edhe sa i përket identifikimit të prioriteteve të intervenimit me qëllim ngritjen e cilësisë dhe përfshirjes, vlerësohet se nuk pati koordinim të mirë institucional dhe nuk u bë në mbështetje të një vlerësimi të procesit të mësimin në distancë në fazën e parë të pandemisë. Prandaj njohësit e arsimit e shohin si të domosdoshme bërjen e disa ndryshimeve në legjislacion për ta vendosur më qartë hierarkinë e vendimmarrjes në sistemin arsimor, sidomos në rrethana të jashtëzakonshme siç ishte epidemia me këtë virus.

Në anën tjetër, sipas SBASHK-ut, pandemia tregoi realitetin, që sipas tyre kjo organizatë e kishte thekuar shumë herë: Partitë politike vazhdimisht, por edhe institucionet, janë deklaruar se arsimin e kanë prioritet, por situata

34 Referuar intervistës me shkruar me Majlinda Mazelliu, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, British Council në kuadër të projektit "Shkollat e Shek. 21", ka vazhduar me ofrimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të udhëheqësve dhe mësimdhënësve të shkollave të mesme të ulëta në Kosovë në shkathhtësitë bazë të shekullit 21, që janë: Mendimi Kritik, Zgjidhja e Problemeve dhe Kodimi. Në kuadër të këtij programi secila shkollë ka fituar një numër të pajisjeve micro:bit - kompjuter xhepi me anë të të cilave nxënësit do të mund të programojnë në lëndë të ndryshme mësimore që të zgjidhin problemet e përditshme. Po ashtu, shkollat janë përkrahur të themelojnë klubet e kodimit ku nxënësit do të mësojnë kodimin në mënyrë praktike dhe do të kenë mundësinë të praktikojnë shkathhtësitë në programim kompjuterik, si dhe ato janë përkrahur me burime shtesë online për zhvillim profesional. Po ashtu kemi ri-akredituar në MASHTI katër programe trajnuese. Gjatë kësaj periudhe, programi Shkollat e Shek. 21 është angazhuar në përkrahje të MASHTI-it për menaxhimin e pandemisë duke zhvilluar programe trajnuese online për zhvillim profesional të punëtorëve arsimorë; duke ofruar një program televiziv për mësimin e gjuhës angleze dhe trajnime e webinarë online për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe përmirësimin e politikave të ministrisë, si digjitalizimi i sistemit arsimor, të cilat përkrahin punën gjatë pandemisë por edhe vendosin një bazë solide për vazhdimësinë e përmirësimin të sistemit të arsimit.

35 Projekti "Harmonizimi i Arsimit dhe i Aftësisë (trajnimin) me Nevojat e Tregut të Punës - ALLED Faza II" (ALLED2), mbështet 20 Shkolla Profesionale nga 17 komuna të Kosovës, në përafrimin e Arsimit dhe Aftësisë Profesional me Nevojat e Tregut të Punës. Projekti ALLED² mbështet rritjen e sigurimit të cilësisë në AAP, zhvillimin e kurrikulës, përmirësimin e performancës së shkollës dhe pajisjen e tyre me pajisjet e nevojshme.

aktuale në shkollat tona tregojnë se këto ishin vetëm deklarata. Shkollat tona nuk janë të pajisura me mjete të duhura të punës dhe kjo krijon vështirësi në arritjen e sukseseve më të mëdha. Sfidat janë të shumta e që dolën sheshit gjatë gjithë kohës së pandemisë. Shkollës i mungon autonomia e veprimit dhe për çdo angazhim duhet prituri e duhet bazuar në vullnetin e DKA-ve. Mungojnë mjetet që mundësojnë aplikimin e teknologjisë informative. Shumë shkolla nuk kanë qasje fare në internet, ndërsa një numër i konsiderueshëm ka qasje të pjesshme. Mësimdhënësit nuk janë mbështetur me mjete të punës gjatë gjithë pandemisë dhe ata, kur është kaluar në mësimin në distancë, është dashur të gjenden vetë, shpesh duke huazuar laptop për të realizuar mësimin me nxënësit e tyre.

Në anën tjetër, nga organizatat që merren me mbështetje të komuniteteve, ka vërejtje se disa nga politikat arsimore nuk janë hartuar në bashkëpunim me të gjithë akterët, hisedarët kryesorë. Theksi vihet tek komunitetet, ku përfaqësues nga organizatat që mbështesin komunitetet, shprehen se nuk janë marrë në konsideratë nevojat nga komunitetet dhe grupet e marginalizuara në zhvillimin e politikave arsimore, si dhe masat e vendosura nga niveli lokal nuk janë transmetuar si duhet tek qytetarët.

Çështje të përafërta ngrihen edhe nga një përfaqësues tjetër i partnerëve të arsimit:

Politikat e zhvilluara për nxënësit nga grupet e cenueshme kanë qenë relativisht të zbehta dhe jo adekuate, veçanërisht për disa kategori të fëmijëve me nevoja të veçanta, pasi mësimi online, kërkon kushte specifike dhe qasje specifike për të qenë i mirë për qafuar nga të gjitha grupet e cenueshme. Për shembull, fëmijët me nevoja të veçanta nuk kanë mundur të ndjekin të gjithë programin e mësimin online, jo vetëm për shkak të mungesës së teknologjisë por edhe vetë formatit që në raste specifike nuk ka qenë adekuat. Edhe pse donatorët kanë mundur të sigurojnë disa iPad dhe kompjuterë për fëmijët me nevoja të veçanta, mungesa e mjeteve digjitale si kompjuterë apo iPad ka sjelle probleme edhe për fëmijët që vijnë nga familje që jetojnë me ndihma sociale ose në zona shume rurale dhe kanë mungesë në teknologji. Po ashtu programet e mësimin online në gjuhën e komuniteteve boshnjake dhe turke kanë munguar dhe kjo ka mundur të shkaktojë ngecje në mësim për këto komunitete.

Në anën tjetër, sa i përket qasjes se institucioneve arsimore ndaj Arsimit dhe Aftësimin profesional, njohës të AAP theksojnë se është bërë përpjekje të gjinden modalitete të menaxhimit më të mirë edhe në këtë nënsektor të arsimit, *mirëpo, qasja ka qenë jo e duhur. Ka munguar një qasje më e koordinuar*, ndërsektoriale dhe me biznese. Gjithashtu, përshkruhet se AAP është një proces i komplikuar, kërkon angazhim të veçantë të të gjithë akterëve dhe shpesh edhe në kushte normale, nuk funksionon si duhet. Sipas njohësve të AAP, mësimdhënësit e AAP kanë njohuri dhe përvojë të mire teorike, mirëpo për fat të keq mungon pjesa e kompetencës dhe përvojës industriale dhe kjo nuk mund të arrihet përmes mësimin online, siç janë detyruar të punojnë një pjesë të madhe të kohës shkollat e AAP. Edhe në kushtet e pandemisë, s'ka AAP të mirë, pa përfshirje të bizneseve. Mësimi në vendin e punës është zgjidhja më e mirë, sepse mundëson që nxënësit shumë shpejt të nxënë atë që është humbur në pjesën teorike. Por, për ta arritur këtë, edhe në kushtet e pandemisë, nevojiten politika të qarta, qasje të koordinuar ndërsektoriale dhe me përfshirje të bizneseve, planifikim të detajuar të secilit veprim, qasje fleksibile me mundësi për vendime të shpejta, në përgjigje të rrethanave dhe kontekstit, siç është edhe pandemia.

Pavarësisht dobësive dhe paqartësive, mësimi në distancë ka ofruar një alternativë për vazhdimin e mësimin në kushte pandemie. Nga disa raste studimore, del se ky proces ka qenë përgjithësisht mirë i koordinuar mes autoriteteve të Ministrisë së Arsimit, komunave të Kosovës, drejtorive të shkollave dhe këshillave të prindërve. Një kontribut të madh kanë ofruar edhe organizatat jo qeveritare të cilat e kanë ndihmuar teknikisht procesin e mbarëvajtjes së mësimin në distancë³⁶.


36 Vesa Ferizi. (12/02/2021). Mësimi në distancë në kohë pandemie: rast studimi në komunën e Prizrenit, Obiliqit dhe Hanit të Elezit. Instituti GAP. Projekti "Inovacioni për mediat e qëndrueshme dhe angazhimin qytetar" i financuar nga BE. <https://www.institutigap.org/lajme/2696>

5. KTHIMI NË SHKOLLË DHE ZBATIMI I KURRIKULËS NË RRETHANAT E ORGANIZIMIT TË MËSIMIT GJATË PANDEMISË

Për t'i shqyrtuar veçoritë e kthimit në shkollë dhe organizimit të mësimimit në kohë pandemie, zbatimit të kurrikulës dhe aspekteve të tjera lidhur me mësimin në këto kushte, krahas analizës së dokumenteve dhe raporteve të lidhura me arsimin parauniversitar në këtë periudhë, janë marrë vështime nga akterë të ndryshëm, si mësimdhënës, drejtorë shkollash, zyrtarë komunal të arsimit si dhe njohës të rrethanave arsimore. Në këtë drejtim, nga përmbledhja e analizave dhe këndvështrimeve të ndryshme përshkruhet situata dhe nxjerrën përfundime për aspektet e trajtuara në këtë studim. Interpretimi i tyre është bërë në harmoni me çështjet e parashtruara për trajtim, të cilat pasqyrohen në pjesën në vijim të këtij kapitulli.

5.1 Organizimi dhe menaxhimi i mësimimit në kushtet e pandemisë - kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimimit sipas tre skenarëve

Kthimi në shkollë i nxënësve, personelit mësimdhënës, personelit menaxhues dhe përkrahës të shkollave dhe akterëve tjerë, ashtu si edhe në vendet tjera, edhe në Kosovë u bë me frikë dhe shqetësim nga virusi dhe përhapja e infeksioneve. Ballafaqimi me sfida të mëdha gjatë mësimimit në distancë në periudhën mars-qershor 2020, si për mungesë të përvojës për mësimin në situata pandemie, ashtu edhe për mungesë të pajisjeve të teknologjisë, qasjes cilësore në internet, platformave dhe materialeve mësimore digjitale, kompetencave digjitale të mësimdhënësve dhe nxënësve, etj., bëri që të shtohen kërkesat për kthim në shkollë si nga mësimdhënësit, prindërit dhe gjithë komuniteti arsimor.



Pritjet ishin që gjatë pushimit veror të bëhen përgatitjet e duhura për kthim në shkollë. Përkundër përgatitjeve të bëra në bazë të Master Planit për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës, nuk u arrit që mësimi të fillojë me 1 shtator, siç përcaktohet me kalendarin e vitit shkollor. Sipas informacionit të publikuar në faqen zyrtare të MASHTI-it, shtyrja e fillimit të vitit shkollor është bërë me qëllim të sigurimit të kushteve të sigurta për fëmijët, mësime dhënësit dhe prindërit, si dhe me qëllim që të sigurojë një mobilizim më të madh të përgjithshëm në përballje me pandeminë në Kosovë³⁷. Pavarësisht rreziqeve nga pandemia, fillimi me vonesë i vitit të ri shkollor tregoi se mekanizmat udhëheqës në arsim nuk kanë bërë përgatitjet e duhura që viti i ri shkollor të fillojë me kohë, dhe se ka munguar në masë të madhe harmonizimi i veprimeve në mes të nivelit qendror dhe atij komunal.

Fillimi i vitit të ri shkollor dhe kthimi në shkollë u arrit të bëhet me 14 shtator 2020, pas përgatitjeve shtesë për fillimin e vitit të ri shkollor, vizitave të ministrit të arsimit z. Ramë Likaj në një numër të madh të shkollave në rreth 30 komuna, inspektimeve të shkollave nga inspektorët e arsimit dhe ata sanitarë, ndihmës që ofruan USAID dhe UNICEF në sigurimin dhe shpërndarjen e materialeve mbrojtëse ndaj Covid-19 për një numër të konsiderueshëm të shkollave, mësime dhënësit dhe nxënësve.

Bazuar në informacionet e publikuara në faqen zyrtare të MASHTI-it nga takimet me akterët institucional dhe partnerët mbështetës për shqyrtimin e fillimit të vitit të ri shkollor dhe kthimin në shkollë, fillimisht me disa klasë prijëse në nivelin e parë dhe të dytë, vendimi për fillimin e vitit të ri shkollor nuk ka qenë aspak i lehtë, por kthimi i nxënësve në shkolla është vlerësuar se përbën interes të lartë shtetëror³⁸.

Kujdesi për mirëqenien e fëmijëve dhe të personelit shkollor gjatë pandemisë, ishte parim pune, masë preventive dhe masa kryesore për vazhdimin e mësimin në shkollë. Në takimet me bartësit e arsimit dhe me mekanizmat për nxjerrjen e vendimeve për mësimin në kushtet e pandemisë, drejtori i IKShPK-së, z. Naser Ramadani në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar rëndësinë e respektimit të tri rregullave themelore: mbajtja e maskës, distancës dhe higjienës. Parakusht për organizimin e mësimin në shkollë, ishte rikthimi nën kontroll i situatës epidemiologjike në vend. Kjo ishte kërkesë e vazhdueshme drejtuar qytetarëve të Kosovës në përgjithësi dhe komunitetit arsimor në veçanti.

Në anën tjetër, SBASHK-u shpesh ka reaguar ndaj përgjegjësisë së ndarë dhe ngarkesës së mësime dhënësit për matjen e temperaturës së nxënësve. Edhe pse sipas udhëzuesit mësime dhënësit nuk janë apostrofuar si përgjegjës për matjen e temperaturës. Sipas udhëzuesit, secila shkollë duhet të ketë termometër për matje të temperaturës dhe të angazhojë një person përgjegjës për matjen e temperaturës së nxënësve dhe të personelit të shkollës.

Të gjitha përpjekjet lidhur me kujdesin për mirëqenien e fëmijëve dhe të personelit shkollor gjatë pandemisë, janë zhvilluar në mbështetje të udhëzimeve për masat higjienike dhe mbrojtëse, rregullat e sjelljes dhe pasojat për organizimin shkollor, të integruara në udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë. Pikë referimi ishin dhe vazhdojnë të mbesin përgjegjësitë e caktuara dhe masat, lista e kontrollit dhe inspektimit.

Nga mënyra se si akterët përgjegjës kanë përmbushur përgjegjësitë e tyre, janë reflektuar edhe nivelet e respektimit të masave lidhur me përgatitjen e nxënësve për shkollë, udhëtimin për në institucionin arsimor përkatës,

37 Informimi zyrtar i MASHTI-it për shtyrjen e fillimit të vitit shkollor: Viti i ri shkollor fillon më 14 shtator 2020. <https://masht.rks-gov.net/article/viti-i-ri-shkollor-fillon-me-14-shtator-2020>

38 MASH dhe MSH vlerësojnë se institucionet arsimore janë të gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021. <https://masht.rks-gov.net/article/mash-dhe-msh-vleresojne-se-institucionet-arsimore-jane-te-gatshme-per-fillimin-e-vitit-te-ri-shkollor-20202021>

rregullat në oborrin e shkollës, rregullat brenda shkollës, rregullat në klasë, rregullat në sallën e mësimdhënësve. Në shkolla të ndryshme urbane, gati se kanë qenë të papërfillshme rregullat në oborrin e shkollës, në kohën e ndërrimeve të mësimit, nga prezenca e prindërve në nivelin fillor.

Kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimit sipas tre skenarëve – nga perspektiva e mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave. Siç është përshkruar më lartë, kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimit sipas tre skenarëve është bërë në përputhje me Protokollin e reagimit ndaj pandemisë Covid-19 **në shkolla, ku me këtë dokument janë** përcaktuar mënyrat e reagimit dhe menaxhimit të shkollave në rast të paraqitjes së rasteve të infektimit individual apo grupor të personelit ose fëmijëve/nxënësve.

Duhet theksuar se bazuar në sfidat e ballafaqimit gjatë mësimit në distancë në periudhën mars-qershor 2020, kanë qenë kërkesat e shtuara si nga mësimdhënësit ashtu edhe nga prindërit që fillimi i vitit të ri shkollor të jetë me kthim në shkolla, me respektim të masave dhe rregullave të përcaktuara nga IKSHP.

Kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimit sipas tre skenarëve nuk ka qenë fare i lehtë, siç pasqyrohet nga perspektiva e mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave. Gati të gjithë respondentët e shkollave të përfshirë në diskutimet në fokus grupe, e përshkruajnë situatën se si janë zbatuar skenarët e propozuar nga Ministria, por edhe sfidat me të cilat janë ballafaquar ata/to. Skenarët janë të njëjtë për të gjithë, por varësisht nga rrethanat me virusin është vendosur nga mekanizmat përkatës për skenarin e mësimit me të cilin duhet të punojë shkolla/t përkatëse.

Skenari A i mësimit përshkruhet të këtë qenë një mundësi e mirë drejtë përprjekjeve për kthim të normalitetit të mësimit, edhe pse përshkruhet se ky skenar i mësimit nuk është shfrytëzuar në mënyrën më të mirë nga shkollat që kanë pasur pak nxënës në klasa, për ta rritur kohën mësimore për orë mësimi. Ndërsa, skenarët e mësimit B dhe C përshkruhen të kenë qenë mjaft sfidues për realizimin e mësimit, për shkak të vështirësive me mësimin në distancë, si për mungesë të platformave mësimore, pajisjeve të kompjuterëve/laptopëve nga ana e nxënësve (pasi që vlerësohet se shumica e nxënësve mbajnë mësim në distancë me telefonona të mençur/celularë), mungesë të rrjetit të qëndrueshëm të internetit, ashtu edhe për mungesë të kapaciteteve të mësimdhënësve për të përdorur aplikacionet online në mënyrë interaktive gjatë punës me nxënës.

Në mungesë të platformave mësimore, pajisjeve teknologjike për të gjitha shkollat, disa shkolla dhe komuna kanë bërë përprjekje që këtë ta sigurojnë vetë. Një mësimdhënës pjesëmarrës në fokus grup e përshkruan situatën në shkollën e tyre si në vijim: Kemi punuar me platformën ZOOM, ku mësimdhënësit të cilët kanë pasur njohuri më të mira ia kanë përcjellë këto njohuri edhe mësimdhënësve tjerë. Drejtoria e shkollës i ka pajisur mësimdhënësit me pajisje teknologjike. Në shtator kemi filluar trajnime me bazë në shkolle për shfrytëzimin e platformës Zoom. (M/1). Po sipas të njëjtit mësimdhënës si lehtësim për organizimin e mësimit në distancë ishte se ‘Komuna ka të zhvilluar- flutura akademi – platformën për organizimin e mësimit online’.

Për rrjedhën e procesit të mësimit në kushtet e pandemisë, sipas skenarëve të mësimit të miratuar nga MASHTI, një nga mësimdhënësit pjesëmarrës në diskutimet në fokus grupe, shprehet se ka vërejtur shumë parregullsi organizative të mësimit. Sipas tij, edhe pse procesi mësimor ka hyre në fazën e adaptimit të nxënësve dhe mësimdhënësve, po ndjehet si formë normale e punës, po punohet me një orar të reduktuar në kohëzgjatjen e orës mësimore / 2x15 minuta bllok ore, duhet ta dimë se është duke u punuar pa ndonjë plan të qartë se çfarë na pret nga dita në ditë. Po ndjehet mos përgjegjësi nga gjithë akterët (M/6).

Sfidë për menaxherët e shkollës ishte zëvendësimi i stafit të prekur nga virusi, ose të cilët kishin edhe probleme të tjera shëndetësore dhe ishin në grupin e të rrezikuarve. Ndërsa sipas një drejtori të shkollës sfidë mbetet organizimi i mësimit online, pasi që ka mësimdhënës të cilët kanë problem të qasen për shkak të kushteve në shtëpi, ka mungesë gatishmërie të mësimdhënësve për t'u kyçur, njohuri të kufizuara të mësimdhënësve në shfrytëzimin e teknologjisë (D/2).

Në përgjithësi, pikëpamjet e drejtorëve po ashtu edhe të mësimdhënësve tregojnë për dallime nga shkolla në shkollë, dhe nga komuna në komunë, sa i përket **mënyrës** së organizimit të mësimit, kohës mësimore dhe adaptimit me këtë qasje të organizimit të mësimit. Madje në **raste të caktuara shfaqen** edhe pakënaqësi lidhur me nivelin e përgjegjësisë nga akterë **të ndryshëm që kanë rol në këtë proces**.

Kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimit sipas tre skenarëve, nga perspektiva e Drejtorive Komunale të Arsimit. Menaxhimi i mësimit në kohë pandemie dhe menaxhimi i situatës kanë qenë sfidat e shtetit dhe të DKA-ve në veçanti. Po themi në veçanti pasi që të gjitha vendimet për sjellje dhe veprim në kohë pandemie janë marrë nga lart. Prandaj është krijuar edhe njëfarë kulture e pritjes 'çka do vijë nga lart' pasi që vendimmarrja duhet të vijë nga niveli shtetëror, pa menduar se çfarë mundet dhe duhet të bëjë edhe niveli komunal/DKA.

Referuar intervistave më shkrim me zyrtarët e arsimit në DKA, DKA-të kryesisht janë marrë me çështje të logjistikës, furnizim me materiale higjienike, por edhe me mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së shkollave. Duhet theksuar se nuk kanë munguar përpjekjet e DKA për të siguruar apo vendosur që puna e shkollave dhe mësimdhënësve gjatë mësimit në kushtet e pandemisë të bëhet përmes platformave që kanë arritur të zhvillojnë me mbështetje të partnerëve më të cilët kanë bashkëpunuar, si me platformën digjitale "*e-Shkollori*", "*Flutura akademi*", etj. Ashtu siç nuk kanë munguar përpjekjet e disa DKA që të mbështesin shkollat edhe përmes formave të ndryshme të këshillimit e përkrahjeve profesionale.

Sipas DKA/3, 'Zyrtarët e arsimit në mënyrë të vazhdueshme kanë mbështetur shkollat me këshilla profesionale, në funksion të menaxhimit sa më të mirë të mësimit në distancë'. Gjithashtu, kjo DKA përveç mbështetjes nga zyrtarët komunal, kanë bërë marrëveshje edhe me psikologët e fakultetit që t'u ofrojnë ndihmë e mbështetje edhe nxënësve në mënyrë që ta zbusin ndikimin negativ të pandemisë në mirëqenien e nxënësve.

Jo të gjitha DKA-të kanë arritur që të kenë një platformë mësimore unike në nivel të komunës, ashtu sikur edhe jo të gjitha DKA kanë arritur të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për shkollat me pajisje të teknologjisë informative, internet të qëndrueshëm, trajnime të stafit për ngritjen e kompetencës digjitale të mësimdhënësve, e cila vlerësohet si tejet sfiduese për ta organizuar mësimin online, sipas udhëzimeve për skenarët e mësimit B dhe C.

Sipas zyrtarëve arsimor në DKA, një numër i caktuar i mësimdhënësve nuk kanë qenë në gjendje të përdorin pajisjet për mësim në distancë për disa arsye: nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme për teknologji, nuk kanë pasur pajisje dhe qasje në internet, ose edhe kanë qenë të moshuar. Ka zyrtar arsimor që janë kritik edhe ndaj vet autoriteteve lokale, siç shprehet (DKA/4) 'as vet qeverisja komunale nuk iu ofroi asgjë mësimdhënësve', prandaj mungesat për përcjellje të mësimit në distancë janë të mëdha.

Sipas DKA-ve, gjatë mësimit në kohë pandemie sfidë ka qenë angazhimi i mësimdhënësve dhe personelit tjetër në shkolla, me theks të veçantë në gjetjen e zëvendësimeve për mësimdhënësit e infektuar si dhe mësimdhënësit me sëmundje kronike. Kryesisht zëvendësimet e mësimdhënësve janë bërë me stafin ekzistues brenda shkollave për shkak të procedurave burokratike të rekrutimit dhe numrit të lejuar të punëtorëve arsimor (DKA/1), edhe pse për këtë ishin ndarë mjetet buxhetore.

Lidhur me organizimin e mësimit, zyrtarët e DKA-ve shohin edhe disa përparësi, përveç sfidave. Këtë e ndërlikojnë me mobilizimin e institucioneve edukativo-arsimore për të gjetur format më të mira të mundshme të organizimit të mësimit sipas specifikave të institucionit dhe situatës aktuale me pandemi. Gjithashtu, vlerësohet se pozitive ka qenë edhe forma e komunikimit me akterët e përfshirë si DKA, SIA, organet shkollore, prindërit, etj. Sipas DKA/5, si gjë shumë pozitive e shohin gatishmërinë e të gjithë mësimitdhënësve për të marrë pjesë në procesin mësimor pa marrë parasysh skenarin e organizimit të tij. Ndërsa si sfida për ta ishte pasiguria në aspektin e pritshmërisë se si të veprohet në situata të papritura, si dhe pamundësia e mbulueshmërisë së orëve mësimore në rastet kur kishte mësimitdhënës të infektuar me Covid-19.

Nga DKA/6 marrin informata për laramani në organizimin e mësimit dhe kohëzgjatje të orës mësimore. Në disa shkolla ora zgjatë 30 e në disa 25 minuta. Prandaj si çështje problematike ata e shohin realizimin e planit dhe pamundësinë e ofrimit të njohurive të nevojshme për nxënësit. Ndërsa si shqetësuese paraqesin: “Mungesa e mësimitdhënësve mbështetës për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe pamundësia për zhvillimin e aktiviteteve të lira dhe organizimin e garave të diturisë dhe garave tjera” (DKA/6).

Sa i përket çështjes përmbajtjesore të procesit mësimor në kushtet e pandemisë, punës me nxënës dhe ngarkesa e tyre dhe e mësimitdhënësve, nga DKA nuk ofrohen argumente apo të dhëna më të thelluara, por vetë fakti se është punuar nën presionin e pandemisë dhe të frikës për infeksion me virusin paraqet një rrethanë stresi e ngarkesë psikologjike të nxënësve dhe të mësimitdhënësve.

Mungesa e të dhënave të thelluara për procesin mësimor në kushtet e pandemisë, le të kuptohet se DKA-të më shumë janë fokusuar në aspektet logjistike të organizimit të mësimit në kushtet e pandemisë, se sa në përmbajtjen e procesit mësimor dhe mjediset e të nxënësve në raport me skenarët e mësimit me të cilët kanë punuar shkollat në komunat e tyre.

Kthimi në shkollë dhe organizimi i mësimit sipas tre skenarëve – nga perspektiva e njohësve të arsimit.

Rikthimi në shkollë ishte sfida më vete. Përveç domosdoshmërisë për përgatitje teknike, pedagogjike dhe administrative, dolën në shesh edhe paralajmërimet për ndërrimet politike. Nisi një garë e panevojshme për ose kundër kthimit në shkollë, kush kishte më shumë apo më pak të drejtë, por edhe pyetjet se a është më mirë të kthehen nxënësit në shkollë apo të vazhdohet sipas skenarëve të hartuar nga ministria (A,B,C). Në njërin anë ishte ministria dhe institucionet e shëndetit të cilët arsyetonin kthimin në shkollë me shtim të masave të kujdesit, në anën tjetër sindikata bënte thirrje për shtyrje të kthimit në emër të ruajtjes së shëndetit të mësimitdhënësve. Kjo vetëm sa shtoi dilema dhe hutitë të nxënësve dhe prindërve, edhe pse të dyja palët kërkonin kthim në shkollë. Për shkak të rrethanave të krijuara, sidomos ndërrimi i qeverive, ka ndikuar edhe në përgatitjet e mirëfillta për rifillim ose rikthim në shkollë. Sidomos mungesa e bashkërendimit të veprimeve midis akterëve të sistemit ka ndikuar në çrregullimin dhe mbjelljen e hutisë të nxënësve, prindërve por edhe tek vetë mësimitdhënësve.

Boshllëqet e komunikimit ndër-institucionale ndikuan për të keq, por edhe mobilizuan nismat individuale të mësimitdhënësve, dhe të disa drejtorëve, për adresimin e kthimit në shkollë. Secila shkollë kishte të formuar Task Forcën për ta vlerësuar situatën dhe për të dalë me qëndrim të qartë për procesin. Por kjo trupë kishte më tepër karakter dhe funksion teknik se sa organizativ.

Sipas njërit nga njohësit e arsimit të intervistuar me shkrim, ajo çfarë mungoi gjatë tërë procesit është komunikimi dhe mbështetja e drejtpërdrejtë nga MASHTI dhe DKA për mësimitdhënësve. Nuk pati mbështetje profesionale të domosdoshme e të nevojshme për mësimitdhënësve. Nuk pati ‘qendër/forum për adresim të pyetjeve

dhe paqartësive' lidhur me mësimdhënien dhe vlerësimin gjatë kohës që mësimi organizohej sipas njërit apo skenarit tjetër. Pati vetorganizim nga mësimdhënësit nëpërmjet rrjeteve sociale, por asgjë dhe asnjë nismë nga qendra (MASHTI ose DKA) (NjA/1).

Sipas njohësve të arsimit, Master Plani për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë, ishte një dokument mjaft ambicioz dhe orientues për masat dhe veprimet që duhet ndërmarrë gjatë këtij viti shkollor. Mirëpo sipas tyre, nuk u zbatua deri në fund, ashtu siç ishte paraparë në raport me pajisjet me TIK, rregullimin e procedurave të qarta për zëvendësimin e personelit mësimor me probleme shëndetësore dhe të infektuar me virus, ofrimin e mundësive për të gjithë mësimdhënësit në ngritjen e kompetencave digjitale, materialet mësimore digjitale, sigurimin e përkrahjes në shërbime psikologjike dhe pedagogjike, monitorimin e mësimin në kushtet e pandemisë, etj. Kjo ndodhi për shkak të mos koordinimit të mirë, por edhe ndryshimeve politike që pasuan. Patjetër që rrethanat e krijuara, por edhe orientimi më shumë në kujdesin për shëndetin e nxënësve, në shumë raste edhe kanë penguar përkushtimin e plotë ndaj realizimit të përmbajtjeve të kurrikulës. Për këtë nuk ka të dhëna të sakta as nga shkollat, se sa është realizuar dhe se sa janë humbjet mësimore në përmbajtje.

5.2 Mësimi dhe platformat mësimore të përdorura nga shkollat

Plani për përgatitjen dhe ofrimin e e-Mësimin, mësimin në distancë për klasat 1-9 për vitin shkollor 2020-2021 në Republikën e Kosovës, është zhvilluar nga Instituti Atomi, në korrik të vitit 2020³⁹. Plani është përgatitur për e-Mësimin në gjuhën shqipe, por i njëjti, me reduktime e modifikime të nevojshme sipas specifikave, mund të përdoret edhe për e-Mësimin në gjuhët e komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë.

Sipas përshkrimit, plani është hartuar bazuar në përvojën dhe praktikën e e-Mësimin të ofruar gjatë periudhës mars-qershor 2020 në Kosovë, duke propozuar zgjidhje për shumë probleme e të meta që e kanë përcjellë këtë proces gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, në mënyrë që e-Mësimi që ofrohet për vitin shkollor 2020-2021 të jetë më mirë i përgatitur, më gjithëpërfshirës dhe më cilësor.

Plani për e-Mësimin është i organizuar në gjashtë kapituj:

- 1 Aktivitetet e menjëhershme përgatitore që duhet të ndërmarrë MASHTI;
- 2 Struktura, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë proces;
- 3 Fushat kurrikulare, lëndët dhe fondi i orëve që do të përfshihen në e-Mësimi;
- 4 Fillimi i vitit shkollor, kohëzgjatja, volumi i përgjithshëm dhe orari ditor e javor i e-Mësimin;
- 5 Protokoli i detajuar për përgatitjen, kontrollimin, xhirimin, konfirmimin dhe publikimin e video-ligjëratave dhe materialeve të tjera mësimore; dhe
- 6 Udhëzime për komunikimin e rregullt mes mësimdhënësve dhe nxënësve.

39 Plani është përgatitur në kuadër të Projektit "Mbështetje për hartimin e një strategjie të mirë-planifikuar për digjitalizimin e sistemit të arsimit në Kosovë", i cili realizohet me fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Sipas planit, në raport me numrin e orëve mësimore është planifikuar që në klasat 1-9 të realizohen mbi 84% e orëve mësimore, nga totali i orëve mësimore në javë. Tabela në vijim pasqyron një përmbledhje të këtij planifikimi sipas klasave.

Tabela 1. Numri i orëve mësimore të planifikuara për klasat 1-9

	Klasa									Totali
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	
Total orë në javë të parapara me Planin Mësimor	21	21	23	24	24	29	30	30	30	232
Total orë në javë të përfshira në eMësimi	16	17	19	19	19	25	27	27	26	195
Total orë në javë të pa përfshira në eMësimi	5	4	4	5	5	4	3	3	4	37
Përqindja e orëve në javë të përfshira në eMësimi	76.19	80.95	82.61	79.17	79.17	86.20	90.00	90.00	86.67	84.05

Bazuar në Planin për e-Mësimin, MASHTI ka angazhuar 43 mësimdhënës për arsimin fillor (klasat 1-5), 62 mësimdhënës për arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) për realizimin e e-Mësimit, sipas klasave dhe lëndëve mësimore/fushave kurrikulare, si dhe 16 auditor dhe 4 lektorë.

Bazuar në Planin për e-Mësimin, protokollin për përgatitjen, kontrollimin, xhirimin, konfirmimin dhe transmetimin/publikimin e video-ligjëratave dhe materialeve të tjera mësimore, si dhe Udhëzuesin metodologjik për mësimdhënësit dhe redaktorët e angazhuar për realizimin e e-Mësimit të hartuar nga IPK, është mbajtur trajnimi i 59 mësimdhënësve të angazhuar për e-Mësimin. Nuk janë përfshirë në trajnim të gjithë mësimdhënësit, sepse nuk është arritur që sipas planit të angazhohen me kohë të gjithë mësimdhënësit e planifikuar.

E-Mësimi për vitin shkollor 2020-2021, është koordinuar nga tre koordinatorë, Koordinatori i Përgjithshëm i e-Mësimit, koordinatori për klasat 1-5 dhe koordinatori për klasat 6-9. Sipas intervistës me shkrim me Koordinatorin e përgjithshme për e-Mësimin, Drejtorja e Komunale e Arsimit në Prishtinë dhe Ekipi profesional i trajnerëve sipas fushave kurrikulare nga DKA Prishtinë, kanë përgatitur planifikimet për realizimin e e-Mësimit, dhe njëkohësisht hartimin e planifikimeve në nivel të vendit për vitin shkollor 2020-2021. Gjithashtu, sipas kësaj interviste, mësimdhënësit e angazhuar kanë treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm, edhe pse ka pasur shumë hezitime dhe nuk kanë shprehur gatishmëri për të marrë pjesë. Vlen të theksohet që mësimdhënësit

kanë qenë kryesisht nga komuna e Prishtinës, edhe pse janë kontaktuar mësimdhënësit nga komunat tjera. Sipas koordinatorës së përgjithshme për e-Mësimin, interesimi i tyre ka qenë tepër i ulët, sepse ishte sfiduese përgatitja dhe incizimi i orëve në të njëjtën ditë kur mësimdhënësit njëkohësisht kishin mësim në shkollat e tyre.

Për realizimin e e-Mësimin është bërë një punë e madhe, diku rreth 6,800 njësi mësimore janë realizuar gjatë kësaj periudhe. Procesi i punës përshkruhet të ketë qenë mjaft sfidues, si për koordinimin e aktiviteteve, ashtu edhe për mësimdhënësit e angazhuar, për shkak të presionit të kohës, por edhe për shkak të kushteve teknike të organizimit të xhirimeve në lokalet e Fakultetit të Edukimit.

e-Mësimi është në funksion të cilit do skenar të mësimin. Kundrejt shkollave që punojnë me Skenarin A të mësimin (mësimi në shkollë), shkollat të cilat punojnë me Skenarin B të mësimin dhe veçanërisht me Skenarin C të mësimin, janë të detyruara që mësimin ta zhvillojnë në përputhje me e-Mësimin që ofrohet përmes RTK dhe në kanal in e MASHTI-t në YouTube, si dhe përmes aplikacioneve e platformave mësimore të përdorura nga shkollat.

Edhe pse mësimet nga organizimi 'aksidental' i mësimin (mars 2020), shtruan nevojën për zhvillimin e një platforme mësimore në nivel shtetëror, një platformë e tillë nuk u arrit të plotësohet as për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, prandaj serish e-Mësimi u fillua të ofrohet përmes RTK.

Krahas e-Mësimin, disa shkolla dhe mësimdhënësit kanë përdorur edhe platforma private të mësimin. Sipas raportit për analizën e gjendjes paraprake për Strategjinë e Digjitalizimit të Arsimit në Kosovë 2021-2026, disa nga platformat private, si School Me⁴⁰, Akademi Albania⁴¹, Edukimi Net⁴², etj., janë përdorur dhe janë duke u përdorur nga shkollat e nxënësit për qëllime të mësimin, disa me pagesë e disa falas, varësisht prej politikave të platformës dhe varësisht prej marrëveshjeve që kanë me institucionet shtetërore qendrore e lokale në Kosovë.

Në mungesë të një platforme mësimore në nivel shtetëror, një numër i komunave dhe shkollave filluan ta marrin vetë situatën në dorë dhe të përdorin platforma të zhvilluara me partnerët apo me vetë iniciativë (E-Shkollori, Flutura), mirëpo edhe ato në shumicën e rasteve sipas mësimdhënësitve dhe drejtorëve të shkollave të përfshirë në këtë studim, nuk funksiononin si duhet. Për të përmbushur nevojat dhe kërkesat për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë (më shumë për Skenarin C të mësimin), edhe gjatë këtij viti shkollor mësimdhënësit vazhduan të punojnë me platforma/aplikacione të ndryshme, si Zoom, Teams, Viber, E-mail, Google Classroom, Skype.

Në anën tjetër, sipas raportit të MASHTI-it për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë (shtator 2020 – prill 2021), zyra e UNICEF-it në Kosovë ka mbështetur MASHTI-in për të zhvilluar platformë digjitale të mësimin shkollat.org përmes Platformës Globale të njohur si Pasaporta e mësimin, e cila është zhvilluar me një partneritet midis UNICEF, Microsoft 365 dhe Universitetit të Kembrixhit (platforma është lansuar me 1 Shkurt 2021⁴³). Sipas raportit, platforma shkollat.org përfshin qasje në video tutorial të përafuar me programin shkollor kombëtar të arsimit, ndërsa aktualisht ofron 14,000 video me përmbajtje arsimore cilësore për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë (që mbulojnë të gjitha fushat e lëndëve për klasat fillore dhe të mesme të ulët - klasat 1 deri

40 <https://www.schoolme.education/landing/>

41 <https://www.akademi.al/>

42 <http://www.edukimi.net/>

43 Fillimisht, lansimi zyrtar është bërë me datën 20 prill 2020 shiko [linkun](#) dhe nga kjo periudhë është përdorur për mësim plotësues dhe mësim jo formal në kuadër të projekteve Ponder, Podium dhe Up Shift me mbështetje të UNICEF. Pastaj, në dhjetor të vitit 2020 Ministri i Arsimit në bashkëpunim me UNICEF akordohen që kjo platformë të shfrytëzohet për tërë arsimin parauniversitar. Lansimi zyrtar i fundit është bërë me datën 1 shkurt 2020, për më shumë info [linkun](#).

në 9), ofron hapësirë për ndërveprim për nxënësit dhe mësuesit, dhe është krijuar dhe ndërtuar në funksionet dhe aftësitë më të mira të Microsoft 365⁴⁴. Për më tepër, sipas raportit, pritet që 345,000 nxënës në Kosovë të kenë adresën e tyre unike të e-mailit emrin.mbiemri@shkollat.org, e cila është në zhvillim e sipër me ndihmën e bashkëpunimit të ngushtë me drejtoritë komunale të arsimit dhe drejtorët e shkollës dhe nxënësit (deri tani janë krijuar rreth 200,000 email adresa në bashkëpunim me MASHT, DKA dhe shkolla).

5.3 Realizimi i kurrikulës në kohë pandemie dhe humbjet mësimore

Covid-19 ka ndryshuar papritmas jetën e organizimit të punës së shkollës, mënyrën e punës së mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollë, duke krijuar një rutinë të re në përpjekje për të përmbushur pritshmëritë në mësim të përcaktuara me dokumentet kurrikulare, si dhe një orientim të ri për të gjetur modalitetet të realizimit të kurrikulës në kushte dhe mjedise të reja të nxënësve, si në shkollë ashtu edhe në shtëpi.

Në kapitullin e tretë të këtij raporti janë pasqyruar disa të dhëna lidhur me orientimet për institucionet arsimore që ofron Udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-it për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19, duke përfshirë edhe ato për zbatimin e kurrikulave. Kurse, udhëzimet dhe orientimet më të detajuara për zbatimin apo realizimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë dhe dallimet në mundësitë e zbatimit të kurrikulës nga perspektiva e skenarëve të mësimin me të cilët institucionet arsimore kanë punuar gjatë këtij viti shkollor, do të trajtohen në pjesën në vijim, duke përfshirë edhe humbjet mësimore.

Realizimi i kurrikulës në kohë pandemie

Udhëzuesi i përgjithshëm udhëzon që objektivat e shkollës dhe të arsimit parauniversitar do të vazhdojnë të jenë të drejtuara edhe në kushte të emergjencës kah realizimi i kompetencave kryesore. Po ashtu, Udhëzuesi i përgjithshëm parasheh që arritja e kompetencave dhe rezultateve të të nxënësve të fushës (RNF) dhe të lëndëve të caktuara (RNL) është e mundshme të bëhet edhe me numër të reduktuar të njësive mësimore (deri në 80%) sipas një plani të mirë organizuar mësimor dhe me qasjen e mësimin të integruar. Mirëpo, nuk ofrohen udhëzime specifike se si duhet të bëhet kjo, cilat tema duhet hiqen nga 20 % i reduktimit të përmbajtjeve programore, kush duhet ta bëjë dhe kur, si të merren për bazë zhvillimet e vitit shkollor paraprak në raport me realizimin e kurrikulave në këtë vit etj.

Në anën tjetër, ajo çka është parashikuar me Udhëzuesin e përgjithshëm, nuk përputhet me Planin për e-Mësimin. Sipas këtij dokumenti, planifikimi i përmbajtjes programore për t'u realizuar për vitin shkollor 2020-2021, për klasat 1-9 është paraparë të jetë 75%. Sipas Planit për e-Mësimin, përfshihen "shtatë fushat kurrikulare për të gjitha klasat 1-9", me "së paku mbi 75 % ose mbi 3/4 e fondit të orëve mësimore". Ky orientim i planifikimit të përmbajtjeve programore i referohet planit të propozuar në udhëzuesin për e-Mësimin, sipas të cilit janë përgatitur dhe shfaqur njësitë mësimore në RTK.

Planifikimi dhe organizimi i mësimin në të gjitha fushat kurrikulare, siç parashihet me dokumente kurrikulare, në kushte normale të punës në shkollë, nga një njohës i arsimit i përfshirë në këtë studim, shihet si një hap i

44 Sipas Veton Alihajdari, Koordinator i qendrës Kosovare të ndërmarrjeve praktike (firma ushtrimore) në MASHTI, Platformat Microsoft 365 për edukim dhe pasaporta e të nxënësve ndërveprojnë në kuadër të domain shkollat.org dhe janë platforma të centralizuara dhe gjenerojnë të dhëna të ndryshme në harmoni me General Data Protection Regulation (GDPR) mbi 250 politika duke e mbrojtur privatësinë.

ngutshëm dhe i pa menduar mirë, sipas të cilit: Synimi institucional që në kushte të kufizimeve në mësimdhënie të mbulohen të gjitha fushat kurrikulare vlerësoj që ishte i paarsyeshëm, i pa menduar, dhe i dëmshëm për mësimdhënie. Argument për këtë është ngecja e identifikuar tek nxënësit dhe vet vendimi i MASHTI për mësimin plotësues për këto fusha vetëm (NJA/3).

Duhet theksuar se planifikimet mësimore për lëndë dhe fusha kurrikulare (klasat 1-9) të hartuara nga grupet profesionale të DKA në komunën e Prishtinës, për e-Mësimin, për RTK, përdoren edhe nga shkollat gjatë mësimin në shkollë, pavarësisht llojit të skenarit të mësimin me të cilin kanë punuar, apo numrit të orëve mësimore javore për lëndë dhe klasë që i mbajnë. Gjithsesi, me mundësi të rishikimit apo ndryshimit në bazë të specifikave të shkollës përkatëse. Mirëpo një gjë e tillë nuk raportohet që është duke ndodhur në shkolla gjatë mësimin në kushtet e pandemisë.

Në anën tjetër, duke iu referuar raportit të Departamentit të Arsimit Parauniversitar (prill 2021), lidhur me zhvillimet në arsimin parauniversitar në kohë pandemie, për periudhën shtator 2020 – prill 2021, lidhur me zhvillimet në zbatimin e kurrikulës pasqyrohen vetëm dy aspekte, përqindja e planifikimit të përmbajtjeve kurrikulare dhe punën e bërë për formimin e komisionit profesional për menaxhimin e procesit të dorëshkrimeve të teksteve shkollore për klasat 3, 8 dhe 12 si në vijim:

- Planifikimi i përmbajtjes programore për t'u realizuar për klasat 1-9 është paraparë të jetë 75%, pra është i reduktuar për 25%.
- Sipas Planit për e-Mësimin, përfshihen “shtatë fushat kurrikulare për të gjitha klasat 1-9”, me “së paku mbi 75 % ose mbi 3/4 e fondit të orëve”, ku “të gjitha lëndët kryesore në e-Mësimin duhet të përfshihen me fond të plotë të orëve (përveç lëndëve që kanë mbi 5 orë në javë)” dhe duke zvogëluar fondin e orëve për 30% në lëndë të caktuara, të cilat për shkak të karakteristikave specifike janë të vështira të realizohen përmes mësimin në distancë.
- Është formuar komisioni profesional për menaxhimin e procesit të dorëshkrimeve dhe rishikimin e udhëzimeve për recensent për vlerësim dhe raportim për klasat 3, 8, 12 dhe atyre të mbetura pa vlerësuar nga viti 2019: për klasën 7 lënda Art dhe Kimi, për klasën 10 lëndët Gjeografi, Edukatë Fizike, Sport dhe Shëndet, dhe për klasën 11 Edukata Fizike, Sporti dhe Shëndeti.

Edhe pse viti shkollor 2020-2021 ka vazhduar me probleme të njëjta sa i përket teksteve të reja, hartimit të tyre në bazë të kurrikulës së re, Shtëpia Botuese Dukagjini ka mundur qasje në formatin elektronik për tekstet shkollore. Kjo është bërë në mbështetje të mësimdhënësve dhe të gjithë shqiptarëve në diasporë dhe kudo në botë⁴⁵. Formatin elektronik i teksteve shkollore, u mundëson mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve që të përdorin tekstet shkollore gjatë mësimin online.

45 Shtëpia Botuese Dukagjini: <https://librat.net/>

Sipas drejtorëve të shkollave dhe mësimeve, shkollat lidhur me zbatimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë kanë marrë vetëm udhëzuesin e përgjithshëm dhe planifikimet vjetore dhe për periudha mësimore (për lëndë dhe fusha kurrikulare) nga grupet profesionale të DKA së Prishtinës. Realizimi i planifikimeve mësimore është përshkruar si një proces mjaft sfidues, për shkak të mospërshtatjes me specifikat dhe mundësitë e shkollave të tyre për ta realizuar atë, por edhe për shkak të skenarëve me të cilët shkollat janë detyruar të punojnë kur kanë pasur raste të infektiveve.

Kishte shkolla, sipas drejtorëve, që nuk kanë marrë ndonjë udhëzim për punë në rrethana pandemie sa i përket reduktimit të kurrikulës ose planifikimit konform rrethanave të krijuara. Ata kryesisht iu kanë përmbytur udhëzimeve të institucioneve shëndetësore sa i përket mbrojtjes nga infektimi.

Mësimeve nuk e kishin shumë të qartë se çfarë dhe si është dashur të planifikohet në kushte të jashtëzakonshme. Shumica prej tyre hedhin fajin te menaxhmenti, ose institucionet për paqartësi. Vetëm M/8 deklaroi 'Planifikimi në fillim ishte i vështirë, por pastaj në bashkëpunim me pedagogun e shkollës dhe duke u bazuar në Master planin për punë, ia kemi dale të planifikojmë mësimin diku me 75% në klasë, e diku me 50% me rotacion të fushave mësimore nëpër javë (M/8).

Mësimeve tjerë janë mbështetur në disa forma të planifikimit të realizuara nga DKA e Prishtinës, por nuk vërehet ndonjë nismë e bërë nga shkolla ose mësimeve, qoftë në aktive profesionale ose individualisht. Edhe mësimeve sikurse edhe drejtorët fajin e hedhin te të tjerët të cilët nuk kanë dalë me sqarime të qarta sa i përket planifikimit të mësimoreve në kushte pandemie.

Sa i përket realizimit të planifikimeve mësimore, zbatimit të kurrikulës, mësimeve pjesëmarrës në diskutimin me fokus grup, shprehen se kanë sfida të shumta, si për mungesë të udhëzimeve si t'i qasen reduktimit të përmbytjeve kurrikulare dhe realizimit të gjitha fazave të orës mësimore në kohëzgjatje 25-30 minuta, ashtu edhe për mungesë të përvojës për të përzgjedhur thelbin e njësive mësimore për të arritur rezultatet e të nxënësve. Nga mënyra se si përshkruhen qasjet praktike të punës me nxënës në kushtet e pandemisë, duket se në kushtet e pandemisë, mësimeve është në qendër, jo nxënësve. Kështu përshkruhet nga një mësimeve:



Duhet të jemi real në mësimeve, gjatë kësaj kohe të mësimin në kushtet e pandemisë, në mësimeve kemi qenë në qendër, jo nxënësve. Më shumë jemi fokusuar në arritjen e programit zyrtar, se sa në përcjelljen e përparimit të nxënësve, ofrimin e mbështetjes për nxënës, krijimin e mjedisit të të nxënësve mundësues për zhvillimin e kompetencave edhe në këto kushte të mësimin....(M/4)

Situatë afërsisht e njëjtë përshkruhet edhe në intervistën me një nga hulumtueset e IPK e cila gjatë periudhës prill – maj, ka vëzhguar 18 orë mësimore/18 mësimdhënës të ndryshëm, në kuadër të studimit *Shkathtësitë gjuhësore të nxënësve të grup moshave 9-13 dhe 14-18 dhe ndikimi i tyre në cilësinë e përgjithshme në arsim me fokus në rezultatet e testimit ndërkombëtar PISA 2018*. Sipas saj:



Vërehej në masë të madhe se kishte një nguti nga ana e mësimdhënësve në realizimin e aktiviteteve të planifikuara, por që duket se nxënësit kanë filluar të adaptohen me një qasje të tillë. Diskutimet me nxënës në orë mësimore (pyetje-përgjigje të shkurtra) bëhen sidomos në pjesën hyrëse e përfundimtare të orës mësimore, ndërsa në pjesën kryesore të orës mësimore kombinohet puna frontale me punën individuale e që fokusi kryesor është puna me tekstet mësimore, jo interaktivitet me nxënës. Në raste shumë të rralla ka mendim kritik. Edhe rezultatet mësimore janë hartuar në nivelin e njohjes, nuk ka argumentim dhe reflektim kritik. Pjesa e vlerësimit është lënë anash. As nuk është e paraparë në përgatitjet ditore mënyra e vlerësimit formativ, përveç kriterëve të suksesit të cilat në pjesën dërmuese nuk janë përcaktuar qartë, por që edhe këto nuk respektohen në aktivitetet me nxënës, ku në shumicën e rasteve ndryshojnë me kërkesat që parashtrohen tek nxënësit. Puna me grupe nxënësish të ndarë nga një klasë/paralele e njëjtë sipas protokollit për numrin e nxënësve në klasa, paraqitet problematike për grupin e dytë, ku sipas mësimdhënësve të vëzhguar po krijohet një monotoni në realizimin e përmbytjeve të njëjta (puna realizohet me planifikimin e njëjtë edhe pse struktura e nxënësve është e ndryshme), po vërehet disbalancë e përvetësimit të përmbytjeve mësimore të nxënësit e grupeve të ndryshme. Sipas tyre “shumë më efektive është puna me grupin e parë, edhe rezultatet të nxënësit janë më të mira”. Pamundësinë e një orari fleksibil dhe pamundësinë e një pushimi për mësimdhënësit mes dy grupeve, mësimdhënësit i shohin si problematike për shkak të ngarkesës dhe lodhjes që ata e ndjejnë.

E njëjta gjë konfirmohet nga disa mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave pjesëmarrës në diskutimet me fokus grupe. Sipas tyre, mësimi me dy ndërrime për një paralele të nxënësve, me një orar 25-30 minuta për orë mësimi, ishte sfidë në vete, sepse duhej të shpejtohej me realizimin e programit dhe nxënësit në masë të madhe nuk kanë arritur të marrin sasinë e duhur të mësimëve, kjo edhe për faktin se për shkak të kushteve të pandemisë nuk ka pasur ndërveprim të mjaftueshëm në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve. Gjithashtu, u theksua se në shkolla vërehet presioni i ngarkesës mësimore dhe frikës nga infeksioni, gjë që ka sfiduar zbatimin e kurrikulës, sipas planeve të mësimimit për këtë vit shkollor.

Në anën tjetër, shikuar nga perspektiva e DKA-ve, sa i përket planifikimit të mësimëve dhe zbatimit të kurrikulës, vërehet se DKA-të nuk kanë njohuri të mjaftueshme se çfarë ndodhë në shkolla. Deklaratat e DKA-ve sillen rreth organizimit të trajnimeve për planifikim si dhe pengesat që janë shkaktuar me shkurtrimin e orës mësimore. Disa e ndërlidhin zbatimin e kurrikulës me mungesën e kushteve, gjë që nuk ka ndonjë ndërlidhje midis zbatimit dhe pajisjeve teknologjike për çka mendojnë ata.

Edhe në pjesën e përshkrimeve në intervistat me shkrim me zyrtarët arsimor në DKA, lidhur me realizimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë, shihet se përqendrimi dhe orientimi i DKA ishte kryesisht në aspektet e zbatimit të kërkesave logjistike dhe rregullave të organizimit në kushte pandemie e më pak në organizimin e brendshëm të procesit mësimor. Sipas DKA-ve duhet pranuar se shkollat dhe DKA-të nuk tregojnë prirje për të marrë vendime konform rrethanave pasi që është krijuar përshtypja se duhet pritur çka po vjen nga lartë.

Përqendrimi vetëm në aspektet organizative dhe në planifikimet mësimore për zbatimin e kurrikulës, si në dokumentet për organizimin e këtij viti shkollor, ashtu edhe nga raportet e analizuara dhe këndvështrimet e drejtorëve, mësimdhënësve dhe DKA-ve, tregojnë se nuk ka një fokus të mbikëqyrjes, mentorimit dhe raportimit për zbatimin e kurrikulës në aspektet përmbajtjesore, të metodologjisë së punës, shfrytëzimit të materialeve dhe burimeve mësimore, vlerësimit të nxënësve, etj.

Referuar studimit të Institutit Pedagogjik të Kosovës për Përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë, si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve (2019), zbatimi i kurrikulës në shkallë vendi deri në vitin shkollor 2018-2019, kishte arritur një nivel të ndjeshëm institucionalizimi, nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave lëndore për klasë, trajnimit të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës dhe organizimit të procesit mësimor në bazë të planit mësimor për kurrikulën e re në klasat ku zbatohet. Gjithashtu, studimi ka identifikuar disa mangësi që kanë të bëjnë me udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, nga niveli qendror deri në nivel shkollë, cilësinë e trajnimeve dhe mbështetjes së shkollave në zbatimin e kurrikulës, mungesën e teksteve shkollore, etj.

Vazhdimi i zbatimit të kurrikulës në rrethanat e pandemisë, me paqartësitë në udhëheqjen e procesit të zbatimit të kurrikulës, me dallimet e mësimdhënësve dhe shkollave në pranimin e filozofisë së kurrikulës së bazuar në kompetenca, mungesën e teksteve të reja shkollore, por edhe me mungesën e mbështetjes sistemore për zbatimin e kurrikulës së re, është reflektuar në masë të madhe edhe në zbatimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë, siç përshkruhet më sipër.

Arritjet e nxënësve dhe humbjet mësimore


Pandemia COVID-19 pritet të ketë ndikim domethënës në performancën e nxënësve, të ndikojë në humbjet mësimore dhe në krijimin e pabarazive në mësim. Me konceptin e humbjes mësimore apo “learning loss”, nënkuptohen humbjet e njohurive dhe shkathtësive apo ngecjet e nxënësve në progresin akademik që mund të jetë si rezultat i ndërprerjes së mësimin për arsye të ndryshme përfshirë: pushimet verore, braktisja e përkohshme e shkollimit, mungesat e shumta, si dhe mësimdhënia jo-efektive.

Në nivel të institucioneve arsimore në Kosovë, janë ngritur debate dhe diskutime lidhur me mundësitë e arritjeve të nxënësve gjatë mësimin në kushtet e pandemisë dhe humbjet mësimore⁴⁶. Mirëpo, nuk është bërë ndonjë studim i veçantë, i cili do të ishte si një pikënisje për ndërmarrjen e masave për sanimin e pasojave dhe përkrahjen e nxënësve në kompensimin e humbjeve mësimore. Divizioni për standarde dhe vlerësime, ka vazhduar me përgatitjet për mbajtjen e testit të arritshmërisë dhe të Maturës Shtetërore, si dhe me përgatitjet për pilotimin e testeve ndërkombëtare PISA 2022 dhe PIRLS 2021, pa ndonjë fokus të veçantë se si do të qasen vlerësimeve të nxënësve me qëllim identifikimin e niveleve të humbjeve mësimore.

46 Një diskutim më gjithëpërfshirës është organizuar me iniciativë nga GIZ, në kuadër të debatit të gjashtë publik, të organizuar me 6 gusht 2020.

Referuar rezultateve të maturës për vitin 2020 (testi i arritshmërisë për klasën 9, nuk është mbajtur në vitin 2020), shohim se në raport me kalueshmërinë, për 3% është shkalla më e lartë e kalueshmërisë në provimin e maturës në afatin e parë në vitin 2020, kundrejt afatit të njëjtë në vitin 2019. Ndërsa, shkalla e arritshmërisë në të gjitha lëndët është mbi 2% më e ulët në vitin 2020, kundrejt vitit 2019.

Tabela 2. Rezultatet e maturës sipas viteve shkollore



Referuar qëllimit të provimit të maturës, formatit dhe mënyrës së organizimit, rezultatet më sipër janë një tregues i rëndësishëm për analizën e humbjeve mësimore. Kujtojmë se shkalla e arritshmërisë nën 50%, e konvertuar në notat e vlerësimit të sistemit tonë arsimor, është e barabartë me notën 2 (mjaftueshëm). Megjithatë këto rezultate nuk mund të merren si referencë kryesore për analizë të humbjeve mësimore në këtë nivel të arsimit, kur kemi parasysh qëllimin e provimit të maturës.

Raportet dhe studimet ndërkombëtare lidhur me humbjet mësimore janë një bazë më e mirë për ta orientuar në mënyrë të argumentuar debatin dhe fokusin institucional në adresimin e humbjeve mësimore, sidomos referimi në raporte që kanë besueshmëri të lartë dhe që i referohen edhe kontekstit të Kosovës, siç janë raportet e Bankës Botërore.

Kështu, referuar raportit të rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor, *Vlerësimi i ndikimit të Covid-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigjja e vendeve*⁴⁷, pavarësisht reagimit të shpejtë të sistemeve arsimore, humbjet në procesin e të nxënësve do të jenë të pashmangshme dhe të konsiderueshme, duke prekur në mënyrë shpërpjesëtimore grupet e cënueshme, ku një pjesë e nxënësve do të bien përsëri në analfabetizëm funksional dhe mbase edhe do ta braktisin shkollën.

47 Flora Kelmendi, James Gresham dhe Syedah Aroob Iqbal (2020). Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor: Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigjja e vendeve. Banka Botërore. <https://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>

Sipas raportit të Bankës Botërore për vlerësimin e humbjeve mësimore, humbjes së të nxënësve, ndikimi i përllogaritur i Covid-19 mbi të nxënësve në Ballkanin Perëndimor, do të jetë afatshkurtër dhe afatgjatë. Sipas raportit, nëse nuk ka mësimdhënie në distancë, të nxënësve në Ballkanin Perëndimor do të ulje mesatarisht me 16 pikë PISA ose 40 % të vitit shkollor. Ndërsa nëse ka përfshirje në mësimdhënie në distancë, dhe duke supozuar se mësimdhënia në distancë nuk është aq efektive sa mësimdhënia ballë për ballë, pritet të jetë një ulje prej rreth 9 pikë PISA ose 22.5% të vitit shkollor. Gjithashtu, sipas raportit, mbyllet e shkollave do të thellojnë pabarazinë në të nxënësve, e cila ishte e madhe dhe para mbylles së shkollave. Hendeku i arritjeve ndërmjet nxënësve më të varfër dhe më të pasur, në rastin e Kosovës pritet të jetë në afërsisht 2 vjet. Ndërsa, shumë nxënës mund të rikthehen në analfabetizëm funksional.

Edhe rezultatet e studimit nga Kristof De Witte & Joana Elisa Maldonado⁴⁸, të kryer me nxënësit e klasave të gjashta (kl.6), në Flanders dhe rajonin e Brukselit, me teste të standardizuara (validuara) nga Edukimi Katolik Flanders (IDP), për të përshkruar ndryshimin në arritjet e nxënësve dhe pabarazinë për shkak të krizës COVID-19, tregojnë për shkallë të lartë të humbjeve mësimore dhe rritje të lartë të pabarazisë në mësim, të barasvlershme (krahasuara) me gjashtë muaj shkollë. Ndërsa pabarazia në rezultatet e testeve brenda shkollave u rrit me 17% për matematikën dhe 20% për holandishten.

Edhe në dokumentin *Letër e bardhë: Përshpejtimi i mësimin me kuptimplotë - Mësimi i bazuar në projekte*, publikuar nga Defined Learning⁴⁹, pasqyrohen evidencat lidhur me humbjet mësimore. Sipas këtij dokumenti, në një studim nga organizata globale e konsulencës McKinsey & Co, i cili analizoi të dhënat e vlerësimit nga një platformë të mësuarit digjital për nxënësit e klasave K-8, zbuloi se nxënësit e kësaj klase kanë arritur të mësojnë vetëm 67 % të matematikës dhe 87 % të leximit. Sipas këtij dokumenti, mesatarisht, raporton McKinsey, nxënësit kanë humbur ekuivalentin e tre muajve të mësuarit në matematikë dhe një muaj e gjysmë të mësuarit në lexim. Humbjet mësimore theksohet se janë më të mëdha në shkollat që kanë nxënës nga grupet e cenueshme, siç janë nxënësit e minoriteteve, ku nxënësit nga këto shkolla kanë arritur 59 % në matematikë dhe 77 përqind në lexim.

Në anën tjetër, të dhëna interesante pasqyrohen në studimin e bërë nga autorët zviceran Martin J. Tomasik , Laura A. Helbling , Urs Moser⁵⁰, lidhur me fitimet arsimore nga mësimi në distancë në shkollat fillore dhe të mesme në Zvicër. Në kuadër të këtij studimi janë krahasuar arritjet mësimore në 8 javët e mbylles së shkollës për shkak të Covid-19 në Zvicër me arritjet mësimore në 8 javët para mbylles në lëndën e matematikës dhe të gjuhës gjermane (lexim dhe gramatikë). Për këtë studim janë përdorur të dhëna nga sistemi i informatave kthyes formative/formuese në formën elektronike (computer-based formative feedback system), duke përfshirë analizat statistikore të përdoruesve aktivë të sistemit MINDSTEPS⁵¹ të cilët përfunduan të paktën një vlerësim të gjeneruar. Studimi tregon se nxënësit e shkollës së mesme mbeten kryesisht të paprekur nga mbyllja e shkollës për sa i përket arritjeve të të nxënësve, për nxënësit e shkollës fillore , të nxënësve ngadalësohet dhe në të njëjtën kohë rritet ndryshimi ndër-individual në arritje. Sipas këtij studimi, format e mësimin në distancë duken si një mjet efektiv për të zëvendësuar mësimin me prezencë në institucione arsimore, të paktën në një situatë emergjente, por jo të gjithë nxënësit përfitojnë në të njëjtën shkallë.

48 Kristof De Witte & Joana Elisa Maldonado (shtator, 2020). Kriza e COVID-19 dhe mbyllja e shkollave, efektet në performancën e nxënësve dhe në pabarazinë arsimore. <https://www.katholiekonderwijs.vlaanderen/engels>

49 Defined Learning: <https://www.eschoolnews.com/resource-library/combating-learning-loss-by-engaging-students-in-meaningful-pbl/>

50 Martin J. Tomasik , Laura A. Helbling , Urs Moser (24 November 2020). Educational gains of in-person vs. distance learning in primary and secondary schools: A natural experiment during the COVID-19 pandemic school closures in Switzerland. <https://onlinelibrary.elsevier.com/doi/full/10.1002/ijop.12728>

51 MINDSTEPS është një sistem i informatave kthyes formative i bazuar në kompjuter, i zhvilluar në Institutin për Vlerësimin Arsimor në Cyrih dhe në shërbim për të gjithë nxënësit në kantonet e Aargau, Basel - Stadt, Basel - Landschaft dhe Solothurn dhe për shumë nxënës nga kantonet e tjera gjermanisht folëse të Zvicrës. Ai u shërben nxënësve nga klasa 3 deri në 9 dhe përfshin lëndët e matematikës, gjermanishten (gjuha zyrtare), anglisht dhe frëngjisht (dy gjuhë të huaja që mësohen në shkolla), sipas programit zyrtar të shkollës.

Në kontekstin e arsimit në Kosovë, në mungesë të analizave dhe raporteve të veçanta për nivelet e humbjeve mësimore gjatë periudhës së mësimimit në distancë, duhet të merren treguesit e indikatorëve nga raportet e mësipërme, në mënyrë të veçantë nga raporti i Bankës Botërore. Në raport me skenarët e mësimimit më të cilët kanë punuar shkollat në Kosovë, pritet të reflektohen edhe nivelet dhe shkallët e humbjeve mësimore.

Në anën tjetër, nëse marrim për bazë punën e shkollave me orar të shkurtuar të orëve mësimore, për punë me dy ndërrime me klasë të njëjta, ku orët mësimore janë mbajtur max. me 25-30 min. i bie që nxënësit tanë edhe në numër të orëve të mbajtura kanë humbur kohë mësimore për rreth 33%. Kjo kohë mësimore më pak, mund të jetë mbuluar te pjesa e angazhimit individual të nxënësve, pasi që grupet e klasave kanë qenë me numër të nxënësve nga 15–20 nxënës, si dhe në bazë të mjedisit të nxënimit të krijuar nga shkolla/mësimdhënësit dhe familja.

Me këtë formë të punës mësimdhënësit janë ngarkuar me dy turne të së njëjtës klasë/paralele, ndërsa efektiviteti me grupin e dytë ka rrezik që ka qenë më i ulët, kundrejt grupit të parë dhe ka rrezik në thellimin e pabarazive.

Shkollat dhe klasat që kanë mbajtur mësim me skenarët B (rikthim i pjesshëm - mësim i kombinuar me prezencë në shkollë dhe mësim në distancë) dhe C (mësim në distancë - TV + e-mësimi), supozohet se kanë shkallë më të lartë të humbjeve se shkollat dhe klasat të cilat kanë punuar me skenarin A (mësim në shkollë).

Humbjet mësimore konfirmohen edhe nga respondentët e përfshirë në këtë studim, por pa tregues të matshëm të bazuar në analiza në nivel të shkollave, komunave apo në shkallë vendi. Sa i përket aspektit të humbjeve mësimore dhe arritjeve të nxënësve, mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, shprehen në forma të ndryshme, me pajtueshmërinë se humbjet mësimore janë evidente dhe i shohin tek nxënësit e tyre. Mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave kanë dallime kur flasin për klasat që konsiderojnë që nxënësit kanë humbje mësimore në shkallë më të lartë dhe gjithnjë i referohen punës së vet dhe asaj që ata kanë arritur për ta parë gjatë kësaj periudhe, d.m.th. nuk tregojnë se ka analiza në nivel të aktivave profesionale apo në nivel shkolle në raport me humbjet mësimore të nxënësve gjatë mësimimit në kushtet e pandemisë dhe nuk kanë ndonjë orientim se si do të punojnë me nxënës në kompensimin e humbjeve mësimore.

Për humbjet mësimore referojnë edhe zyrtarët arsimor në DKA, të cilët shprehin mendimin se organizimi i mësimimit në rrethana pandemi më së shumti ka prekur nxënësit. Mirëpo, kryesisht këtë e ndërlikojnë me numrin e nxënësve të cilët zyrtarisht nuk kanë marrë pjesë në mësim në fazën e parë të mësimimit në distancë, nuk ofrojnë ndonjë të dhënë tjetër për shkallën e humbjeve mësimore në komunat e tyre, ndonjë analizë të bërë për arritjet dhe humbjet e nxënësve gjatë mësimimit në kushtet e pandemisë.

Për shkak të mungesës të një sistemi për raportimin e humbjeve ende nuk dihet me saktësi se sa janë humbjet mësimore në gjithë sistemin arsimor. Njëri ndër njohësit e arsimit të intervistuar këtë çështje e sheh si: 'nuk kemi sistem standard për matjen e humbjeve, prandaj edhe mbështetja eventuale është me rrezik të jetë ad-hoc dhe jo e bazuar në nevoja të nxënësve (NjA/1), prandaj edhe nismat për plotësimin e humbjeve, ose masat për zvogëlimin e tyre në të ardhmen po ngjallin reagime.

Të gjithë njohësit e intervistuar mendojnë se nga pandemia kemi mësuar shumë për mangësitë si të funksionimit të sistemit, përfshirë aspektet organizative dhe të kompetencës profesionale. Nga këto mangësi duhet nxjerrë mësim në mënyrë që të na shërbejnë për përmirësimin e sistemit dhe të performancës së shkollës në përgjithësi.

Në përgjigje të nevojave për kompensimin e humbjeve mësimore, MASHTI ka nxjerrë vendim të veçantë⁵² për organizimin e mësimin plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve të nxënësve si pasojë e pandemisë Covid-19. Sipas vendimit organizimi dhe mbajtja e mësimin plotësues ka filluar nga data 03.05.2021 dhe do të vazhdojë deri në fund të vitit mësimor 2020-2021. Fokusi i mësimin plotësues do jetë me lëndët, matematikë, gjuhë amtare dhe shkencave të natyrës, ku nxënësit kanë nevojë më shumë për mbështetje.



Për humbjet mësimore referojnë edhe zyrtarët arsimor në DKA, të cilët shprehin mendimin se organizimi i mësimin në rrethana pandemi më së shumti ka prekur nxënësit. Mirëpo, kryesisht këtë e ndërlidhin me numrin e nxënësve të cilët zyrtarisht nuk kanë marrë pjesë në mësim në fazën e parë të mësimin në distancë, nuk ofrojnë ndonjë të dhënë tjetër për shkallën e humbjeve mësimore në komunitet e tyre, ndonjë analizë të bërë për arritjet dhe humbjet e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e pandemisë.

52 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2021). Vendimi nr.01B/22, datë 20.04.2021 për r organizimin e mësimin plotësues për nxënësit që kanë ngecje në arritjen e rezultateve të nxënësve si pasojë e pandemisë COVID 19 <https://masht.rks-gov.net/uploads/2021/04/vendimi-me-nr-603-dka-ve.pdf>

6. PËRFSHIRJA NË MËSIM E FËMIJËVE/NXËNËSVE NGA GRUPET E CENUESHME GJATË PANDEMISË

Qasja në arsim është një e drejtë themelore që duhet të sigurohet për të gjithë fëmijët pa dallim, pra edhe në rrethanat e organizimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Të gjithë udhëzuesit dhe dokumentet tjera ta zhvilluara nga MASHTI me partnerët që mbështeten në vazhdimësinë e mësimin dhe mirëqenien e nxënësve në arsimin parauniversitar, e mbështesin këtë të drejtë themelore.



Organizimi i mësimin dhe përfshirja e të gjithë fëmijëve në mësim në kushtet e pandemisë, ka qenë sfidë dhe vazhdon të mbetet sfidë për arsimin në Kosovë. Krahas me këtë, sfidë në vete është edhe përfshirja në mësim e fëmijëve/nxënësve nga grupet e cenueshme gjatë pandemisë. Sipas Insidehighered (2020) tashmë e dimë që mësimi online nuk funksionon mirë për të gjithë nxënësit, sidomos për ata të grupeve të marginalizuara, edhe në kushte normale. Por këto nuk janë kushte normale⁵³.

Disa nga të gjeturat e hulumtimit të Institutit Pedagogjik të Kosovë për Mësimin në distancë (IPK, maj 2020) tregojnë se fëmijët nga grupet e marginalizuara janë ballafaquar me shqetësim e stres, kryesisht për shkak të pamundësisë teknike për ndjekje të duhur të mësimin në distancë, si pasojë e mungesës së pajisjeve të nevojshme. Sipas raportit të këtij studimi, vështirësitë kryesore lidhen me mungesën e pajisjeve të TI për nxënës, ku shumë familje nga grupet e marginalizuara nuk kanë asnjë laptop, tablet ose kompjuter, e shpesh disa fëmijë të një familje e kanë poseduar vetëm një telefon të mençur në dispozicion për mësim në distancë.

Ngjashëm, gjetjet e studimit *Ndikimi i pandemisë Covid-19* në edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin parauniversitar tregojnë se periudha e pandemisë, e ndërlidhur me izolimin në shtëpi, mungesën e socializimit, ndryshimin e rutinës ditore dhe mungesën e shërbimeve kanë ndikuar negativisht në gjendjen emocionale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, duke kontribuar në ngarkesë dhe stres të prindërve. Sipas këtij studimi, faktorë të shumtë kanë ndikuar në nivelin e ulët të gjithëpërfshirjes dhe përfitimeve nga mësimi online i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore gjatë pandemisë. Për të përmirësuar cilësinë e edukimit, gjithëpërfshirjen dhe mundësitë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, rekomandohet adaptimi i kurrikulës dhe i programeve të mësimdhënies përkritazi me nevojat individuale, trajtim i barabartë për të gjithë nxënësit, zhvillim profesional të mësimdhënësve, ofrim i shërbimeve brenda shkollës, si dhe përfshirje dhe mbështetje të prindërve në edukimin e fëmijës⁵⁴.

Përpjekjet e institucioneve arsimore në Kosovë për krijimin e kushteve për përfshirje në mësim të nxënësve nga grupet e marginalizuara nuk kanë munguar, përkundër argumentit se nevojitet më shumë punë në mënyrë që të sigurohet përfshirja në mësim e fëmijëve/nxënësve nga grupet e cenueshme gjatë pandemisë. Kështu, referuar raportit të MASHTI për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë (raportit për periudhën shtator 2020 – prill 2021), për rritjen e përfshirjes së komuniteteve në sistemin e arsimit, MASHTI në bashkëpunim me donatorët ka vazhduar të ofrojë bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta. Kështu, MASHTI në bashkëpunim me partnerët REF dhe VORAE për vitin shkollor 2020-2021 ka ndarë 596 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (MASH ka ndarë 333 bursa në vlerë prej 100.000 Eurosh, REF 103 bursa dhe VoRAE 160 bursa).

Sipas njërit nga përfaqësuesit të partnerëve mbështetës të arsimit të intervistuar me shkrim, ndonëse Ministria e Arsimit dhe DKA-të kanë arritur që të reagojnë shpejtë në ofrimin e mësimin në distancë, masat dhe praktikat nuk kanë qenë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse dhe disa nevoja specifike të fëmijëve nga grupet e cenueshme nuk janë adresuar sa duhet.

53 Insidehighered (2020). "A do të ndihmojë apo lëndojë mësimin online kalimi i pjesës më të madhe në mësim në distancë" – Përmblendje e panelit të ekspertëve. <https://www.insidehighered.com/digital-learning/article/2020/03/18/most-teaching-going-remote-will-help-or-hurt-online-learning>

54 Dr. Zamira Hyseni Duraku & MSc Mirjeta Nagavci (2020). Ndikimi i pandemisë COVID-19 në edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin parauniversitar. https://www.researchgate.net/publication/343323273_Ndikimi_i_pandemise_COVID-19_ne_edukimin_e_nxenesve_me_aftesi_te_kufizuar_ne_arsimin_parauniversitar

Në anën tjetër, lidhur me përfshirjen në mësim gjatë pandemisë të fëmijëve/nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, u theksua se :

- Institucionet zbatuan qasje të ngjashme për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh nevojat specifike të familjeve nga grupet e cenueshme (gjendja socio-ekonomike, qasja në internet, pajisja me teknologji).
- Programi online (mësimet e ofruara përmes TV) nuk ofronte mundësi mësimi për të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë. Për disa fëmijë nuk ishte e kuptueshme për shkak të ndryshimeve në metodologjinë dhe strukturën e mësimdhënies.
- Pjesëmarrja në mësim e fëmijëve nga komunitetet pakicë, si dhe e shumë fëmijëve të tjerë me të ardhura të ulëta, ishte e ulët. Për shkak të pjesëmarrjes së ulët, performanca e shumicës së këtyre fëmijëve pritet të jetë e ulët. Pjesëmarrja e ulët është e lidhur me mungesën e internetit, teknologjisë, por edhe me mungesë të materialeve mësimore.

Sa u përket grupeve të cenueshme, edhe në kushte normale ato kanë nevojë për mbështetje dhe për përkrahje të shtuar. Pandemia nxori në pah edhe grupe të tjera të cilat në kushte normale nuk konsideroheshin si të tilla. Fëmijët e familjeve me më shumë fëmijë kishin sfida me pajisjet si dhe me orarin e shfrytëzimit të tyre, pasi që ishte gati e pamundur një përshtatje e orarit të mësimave nga ana e mësimdhënësve. Prindërit e tyre në mungesë të mjeteve për t'i pajisur me teknologji, i anashkallonin dhe nuk shprehnin interesim për ndjekjen e mësimi online nëpërmjet internetit. Institucionet nuk arritën të depërtonin te këto familje për t'u ofruar ndihmë. Këtë e adreson edhe NjA/1:



Në fakt, gjatë kësaj periudhe, edhe koncepti 'grupe të cenueshme' ndryshoi sepse dolën në shesh mangësitë dhe nevojat e sistemit dhe shumë grupeve sociale të cilat patën nevojë për ndihmë. Ishte përqindje e lartë e raportuar nga MASHTI/DKA e nxënësve të cilët kishin qasje në internet mirëpo nuk kishin pajisje me të cilat do të përfshiheshin në mësimin online.

Ndërsa NjA/2, përveç mos pajisjes me mjete të nevojshme, e sheh si problematike edhe se '...ishin të papërkrahur në nxënie si përshtatje me metodologjitë e të mësuarit në këto metoda'. Kjo ndodhi kështu pasi që 'Masat e ndërmarra kanë qenë uniforme për të gjithë nxënësit' (NjA/3), përjashto këtu Qendrat Burimore, ku mobilizimi ka qenë më i mirë në përkrahje të këtyre nxënësve.

Ministria hartoi Udhëzues për të ndihmuar institucionet arsimore, mirëpo sipas (NjA/4) nuk dihet nëse këto udhëzime e udhëzues depërtuan tek të gjithë mësimdhënësit dhe shkollat, por edhe si u zbatuan këto me fëmijët e grupit të cenueshëm, pasi që jo të gjitha grupet e marginalizuara janë përfshirë në masa mbështetëse (zonat rurale, sidomos ato të thella rurale, nuk kanë qasje në kabllorë dhe/ose internet, familjet që kanë më shumë se dy fëmijë në shkollë, për fëmijët/nxënësit femra, ata pa prindër/kujdestarë, për të rikthyerit së fundmi, etj.).

Të gjitha institucionet, edhe vetë shkollat, kanë sfida dhe mangësi, në grumbullimin, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave për nxënësit si dhe për familjet e tyre, të dhënat e nevojshme që lidhen me shkollimin e fëmijëve. Ky fakt paraqiti probleme shtesë në kohë pandemie, ku shumë nxënës kishin mungesë të pajisjeve të teknologjisë dhe qasjes në internet. Kjo më shumë u reflektua për fëmijët që vijnë nga familje që jetojnë me ndihma sociale ose në zona të thella rurale. Krahas interesimit për mbështetje me materiale higjienike, mirëmbajtje të hapësirave, donatorë të ndryshëm kanë shprehur interesim dhe kanë siguruar iPad ose kompjuterë për fëmijë, por ishte e pamundur që në fillim të sigurohej për të gjithë fëmijët të cilët kishin nevojë.

Në anën tjetër, nevojat për mbështetje të fëmijëve përtej pajisjeve me teknologji dhe internet, janë në rritje. Për sigurimin e asistentëve në kushte të mësimin në distancë, nga shtëpia, as që mund të bëhej fjalë në këto rrethana. Edhe në kushte normale në shkolla ende nuk sigurohet asistencë për këta nxënës kur ata mësojnë në klasa të rregullta.

Njohësi tjetër i arsimit (NjA/7) adreson një varg mangësish të sistemit për t'i përmbushur nevojat e grupeve të cenueshme të nxënësve. Reagimi institucional ishte i shpejtë dhe me vend, por pastaj sa i përket ndihmës për këta nxënës kishte shumë mangësi, siç janë mesazhet vetëdijesuese mbi shëndetin dhe higjienën nuk ishin të qasshme dhe të kuptueshme për fëmijët me dëmtime shqisore dhe intelektuale. Një ndihmesë të mirë e kanë dhënë donatorët/organizatat e jashtme, siç ishin BE-KE (projekti "INCLUDE"), GIZ dhe Save the Children, të cilët përveç pajisjeve ofruan edhe ndihmë në trajnime dhe udhëzime për mësimdhënës se si t'iu qasen grupeve të cenueshme edhe në kohë pandemie.


Sipas përfaqësuesit të një organizate partnere në arsim, ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare për pjesëmarrjen dhe arritjet e fëmijëve/nxënësve nga grupet e cenueshme në arsim gjatë pandemisë: *ndërprerja e mësimin direkt në institucione arsimore parashihet të ketë pasoja mjaftë serioze dhe afatgjata për ekonominë dhe shoqëritë, e që do të mund të ndikojnë në rritjen e pabarazive, mungesës së qasjes në shërbime arsimore të grupeve të cenueshme, përkeqësimin e gjendjes shëndetësore dhe kohezionit social. Humbjet në procesin e të nxënimit do të jenë të pashmangshme dhe të konsiderueshme... duke prekur në mënyrë të ndjeshme grupet e cenueshme, ku një pjesë e nxënësve janë në rrezik të humbjes së madhe të mësimin si pasojë e gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, kushteve dhe rrethanave në të cilat jetojnë e që mbase edhe do ta braktisin shkollën.*

Për përfshirjen sa më të mirë të fëmijëve/nxënësve nga grupet e cenueshme në arsim dhe zvogëlimin e humbjeve mësimore, rekomandohet që institucionet arsimore krahas mbështetjes së mësimdhënësve që punojnë me nxënësit nga grupet e cenueshme, përmbushjen e nevojave specifike për fëmijët e këtyre grupeve për qasje dhe edukim të përshtatshëm, të ofrojnë mbështetje shtesë për prindërit / kujdestarët ligjor të fëmijëve nga grupet e cenueshme për të mbështetur të mësuarit e fëmijëve të tyre nga shtëpia.

7. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE GJATË PANDEMISË

Mësimdhënësit janë përballur me sfida të shumta gjatë pandemisë. Shkëputja nga sistemi, thuaja tradicional e rutinë, për organizimin e mësimit në klasë në një situatë të re ku njohja dhe përdorimi i teknologjisë ishte i domosdoshëm, për shumë mësimdhënës paraqet ngarkesë shtesë.

Siç është përshkruar në kapitullin e tretë të këtij raporti, në kuadër të Udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, janë dhënë orientime lidhur me trajnimin e mësimdhënësve, personelit menaxherial dhe përkrahës të shkollave dhe akterëve tjerë. Mirëpo nuk ka pasur një plan të detajuar dhe të publikuar në faqen zyrtare të MASHTI-it për trajnimin e mësimdhënësve për këtë vit shkollor në kushtet e pandemisë.



Sipas raportit të Departamentit të Arsimit Parauniversitar (prill 2021), lidhur me zhvillimet në arsimin parauniversitar në kohë pandemie, për periudhën shtator 2020 – prill 2021, nuk janë mbajtur të gjitha trajnimet/modulet e propozua me Udhëzuesin e përgjithshëm. Referuar raportit të MASHTI-it janë realizuar disa programe të trajnimit dhe forma të tjera të zhvillimit profesional nga MASHTI, partnerët mbështetës dhe OJQ që ofrojnë trajnime:

- Për zbatimin në praktikë të KK-së, në vitin 2020, janë trajnuar 2500 mësime, 1700 në nivelin fillor dhe 800 në nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX), ndërsa për vitin 2021 janë planifikuar të trajnohen për KK edhe 2000 mësime.⁵⁵
- Në koordinim me British Council, janë trajnuar online 50 pjesëmarrës për Bazat e Micro:bit kodim, ndërsa trajnim fizik për Mendimi kritik, zgjidhja e problem dhe bazat e Micro:bit janë trajnuar 243 pjesëmarrës. Gjithashtu për Shkathtësitë Bazë dhe Zhvillimi për Leadership janë trajnuar fizikisht 147 pjesëmarrës.
- Nga Instituti Pedagogjik i Kosovës janë trajnuar 53 mësime për prezantimin e e-Mësimi.
- KEC - Në kuadër të Programit “Përkrahje Adolehentëve pas Mësimi të Rregullt” -ASSET deri me tani ka trajnuar 237 mësime.⁵⁶
- Janë mbajtur ligjërata vetëdijuese me rreth 1000 mësime për shëndetin mendor të organizuara nga MASHTI në bashkëpunim me IKSHPK me mbështetje të OBSH, ndërsa ligjërues kanë qenë dy psikologë shkollor nga departamenti i psikologjisë. Materialet janë në faqen zyrtare të MASHTI-it.
- Në mars të vitit 2021 KSHLM ka aprovuar 14 programe të trajnimit për teknologji informative.

Në raportin e njëjtë të MASHTI-it (prill 2021), nuk përfshihen të gjitha trajnimet që janë realizuar gjatë pandemisë, me theks të veçantë gjatë këtij viti shkollor (2020-2021), kjo le të kuptohet se nuk ka një sistem të raportimit të bazuar në indikatorët matës, përmes të cilit do të mund të gjeneroheshin raporte të detajuara për përfshirjen e mësimeve në trajnime sipas komunave dhe shkollave, programet e ndjekura, ofruesit e programeve, etj. Kjo nuk nënkupton që nuk ka të dhëna, por ato janë të pasistemuara.

Kështu, referuar të dhënave të dërguara nga Divizioni për ZHPM në MASHTI, në kuadër të programit GIZ-it, gjatë këtij viti shkollor 659 mësime janë përfshirë në 10 programe të ndryshme, ku kryesisht kanë marrë pjesë mësime dhe 20 shkollave kampion që i mbështet programi i GIZ-it. Trajnime nga GIZ kryesisht janë mbajtur online.

Ndërsa, sipas intervistës me shkrim të përfaqësuesit të SBASHK-ut, janë trajnuar 4500 punëtorë të arsimit në katër programet e trajnimit të SBASHK, të miratuara nga MASHTI, si “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, “Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar”, “Aplikimi i pro-

55 Programi për zbatimin në praktikë të kurrikulës, është ofruar nën koordinimin e MASHTI-it me DKA-të. MASHTI gjithashtu, gjatë vitit 2020 ka ofruar edhe trajnimin për Udhëheqje arsimore, ku janë përfshirë 300 pjesëmarrës. Të gjitha trajnimet e organizuara nga MASHTI, janë mbajtur me prezencë të drejtpërdrejtë në shkolla apo Qendrat Didaktike.

56 Referuar të dhënave të dërguara nga Divizioni për ZHPM në MASHTI, në kuadër të 5 programeve të ofruara nga projekti ASSET, pjesa më e madhe e këtyre mësimeve, kanë ndjekur me shumë se një program trajnimit, apo 705 mësime janë përfshirë në pesë programet e trajnimit, të cilat që të gjitha janë ofruar përmes formës online të trajnimit.

grameve kompjuterike në mësimdhënie”, “Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik”, “Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm”.

Mundësia e mësimdhënësve për përfshirje në trajnimet e organizuara gjatë kushteve të pandemisë, dallon nga komuna në komunë, si dhe nga shkolla në shkollë. Në përgjithësi sipas drejtorëve dhe mësimdhënësve nuk ka pasur organizim të zhvillimit profesional nga institucionet. Disa shkolla dhe komuna gjatë kësaj periudhe kanë përfutuar më shumë, pasi që paraprakisht ishin në ndonjë proces të bashkëpunimit me ofruesit e trajnimeve, si shkollat kampione në kuadër të programit të GIZ-it, ashtu edhe shkollat tjera në kuadër të programeve të ofruara nga British Council, apo nga SBASHK vetëm për anëtarësinë e vet.

Janë raste ku vet DKA-të kanë organizuar trajnime për mësimdhënës në rrethanat e pandemisë. Ky është një shembull i mirë se si niveli komunal të shfrytëzojë mundësitë e veta për t'i mbështetur shkollat edhe me trajnime e forma të tjera të zhvillimit profesional. Këtë e konfirmon edhe M/3, sipas të cilit komuna ka pajisur të gjithë mësimdhënësit me teknologji dhe trajnime (M/3). Po sipas M/3 edhe MASHTI në bashkëpunim me UNICEF ka ofruar trajnimin mbi edukimin seksual.

Në disa shkolla raportohet se ka pasur trajnime me bazë në shkolle, në bashkëpunim me aktivet profesionale, si dhe disa trajnime nga sindikata (M/1). Por kjo nuk ka funksionuar njësoj te të gjitha shkollat, pasi që sipas M/3 ‘Vetëm me iniciativë të mësimdhënësve në gjetje të trajnimeve të ofruara nga organizata të ndryshme. Nuk ka funksionuar as bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve brenda aktiveve profesionale (M/3). Thuaja të njëjtën brengosje e shfaq edhe M/7 pasi që ‘Ka mungesë të iniciativës nga shkolla, por edhe shkolla anashkalohet nga DKA dhe MASHTI. Ndërsa sipas M/7 shpreh pakënaqësi me mos përkrahjen e mësimdhënësve gjatë kësaj periudhe.

Sipas përfaqësuesve të DKA-ve të përfshirë në këtë studim, zhvillimi profesional i mësimdhënësve ishte i fokusuar kryesisht në përdorimin e teknologjisë. Këtë nevojë e kanë plotësuar me trajnime vullnetare nga vetë mësimdhënësit, ndërsa disa shkolla dhe DKA kanë pritur nga MASHTI ose organizatat që ofrojnë trajnime. Për përdorimin e platformave të ndryshme mësimore dhe mësimin në distancë, sipas njërit nga zyrtarët e arsimit (DKA/2), trajnime kanë zhvilluar MASHT, GIZ, British Council, UNFPA-KOPE, UNICEF.

Në anën tjetër sipas DKA-ve, kanë munguar programet dhe trajnimet për mësimdhënës lidhur me qasjet në mësimdhënie në kushtet e pandemisë, aspektet psikologjike të ngarkesës dhe stresit të mësimdhënësve për punën nën presionet e krijuara nga pandemia. Edhe pse në disa komuna janë ofruar programe të trajnimit të kësaj natyre, siç ishin modelet e trajnimit të ofruara nga OJQ EDUMEN, me mbështetje nga OSCE (DKA/4).

DKA-të ndajnë mendimin se mësimdhënësit nuk i shohin si mundësi të mirë trajnimet online, përkundër që e pranojnë se ishte e domosdoshme një formë e tillë e organizimit të trajnimeve për mësimdhënës. Sipas DKA/4 mungesa e ambientit shkollor, e kontaktit të drejtpërdrejtë në trajnime nuk nxitë motivin për nxënie të suksesshme, gjë e cila reflektohet edhe në punën me nxënësit

Në anën tjetër, sipas njohësve të arsimit nuk janë evidentuar veprime domethënëse për mbështetjen e mësimdhënësve në kohën kur ata ishin midis sfidave të shumta, gjatë mësimin në kushtet e pandemisë. MASHTI kryesisht u doli në ndihmë me udhëzues se si të veprojnë në kushte të jashtëzakonshme, edhe pse vlerësohet së udhëzimet janë të përgjithshme. Sipas (NjA/3) **përkrahja vetëm me udhëzues u dëshmuar të ketë qenë e pamjaftueshme. MASHTI në dokumentet e saja strategjike promovon të mësuarit digjital për vite me radhë, mirëpo, siç u dëshmuar, duket që përkushtimi për mësimin digjitalit të mos ketë qenë i sinqertë.**

Nevoja dhe kërkesa kryesore e mësimdhënësve në këtë kohë ishte pajisja me teknologji, por edhe aftësimi i tyre sa i përket përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie. Mbështetja nga institucionet dhe organizatat tjera kanë qenë të fragmentuara, pa u fokusuar në personat të cilët vërtetë kanë pasur nevojë për aftësim të tillë. Kjo sipas (NjA/4) ndodhë pasi që institucionet nuk kanë informata të sakta për nevojat e mësimdhënësve, hierarkia e funksionimit të institucioneve është e brishtë, shkollat nuk kanë autonomi të plotë për veprim të pavarur, dhe zakonisht për të gjitha vendoset nga lartë. Ndërsa, në anën tjetër MASHTI nuk ka kapacitete të mjaftueshme për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe nevojave.

Një përfaqësues nga partnerët që mbështetin arsimin në Kosovë, shprehet se në kuadër të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe punëtorëve arsimorë nuk ka pasur një qasje apo strategji nacionale dhe nuk janë konsultuar partnerët rreth kësaj çështje, pavarësisht kërkesave dhe ofrimit të mundësive. Ndërsa sipas NjA/5 nuk është se nuk ka pasur përpjekje për mbështetjen e mësimdhënësve për zhvillim profesional, por kishte mungesë të përvojës dhe mungesë të kapaciteteve planifikuese dhe zbatuese.


Pandemia sheshoi edhe dukurinë se si trajnimet dhe kurset e deritashme janë ndjekur shumë formalisht nga ana e mësimdhënësve. Kjo ka ndodhur edhe me trajnimin për ECDL ku mijëra mësimdhënës e kanë ndjekur por asnjëherë nuk është vlerësuar kompetenca e tyre, sikurse ndodh edhe me trajnimet tjera. Institucionet tani kishin sfida të tjera, si të sigurohen mjete higjienike, rregulla të sjelljes dhe të mbrojtjes nga virusi, kështu që aftësimi i mësimdhënësve nuk ishte në plan të parë në kohë pandemie dhe shpesh jo relevant për nevojat e mësimdhënësve.



Mundësia e mësimdhënësve për përfshirje në trajnimet e organizuara gjatë kushteve të pandemisë, dallon nga komuna në komunë, si dhe nga shkolla në shkollë. Në përgjithësi sipas drejtorëve dhe mësimdhënësve nuk ka pasur organizim të zhvillimit profesional nga institucionet. Disa shkolla dhe komuna gjatë kësaj periudhe kanë përfituar më shumë, pasi që paraprakisht ishin në ndonjë proces të bashkëpunimit me ofruesit e trajnimeve, si shkollat kampione në kuadër të programit të GIZ-it, ashtu edhe shkollat tjera në kuadër të programeve të ofruara nga British Council, apo nga SBASHK vetëm për anëtarësinë e vet.

8. MËSIMI NË KUSHTE PANDEMIE DHE ROLI I PRINDËRVE

Prindërit si kujdestarë primarë të fëmijëve të tyre/nxënësve, janë pjesë e komunitetit të shkollës, të cilët kanë rol dhe përgjegjësi për fëmijën/et e tyre dhe për proceset që zhvillohen në shkollë. Edhe prindërit, ashtu si nxënësit dhe mësuesit, u përballën me sfida të shumta në punën me fëmijët e tyre gjatë masave të izolimit si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe mësimit në distancë në kushtet e shtëpisë, por edhe tani me kthimin në shkollë me respektim të masave mbrojtëse.



Referuar raportit të Bankës Botërore⁵⁷, edhe në rrethanat më të mira, shumë prindër nuk janë të përgatitur për t'u përballur me të nxënësit në distancë dhe mësimin në shtëpi, veçanërisht ata që nuk kanë njohuri mbi teknologjinë, kanë arsim e burime të kufizuara, kanë shumë fëmijë për të mbajtur, dhe që duhen të marrin vendime për shpërndarjen e një numri të pamjaftueshëm pajisjesh të teknologjisë së informacionit. Kjo sipas raportit ilustron me të dhënat që tregojnë se numri i të rriturve që kanë aftësi digjitale bazë apo më të mira shkon nga 24 për qind në Bosnjë-Hercegovinë, në 32 për qind në Maqedoninë e Veriut dhe në 46 për qind në Serbi, në krahasim me 56 për qind në BE dhe mbi 70 për qind në vende si Gjermania, Danimarka dhe Holanda.

Prindërit dhe kujdestarët mund të vendosin me fëmijët e tyre rregulla se si, kur dhe ku mund të përdoret interneti. Për të vendosur një ekuilibër të shëndetshëm ndërmjet kohës online dhe veprimtarive të tjera duhet të përcaktohen disa kufij. Në rastin e fëmijëve të vegjël, veprime si kontrollet prindërore mund të ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve online. Prindërit dhe kujdestarët mund t'i ndihmojnë fëmijët që të kenë qasje në burimet online, të domosdoshme për mësimin online, socializimin dhe argëtimin në periudhën e pandemisë së Covid-19. Njëkohësisht, prindërit dhe kujdestarët duhet të tregohen vigjilentë ndaj rreziqeve online ndaj fëmijëve⁵⁸.

Gjetjet nga studimi *Ndikimet e Covid-19, mbylljes së shkollës dhe izolimit social në mirëqenien dhe qëndrimet për mësimin në distancë (online) të nxënësit me dhunti*, tregojnë se si rezultat i mbylljes së shkollave dhe izolimit në shtëpi, prindërit e fëmijëve me dhunti janë ndjerë më të ngarkuar se zakonisht, në familje është rritur tensioni, ndërkaq tek fëmijët me dhunti janë vërejtur ndryshime në mirëqenien psikologjike⁵⁹.

Lidhur me rolin e prindërve në organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë, qysh në dokumentin e parë për detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë (mars 2020⁶⁰), MASHTI ka përkrahur rëndësinë e përfshirjes së prindërve në realizimin e mësimin në distancë. Sipas këtij dokumenti, prindërit, sidomos ata që kanë fëmijë të moshës së re (klasat 1-3), janë pikëmbështetja kryesore për realizimin e mësimin online. Po ashtu, prindërit janë faktori më i rëndësishëm për realizimin e mësimin edhe në nivelet tjera të arsimit parauniversitar. Mirëpo, në dokumentet e zhvilluara për mësimin në kushtet e pandemisë, ka pak udhëzime të përvijuara në mënyrë të veçantë për prindër dhe punën me fëmijët e tyre.

Në kuadër të platformës “Edukimi në Distancë Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 – 6 vjeç”, pasqyrohen këshilla dhe informacione për prindër lidhur me realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijë në kushte shtëpie. Pjesë e platformës është edhe përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara për të cilat prindërit informohen se ato stimulojnë fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore në varësi të moshës së tyre si në fushën fizike, njohëse, emocionale, matematikore dhe në atë të kreativitetit. Gjithashtu, platforma sjell informata se si prindërit të flasin me fëmijët për Covid-19, temat mujore, shembuj të aktiviteteve të realizuara nga fëmijët, video të ndryshme dhe materiale që flasin për zhvillimin e fëmijëve në moshën e hershme. Prindërit udhëzohen që të punojnë bashkë me fëmijët e tyre gjatë aktiviteteve ditore të paraqitura në platformë.

57 Banka Botërore (2020). Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Vlerësim i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundër përgjigjja e vendeve. <https://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>

58 UNICEF dhe OBSH (prill 2020). COVID-19 dhe ndikimet e tij në mbrojtjen e fëmijëve online. https://www.unicef.org/albania/media/2811/file/ALBANIAN_COVID-19_and_Its_Implications_for_Protecting_Children_Online_neë.pdf

59 Zamira Hyseni Durak & Naime Hoxha. (2020). Ndikimet e COVID-19, mbylljes së shkollës dhe izolimit social në mirëqenien dhe qëndrimet për mësimin në distancë (online) të nxënësit me dhunti. https://www.researchgate.net/publication/343389659_Ndikimet_e_COVID-19_mbylljes_se_shkollës_dhe_izolimit_social_në_mirëqenien_dhe_qëndrimet_për_mësimin_në_distancë_online_të_nxënësit_me_dhunti

60 Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distancë-mashti_1.pdf

Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve për vitin shkollor 2020-2021, përshkruan shkurtimisht rolin e prindërve, sipas të cilit, duke pasur parasysh gjendjen e krijuar për shkak të pandemisë Covid-19, prindërit duhet të përfshihen më shumë se kurrë më parë në mbështetje të fëmijëve të tyre në procesin mësimor që do të organizohet sipas skenarëve të caktuar nga shkolla si dhe në procesin e vlerësimit qo do të aplikohet sipas udhëzimeve të MASHTI.

Në anën tjetër, udhëzuesi i përgjithshëm i MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19, nuk ofron udhëzime dhe mbështetje të veçantë për prindër, lidhur me qasjet që duhet praktikojnë në punën me fëmijët e tyre në kushtet e pandemisë. Po ashtu nuk janë zhvilluar udhëzues të veçantë për prindër, video-incizime, si dhe nuk është krijuar një link i veçantë në faqen zyrtare të MASHTI-it ku prindërit do të kishin qasje më të lehtë, do të përdorej nga shkollat dhe prindërit për të ndërtuar një partneritet më të qëndrueshëm dhe përkrahje reciproke në kushtet e pandemisë. Kjo kryesisht është realizuar në vetë shkollat, diku – diku me mbështetjen e komunave përmes platformave mësimore, në mënyrën se si kanë mundur të organizohen dhe të ndihmojnë vetë prindërit, pa ndonjë ndihmë të veçantë nga sistemi.

Në udhëzuesin teknik Covid-19 dhe ndikimet e tij në mbrojtjen e fëmijëve online⁶¹, të promovuar nga UNICEF dhe OBSH, përcaktohen disa nga prioritetet dhe rekomandimet kyçe se si t'i zbutim këto rreziqe dhe se si të promovojmë përvoja pozitive online për fëmijët, përfshirë edhe rekomandimet për mbështetjen e prindërve:

- Qeveritë, shoqëritë dhe aktorë të tjerë duhet t'i mbështesin prindërit me udhëzime dhe mjete të përshtatshme, duke përfshirë mënyrën se si të reagojnë dhe, nëse është nevoja, se si të raportojnë kontaktet, sjelljen dhe përmbajtjen e dëmshme.
- Qeveritë, shoqëritë dhe administratorët e shkollave duhet t'i njohin prindërit dhe kujdestarët me politikën përkatëse, si dhe me mekanizmat online dhe offline të raportimit. Prindërit duhet të kenë në dispozicion numrat mbështetës të linjave të dobishme telefonike dhe të ndihmës, dhe të kontaktojnë policinë nëse shqetësimi i fëmijëve të tyre lidhet me kërcënime, krime të mundshme ose sjellje të tjera të paligjshme.

Mbështetja e prindërve me udhëzime dhe këshilla për punën me fëmijët e tyre, është kërkuar edhe nga mostra përfaqësuese e prindërve të përfshirë në studimin për mësimin në distancë të realizuar nga IPK në maj të viti 2020. Kjo arsyetohet me argumentin se shumë prindër nuk mund të sigurojnë mbështetjen e duhur të fëmijëve të tyre në çështjet që lidhen me mësimet, ndërsa në anën tjetër është vërejtur se vazhdimi i mësimit në distancë për një kohë të gjatë ka filluar të ndikojë në rënie të motivimit të fëmijëve për të mësuar.

61 UNICEF (prill, 2020). COVID-19 dhe ndikimet e tij në mbrojtjen e fëmijëve online https://www.unicef.org/albania/media/2811/file/AL-BANIAN_COVID-19_and_Its_Implications_for_Protecting_Children_Online_new.pdf

Kërkesa afërsisht të njëjta përshkruhen edhe në debatin e organizuar nga GIZ lidhur me: Sfidat e organizimit të procesit mësimor në kushte pandemie COVID-19 nga perspektiva e prindërve, në të cilin kanë marrë pjesë 25 pjesëmarrës, me përfaqësim më të madh nga prindërit⁶². Referuar minutave të këtij takimi, në rrethanat e mësimin në distancë, në Kosovë është rritur bashkëpunimi dhe komunikimi i mësimdhënësve dhe i shkollës me prindër. Natyrisht jo në nivelin e duhur për aspektet përmbajtjesore. Sistemi ynë ka bërë pak për përfshirjen e prindërve në proceset e mësimin, sidomos pas rrethanave të krijuara nga pandemia. Sipas prindërve sfidat e përgjithshme të mësimin në kushtet e pandemisë dhe prindërve, janë si në vijim:

- Problemet me teknologji, mungesë e platformave mësimore që mundësojnë mësim interaktiv, mbajtja e evidencës së mungesave të nxënësve dhe të mësimdhënësve në mësimin online jo të besueshme.
- Sigurimi i pajisjeve të teknologjisë informative, laptop dhe kompjuter, si dhe mungesa e kapaciteteve për mbështetjen e fëmijëve për mësim në distancë;
- Mungesë të transparencës me këshillat e prindërve. Mungesa e bashkëpunimit në mes të këshillit të prindërve në nivel shkollë me atë në nivel komunal. Jo në të gjitha shkollat funksionojnë mekanizmat e prindërve në nivel klase dhe shkollë.
- Mungesë e udhëzimeve dhe orientimeve për prindër se si t'i qasen punës me fëmijët e tyre (aspektet psikologjike, pedagogjike, metodike...), orarit mësimor në shtëpi, përkrahjes gjatë mësimin për të siguruar informacione dhe materiale mësimore, etj. Kjo ka bërë që prindërit gjatë kësaj kohe të ngarkohen tej mase.

Në rrethanat e mësimin në kushtet e pandemisë, një pjesë e prindërve morën rolin e mësuesit, në përpjekje për të mbështetur fëmijët e tyre, por një numër syresh nuk kanë qenë në nivel të përgjegjësive. Sipas (NjA/4) në këto rrethana, ngarkesa e prindërve është e ndërlidhur me cilësinë e ndjeshmërisë së prindërve për mbështetjen dhe përkrahjen e fëmijëve të tyre.

Situata me pandeminë është e paparashikueshme, rrjedhimisht edhe kohëzgjatja e qëndrimit në shkollë apo kohëzgjatja e mësimin në distancë, prandaj institucionet arsimore në Kosovë duhet të tregojnë kujdes dhe angazhim të shtuar institucional mbështetje së prindërve për punë me fëmijët e tyre në kushtet e mësimin në rrethanat e pandemisë. Prindërit, për përfshirjen aktive të tyre në proceset zhvillimore të shkollës dhe arsimit, rekomandojnë që të:


- përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve për shkollën dhe anasjelltas ato të shkollës dhe mësimdhënësve për prindër, lidhur me mësimin në këto kushte;
- sigurohet mbështetja në mënyrë sistematike e strukturave të prindërve nga niveli i klasës, shkollës deri në nivelin qendror;
- zhvillohet një platformë e veçantë për informimin zyrtar të prindërve nga niveli qendror, në të cilën publikohen materiale e udhëzime për prindër lidhur me punën me fëmijët e tyre, zhvillohen diskutime dhe analiza siç janë këto të fundit që lidhen me mësimin në kushtet e pandemisë; zhvillohen debate me prindër nga niveli i shkollës, deri në nivelin qendror.

62 Pjesë e këtij debate kanë qenë edhe autorët e këtij studimi.

9. MONITORIMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE RAPORTIMI GJATË PANDEMISË

Siç është përshkruar në kapitullin e tretë, Inspektorati i Arsimit mbetet mekanizimi kryesor për monitorim dhe inspektim në arsimin parauniversitar edhe në kushtet e pandemisë, i cili kryen detyrat përmes inspektimit të përgjithshëm, tematik, emergjent, ri-inspektimit si dhe inspektimit të cilësisë.

Bazuar në tri prioritetet e përcaktuara me udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021, fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar, vihet tek aspektet logjistike dhe organizative, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësinë e mësimit në kushtet e pandemisë, etj.



Sipas intervistës me shkrim me drejtorin e Inspektoratit të Arsimit, që nga fillimi i pandemisë Inspektorati i Arsimit është angazhuar në përcjelljen e situatës së krijuar në shkolla, ku gjerë më tani janë realizuar disa qindra inspektime tematike me qëllim të kontrollimit të zbatimit të masave anti Covid-19, si dhe në mënyrë të vazhdueshme janë mbajtur kontakte me DKA-të, me qëllim harmonizimin e aktiviteteve për të qenë sa më afër shkollës në mbështetje të procesit mësimor si dhe në ofrimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga Covid-19.

Në raportin e inspektoratit për mbarëvajtjen e mësimit sipas skenarëve A ,B dhe C për secilën komunë në nivel vendi nga dt. 14.09.2020-26.03.2021, pasqyrohen të dhëna për numrin e shkollave në secilën komunë që gjatë kësaj periudhe kanë punuar me skenarin A, skenarin B dhe skenarin C të mësimit. Tabela në vijim, pasqyron një përmbledhje të këtyre të dhënave në nivel rajoni.

Tabela 3. Numri i shkollave sipas skenarëve të mësimit

Nr.	Rajoni	Numri i shkollave që kanë punuar me Skenarin A të mësimit (në shkollë)	Numri i shkollave që kanë punuar me Skenarin B të mësimit (në shkollë + online)	Numri i shkollave që kanë punuar me Skenarin C të mësimit (online)	Gjithsej
1	Gjilan	74	2	2	78
2	Ferizaj	123	10	2	135
3	Mitrovicë	74	5	20	99
4	Pejë	47	6	41	94
5	Gjakovë	114	7	0	121
6	Prishtinë	143	6	10	159
7	Prizren	87	20	0	107
Gjithsej		662 ose 83.5%	56 ose 7 %	75 ose 9.5%	793

Sipas raportit të inspektoratit, numri më i madh i shkollave që gjatë këtij viti shkollor, në periudha të ndryshme kanë punuar në Skenarin C të mësimin (online), janë shkolla nga komunat të cilat janë edhe rajone, si Peja, pastaj Mitrovica dhe Prishtina.

Në anën tjetër, sa i përket raportit narrativ të siguruar nga Inspektorati i Arsimit për mbarëvajtjen e mësimin sipas skenarëve A, B dhe C të datave 14.09.2020-26.03.2021, ka dallime në mënyrë se si përshkruhet situata e mbarëvajtjes së mësimin për komunat e përshkruara. Përshkrimet në raportet narrative, përtej skenarit të mësimin, iu referohen informacioneve për funksionimin e Task Forcës së shkollës, vendosjes së udhëzimeve, informacioneve dhe vendimeve për respektimin e masave mbrojtëse, furnizimit me mjete dezinfektuese si dhe maska dhe dorëza për nxënës, matjes së temperaturës së nxënësve, testimet e bëra për Covid-19, numrit të rasteve të infektive apo vdekjeve nga virusi etj.

Dallimet në raportet narrative të mbarëvajtjes së mësimin sipas komunave janë në bazë të specifikave dhe dëshmimeve të siguruar gjatë inspektiveve në shkolla. Ato përshkruhen me mungesë të indikatorëve matës përmes të cilëve do të mund të përgatiteshin raporte sipas indikatorëve, komunave dhe në shkallë vendi. Vetëm në dy raste të raporteve përshkruese pasqyrohen indikatorë matës, si numri i shkollave që kanë punuar sipas skenarëve të mësimin dhe numri i të vdekurve nga personeli i shkollave nga Covid-19.

Pra, në përgjithësi, sistemi i raportimit nga SIA nuk është i lidhur me një kornizë të monitorimit dhe raportimit, përmes së cilës do të mund të raportohej me indikatorë matës, të cilët do të mund të krahasoheshin me komunat tjera dhe do të mund të përgatiteshin raporte në shkallë vendi për indikatorë të caktuar, si për shembull:

- Nr. i shkollave që mbajnë mësim, sipas skenarëve të mësimin;
- Nr. i mësimdhënësve që punojnë me dy grupe të nxënësve të së njëjtës klasë;
- Numri i mësimdhënësve të trajnuar për mësim online;
- % e shkollave që punojnë me kohëzgjatje të orës mësimore prej 25-30 minuta;
- % e nxënësve që marrin pjesë në mësim, sipas skenarëve të mësimin;
- % e orëve mësimore të realizuara sipas klasave;
- Nr. i mësimdhënësve të infektuar nga Covid-19;
- Nr. i mësimdhënësve që kanë munguar për shkaqe shëndetësore;
- Nr. i mësimdhënësve për të cilët është siguruar zëvendësimi nga DKA
- Nr. i mësimdhënësve për të cilët vetë shkollat kanë siguruar zëvendësimet;
- Nr. i nxënësve të infektuar nga Covid-19;
- % e përdorimit të secilës platformë digjitale, bazuar në numrin e mësimdhënësve që kanë përdorur platformat digjitale përkatëse (shkollat.org E-shkollori, Zoom, Teams, Google Classroom, etj.);
- Nr. i mësimdhënësve të vëzhguar në orë mësimore.


Në mungesë të indikatorëve matës të raportimit, është vështirë të nxirren përfundime për cilësinë e mësimin në kushte të pandemisë. Për më shumë, një format i tillë i raportimit nuk është kërkuar as me Udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021, kapitullin e gjashtë: Monitorimi dhe Inspektimi.

Megjithatë, bazuar në formatin e raporteve ekzistuese, IA ka identifikuar disa nga sfidat më të mëdha me të cilat është përballur sistemi arsimor si në vijim:

- situata emergjente me rrezikim të shëndetit dhe jetës;
- mungesa e plan programeve të cilat i përgjigjen situatave emergjente;
- orët mësimore me kohëzgjatje prej 25-30 minuta;
- mungesa e përvojës për t'iu përgjigjur situatave të tilla;
- mësimi online (në distancë);
- pengesa në qasje në platforma elektronike për komunikim/mësim online;
- mungesa e pajisjeve teknologjike për të përcjellë mësimin online;
- mos angazhimi i personelit plotësues nga DKA-të për shkolla për të zëvendësuar të infektuarit me Covid-19 etj.

10. SFIDAT NË PËRBALLJE ME PANDEMINË DHE MUNDËSITË PËR ADRESIMIN E TYRE

Pandemia Covid-19 vazhdon të sfidojë sistemet arsimore, duke ndryshuar rutinën e organizimit të procesit mësimor dhe të organizimit të punës së institucioneve arsimore, duke rritur shkallën e ngarkesës së komunitetit arsimor, përfshirë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, dhe njëkohësisht duke ndikuar në thellimin e pabarazive në arsim.



Në kontekstin e Kosovës, vetë mënyrat e organizimit të mësimi në kushte pandemie, si mësimi në shkollë në kushtet e pandemisë, mësimi i kombinuar apo mësimi në distancë, u përcoll me sfida të shumta, si për mësimdhënësit ashtu edhe për prindërit, nxënësit dhe komunitetin arsimor në përgjithësi. Vlerësohet se e gjithë energjia gjatë përballjes me pandeminë është përqendruar në organizimin e procesit mësimor, pjesëmarrjen fizike në shkollë, realizimin e programeve mësimore, ndërkaq, shumë pak është ofruar këshillim dhe mbështetje emocionale për fëmijët gjatë kësaj periudhe⁶³.

Mbyllja emergjente e shkollave ishte mjaftë sfidues për sistemin dhe shoqërinë në përgjithësi. Ndërrimi i rutinës nga klasa në shtëpi ishte mjaftë sfidues për nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Sipas (NjA/1) ngarkesa e të gjithë akterëve në procesin mësimor ka qenë dhe mbetet e lartësi p.sh: mësimi online, mbajtja e mësimi me orar të shkurtuar dhe në dy ndërrime për të njëjtën klasë, duke krijuar presion dhe stres tek secila kategori.

Në anën tjetër, disa njohës tjerë të arsimit, ngarkesën e komunitetit arsimor në përballje me pandemisë, përveç ndikimeve të mëdha nga vet e panjohura, pandemia, atë e ndërlikojnë edhe me mosfunksionimin e mekanizmave mbështetës, mungesë të përkrahjes së strukturuar. Në mungesë të mekanizmave mbështetës, në shumicën e rasteve familjet dhe shkollat mbetën vetëm. Kjo pastaj ka sjellë dallime në mënyrën se si familjet dhe shkollat e kanë kuptuar rolin e tyre në kushtet e pandemisë dhe iu kanë përgjigjur kërkesave specifike që lidhen me rolin e tyre.

Sipas njohësit tjetër të arsimit, aspekti i ngarkesës së nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve në proceset e mësimi gjatë pandemisë, duhet shikuar nga perspektiva **e mbështetjes dhe përkrahjes së ofruar, sepse sipas tij, komunitetit të shkollës pa përjashtim i ka munguar përkrahje e strukturuar në proces të mësimdhënies dhe mësim nxënies gjatë pandemisë** (NjA/3).

Nuk ka të dhëna të sakta sa i përket ngarkesës sasiore të të gjitha palëve. Sipas (NjA/6) presioni tek mësimdhënësit dhe prindërit është krijuar nga vetë situata e pandemisë, pasiguria financiare, pasiguria e shëndetit, balancimi i punës nga shtëpia dhe kujdesit për fëmijët, por edhe përballja me një sistem mësimi i cili ka vënë në dyshim cilësinë e mësimi dhe të ardhmen zhvillimore të nxënësve. Edhe pse vlerësohet se pjesa e mësimdhënësve, të cilët me seriozitet ju kanë qasur mësimi në distancë, apo edhe skenarëve të tjerë, kanë qenë të mbingarkuar. Në anën tjetër, për nxënësit ngarkesa ka qenë mjaft e madhe në procesin e të nxënies, duke marrë parasysh mungesën e interkasionit me mësimdhënësin dhe shokë të klasës apo punës në grupe, e cila është një nga parakushtet për zhvillim të kreativitetit dhe mendimit kritik.

Sistemi arsimor ende nuk është konsoliduar sa i përket zbatimit të plotë të Kurrikulës, dhe qasjes ndaj mësimdhënies sipas kërkesave të saj. Kurrikula aktuale i mundëson mësimdhënësit autonomi të zgjeruar për përzgjedhjen e materialeve/burimeve mësimore dhe përdorimin e mjeteve të ndryshme për arritjen e kompetencave. Se sa mësimdhënësit ende nuk janë familjarizuar me Kurrikulën e re, u pa kur ata u sfiduan me shprehjen e autonomisë së tyre për qasjet të cilat pikërisht i adreson filozofia e kurrikulit të bazuar në kompetenca. Sipas (NjA/1) mungesa e traditës dhe kapaciteteve për përgatitjen e materialeve mësimore digjitale, dhe niveli i ulët i kompetencës digjitale në shoqërinë tonë, u reflektua në masë të madhe gjatë pandemisë.

Sfidë më vete ishte ‘mungesa e llogaridhënies dhe mungesa e kompetencës profesionale të mësimdhënësve’ (NjA/2), gjë që ka ndikuar edhe në gjetjen e rrugëve më të mira për veprim në gjendje pandemie.

63 Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), 2021. EDITORIAL - Arsimi në Kosovë gjatë Pandemisë COVID-19. Në kuadër të projektit: CILËSIA, LLOGARIDHËNIA DHE GJITHËPËRFSHIRJA NË ARSIM 2021. http://www.kec-ks.org/ep-content/uploads/2021/04/Editorial_Arsimi-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-COVID-19-FINAL.pdf

Lidhur me sfidat më të mëdha me të cilat është përballur arsimi parauniversitar, nga përfaqësuesit e MASHTI-it adresohen sfidat e mëposhtme:

- Numri i madh i fëmijëve në grupe edukative gjatë vijueshmërisë së fëmijëve në institucionet parashkollore gjatë periudhës së pandemisë.
- Realizimi i aktiviteteve edukative me fëmijët e vegjël\ pamundësia e mbajtjes së distancës.
- Realizimi i aktiviteteve ditore online nga platforma “Edukimi në Distancë”, me fëmijët në raste të izolimit.
- Mungesa e zëvendësimit të stafit edukativ të infektuar me Covid dhe ato mbi moshën 60 vjeçare, duke pasur parasysh qëndrimin ditor të edukatoreve në punë.
- Kalimi nga një skenar në skenarin tjetër ka shkaktuar probleme të nxënësit me nevoja të veçanta sepse mësimi online është i vështirë me këta nxënës pasi që ai duhet të behet përmes prindërve.
- Problemet me pajisje teknologjike por edhe me përdorimi i tyre nga ana e nxënësve dhe prindërve.
- Numri i vogël i asistentëve në shkollë dhe mungesa e kohës së mesimdhënësve për të punuar individualisht me këta nxënës.
- Mungesa e kapaciteteve digjitale dhe materialeve mësimore digjitale.
- Mungesa e një njësie organizative në MASHTI, si departament ose divizion që merret me digjitalizimin e arsimit, pedagogjinë digjitale, planifikimin, monitorimin dhe raportimet etj.

“

Mbyllja emergjente e shkollave ishte mjaftë sfidues për sistemin dhe shoqërinë në përgjithësi. Ndërrimi i rutinës nga klasa në shtëpi ishte mjaftë sfidues për nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Sipas (NjA/1) ngarkesa e të gjithë akterëve në procesin mësimor ka qenë dhe mbetet e lartësi p.sh: mësimi online, mbajtja e mësimit me orar të shkurtuar dhe në dy ndërrime për të njëjtën klasë, duke krijuar presion dhe stres tek secila kategori.

Edhe sipas drejtorëve të shkollave, mësimeve dhe Drejtorive Komunale të Arsimit, mësimi në kushtet e pandemisë karakterizohet me sfida të shumta, si:

- Vetë procesi i organizimit të mësimi në kushte pandemie.
- Mungesa e kompetencave digjitale të personelit arsimor dhe prindërve, mungesa e infrastrukturës së TIK-ut, mungesa e platformave për organizimin e mësimi, mungesa e pajisjeve, mungesa e internetit e deri te mungesa e shtrirjes së rrjetit të kanalit televiziv RTK në zonat e thella.
- Mbrojtja nga infeksioni Covid-19. Organizimi i hyrjes dhe daljes së nxënësve në shkollë dhe në oborrin e shkollës.
- Orari i shkurtër i orës mësimore. Ndarja e nxënësve nëpër grupe.
- Zbatueshmëria e planeve mësimore të hartuara, kur kemi parasysh se përmbajtjet mësimore janë reduktuar, kushtet e mjedisit të punës në shkolla, mbajtja e maskës, distanca sociale me nxënës dhe ndërmjet nxënësve, etj.
- Pasiguria në aspektin e pritshmërisë se çfarë dhe si të veprohet në një situatë në të cilën asnjë institucion shkollor nuk ka qenë më herët.
- Menaxhimi i situatës me personel gjatë pandemisë. Zëvendësimi i personelit arsimor i cili gjatë kësaj kohe ka qenë i infektuar me Covid 19. Pamundësia e mbulueshmërisë së orëve mësimore në rastet kur kemi pasur mësimeve të cilët kanë qenë të infektuar me Covid-19.
- Ngarkesa me punë e mësimeve, sidomos në shkollat ku mësimeve kanë punuar me dy grupe të nxënësve dhe me skenarin e mësimi B.
- Ndërprerja e aktiviteteve të ndryshme në shkolla. Pa mundësia për zhvillimi e aktiviteteve të lira dhe organizimin e garave të diturisë dhe garave tjera.

Në anën tjetër, nga njohësit e arsimit adresohen sfidat e mëposhtme:

- Mungesa e qasjes sistemore në planifikim dhe organizim të mësimi gjatë pandemisë. MASHTI planifikoi atë sa kishte mundësi – sepse u dëshmuar se për vite të tëra nuk ishin krijuar kapacitetet e resurset e nevojshme për mësim dhe mësimdhënie online.
- Mungesa e mobilizimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional për të krijuar kushtet elementare (qasja në internet, sigurimi i pajisjeve dhe sigurimi/identifikimi i materialeve mësimore) për organizim dhe mbarëvajtje të procesit mësimor.
- Aspektet organizative dhe mbështetja institucionale e fragmentuar.
- Sigurimi i cilësisë, gjë që ka sjellë mjaft pikëpyetje dhe ka hapur tema për debat, sidomos rreth mundësive për zbatim të kurrikulës, vlerësim objektiv dhe zhvillim akademik të nxënësve sipas rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave.
- Të meta të sistemit arsimor u bartën tutje për tu multiplikuuar si ndikim edhe gjatë pandemisë. Mungesa e llogaridhënies, mungesa e kompetencës profesionale të mësimeve, tekste shkollore jo të përshtatshme, e shume të tjera, vazhdojnë të jenë probleme kyçe që cenojnë cilësinë e arsimit parauniversitar.

Të gjitha këto sfida kanë nxjerrë në pah pothuajse të gjitha mangësitë e sistemit arsimor. Vlerësimi i situatës duhet të kontribuojë në përmirësimin e masave për aplikimin e mësimit online, por edhe në identifikimin e masave prioritare që duhen ndërmarrë në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim. Politikëbërësit në të ardhmen duhet t'i orientojnë politikat buxhetore dhe zhvillimore drejt evitimit të sfidave të identifikuara, për të mos u befusuar nga situatat emergjente në të ardhmen, por edhe për t'i paraprirë zhvillimit të arsimit.

Mundësitë që duhet shfrytëzuar në përgjigje më të mirë rrethanave të krijuara nga COVID 19. Organizimi 'aksidental' i mësimit në kushtet e pandemisë, ndryshimi i detyrueshëm i qasjes së mësimdhënies dhe të nxënies, në kushte pandemie globale, për shumë shoqëri, edhe për ne, ishte një mësim i ri ndaj të cilit duhet reflektuar, siç është organizimi i shkollimit në këso rrethanash. Gjithashtu, organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, ishte një mundësi e mirë për të mësuar për përparësitë e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, për modalitetin e mësimit në distancë, dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe integrimin e mësimit online në sistemin arsimor të Kosovës⁶⁴.

Sipas Dawson dhe Mellor (2020), vihet re se nuk ka një zgjidhje të vetme për të gjitha sfidat strukturore afatgjata të pranishme në sistemet arsimore. Pandemia nuk nënkupton vetëm një gjendje emergjente, por ajo gjithashtu mund të shfaqë një perspektivë mundësish për rishikim apo rikonceptualizim kombëtar të sistemit arsimor – duke u orientuar kështu drejt një sistemi të ri vlerash (cituar Gentiola Madhi dhe Francesco Trupia, mars 2021⁶⁵).

Organizimi i mësimit në kushtet e pandemisë, veçanërisht organizimi i mësimit në distancë, përveç sfidave, përbën një mundësi të mirë për të kuptuar rëndësinë dhe përparësinë e shfrytëzimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe përfshirjen e mësimit online në sistemin arsimor të Kosovës⁶⁶. Tani më nuk mund të themi se sistemi arsimor ende është i papërvijë, pasi që është krijuar një traditë organizimi si dhe përvijë për ndryshime dhe hartim të politikave arsimore nga një perspektivë e mundësive për qasje të reja.

Nga këndvështrimi i njohësve të arsimit dhe studimeve në këtë fushë, duhet të vepohet nga mësimet dhe përvojat e sistemeve të tjera. Krijimi i një plani/strategjie shtetërore për digjitalizim të sistemit të arsimit dhe zbatimi i atij plani/asaj strategjie duke filluar nga viti shkollor 2021-2022, shihet si një alternativë kryesore. Situata nuk duket se do të jetë (shumë) ndryshe edhe në vitin tjetër shkollor. Çdo vonesë në këtë drejtim vetëm sa do ta shtojë shkallën e humbjeve që janë krijuar në sistem. Çdo vonesë do ta dëshmojë joseriozitetin e institucioneve shtetërore për të vepruar në këtë kohe krizash të shumta në sistem. (NjA/1). *Është i domosdoshëm promovimi dhe avancimi i formave të reja dhe qasjeve mësimore digjitale. Ata të cilët deri dje ishin skeptik ndaj modaliteteve të mësimdhënies digjitale, sot e shohin si një mundësi reale për të cilën duhet investuar në krijimin e kushteve dhe kompetencave digjitale.*

Gjithashtu, situata me pandeminë dëshmoi rëndësinë e promovimit dhe avancimit të bashkëpunimit me prindër për mësim në distancë. Shumë syresh, të cilët kanë heziturar të kenë një bashkëpunim më të ngushtë të prindërve

64 Instituti Pedagogjik i Kosovës (2020). Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID - 19. IPK, Prishtinë.

65 Gentiola Madhi dhe Francesco Trupia (2021). Reformimi apo rikonceptualizimi i arsimit postpandemik në Ballkanin Perëndimor - Analizë për Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë. Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, KFOS. <https://kfos.org/storage/app/uploads/public/604/08b/814/60408b8146acd816019318.pdf>

66 Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), 2021. EDITORIAL - Arsimi në Kosovë gjatë Pandemisë COVID-19. Në kuadër të projektit: CILËSIA, LLOGARIDHËNIA DHE GJITHËPËRFSHIRJA NË ARSIM 2021. http://www.kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/Editorial_Arsimi-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-COVID-19-FINAL.pdf

me shkollën, tani janë bindur se sa i rëndësishëm është një bashkëpunim i tillë për të mirën e fëmijëve të tyre. Prandaj shkollat dhe institucionet tjera duhet ndihmuar që një bashkëpunim reciprok të promovohet për të mirën dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Në anën tjetër, sa i përket adresimit të humbjeve mësimore, njëri nga njohësit e arsimit (NjA/1), zbatimin e mësimdhënies së bazuar në projekte, e sheh si një mundësi ndaj të cilës duhet të reflektojnë shkollat dhe mësimdhënësit, gjithnjë duke marrë për bazë specifikat e klasave dhe nivelet e arsimit, kapacitetet e mësimdhënësve për zbatimin e mësimdhënies së bazuar në projekte, temat/përmbajtjet mësimore të planifikuara këtë vit shkollor për të qenë në funksion të rezultateve të nxëniet të cilat nuk janë arritur dhe synohet të arrihen nëpërmjet qasjeve të tilla të mësimdhënies. Idetë për mundësitë që duhet shfrytëzuar për adresimin e humbjeve mësimore, janë një orientim i mirë për punën e shkollave dhe mësimdhënësve, plotësojnë në masë të madhe mungesën e udhëzimeve të qarta nga MASHTI për qasjen në mësimdhënie në raport me mësimin plotësues që planifikohet të ofrohet.

Mësimet e nxjerra dhe përvoja e dobishme duhet të përdoret edhe në të ardhmen, për (dhe jo vetëm) (NjA/5):

- sigurimin e qasjes në arsim për grupe të caktuara të nxënësve (nxënësit me probleme shëndetësore që janë në spitale, mësimi shqip për nxënësit në diasporë)
- komunikim të shtuar online ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve (pas mësimit në shkollë)... për të kompensuar mangësitë e qëndrimit të kufizuar në shkollë për shkak të organizimit të punës me ndërrime
- zhvillimin e mësimit digjital në kushte normale të organizimit të procesit mësimor, si mundësi ideale për rritje të transparencës dhe llogaridhënies në arsimin para universitar etj.

Mësimet dhe përvoja e dobishme, duhet të kthehen në veprime, të cilat kërkojnë bashkim sinergjish ndërinsti-tucionale dhe mbarë shoqërore, për tejkalimin më të lehtë dhe më të suksesshëm të sfidave të pandemisë dhe për të ardhmen e arsimit.

11. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përgjigje të rrethanave të krijuara nga pandemia globale e njohur si Covid-19, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim Drejtoritë Komunale për Arsim, Shkollat, partnerët ndërkombëtarë që mbështesin arsimin, organizatat jo-qeveritare dhe industrinë e teknologjisë informative, arriti të organizojë mësimin në distancë në kushtet e pandemisë dhe të përmbyllë vitin shkollor 2019/2020.

Në anën tjetër, për të siguruar organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19, MASHTI në konsultim me IKSHP zhvilloi Udhëzuesin dhe Master planin për organizimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës. Si të tilla, këto dokumente dhe dokumentet tjera plotësuese shërbyen për organizimin e mësimin gjatë këtij viti shkollor. Megjithatë, nga analiza e kuadrit të masave të vendosura në dokumentet bazë për organizimin e mësimin në kushtet e pandemisë, analiza e e raporteve për mbarëvajtjen e procesit mësimor në këto kushte, si dhe nga pikëpamjet e respondentëve të përfshirë në këtë studim, rezulton se këto dokumente nuk kanë mbuluar mjaftueshëm disa nga nevojat bazë të komunitetit të shkollave, si dhe disa masa të vendosura në këto dokumente nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në kohën e përcaktuar, duke filluar nga vetë MASHTI si promovues i këtyre masave.

Përfundimet dhe rekomandimet lidhur me temat e trajtuara në kuadër të këtij studimi, pasqyrohen si në vijim.

11.1 PËRFUNDIMET

Organizimi i mësimin në kushtet e pandemisë. Siç është përshkruar në kapitullin e tretë të këtij raporti të studimit, organizimi i mësimin në kushtet e pandemisë, përfshin dy periudha, e para i referohet fazës së parë të pandemisë, periudhës mars-qershor 2020, e cila përfshin periudhën e tretë të mësimin në kuadër të vitit shkollor 2019-2020, ndërsa e dyta i referohet vitit shkollor 2020-2020.

Sistemi i arsimit në Kosovë, nuk ishte i përgatitur për organizimin e mësimin digjital në kushte të jashtëzakonshme, siç ishte pandemia, por as në rrethana normale të mësimin për të mbajtur mësim digjital.

Referuar gjetjeve kryesore lidhur me organizimin e mësimin në fazën e parë të pandemisë Covid-19, shihet se i gjithë organizimi i mësimin në këtë fazë është bërë përmes mësimin në distancë. Kjo formë e mësimin përfshiu transmetimin e video-ligjëratave në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK) dhe kanalit të MASHTI-t në YouTube (fillimisht për nivelin fillor klasat 1-5 dhe pastaj edhe për nivelin e dytë klasat 6-9) dhe punës së më-

simdhënësve dhe nxënësve nga shtëpia, për detyra dhe mësim shtesë. Ndërkaq, për nivelin e mesëm të lartë, klasat 10-12 (gjimnazet dhe shkollat profesionale), organizimi i mësimin në distancë ishte lënë në përgjegjësi të komunave.

Në këtë drejtim, krahas videove të transmetuara, mësimdhënësit shfrytëzuan platforma të ndryshme elektronike siç janë ZOOM, Skype, Viber, Google Meet dhe Google Classroom, për të ndarë detyrat e shtëpisë, mësim të reja dhe materialet mësimore.

Organizimi i mësimin në vitin e ri shkollor 2020-2021 ka filluar në mbështetje të Master Planit për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës dhe Udhëzuesit të përgjithshëm të MASH-TI-it për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19 me kufizime. Këto përfshijnë maskat mbrojtëse, matjen e temperaturës, dezinfektimin e duarve dhe mjediseve, si dhe distanca fizike. Viti shkollor filloi me dy javë vonesë, ndërsa organizimi i procesit mësimor bëhet në varësi nga situata epidemiologjike në vend dhe kushtet specifike të institucioneve arsimore, gjithnjë në bazë të tre skenarëve të mësimin: Skenari A – mësim në shkollë; Skenari B – mësim i kombinuar (në shkollë dhe distancë) dhe Skenari C – mësim në distancë.

Organizimi i mësimin në kushte pandemie vazhdon të përcillet me sfida të shumta, si për mësimdhënësit ashtu edhe për prindërit, nxënësit dhe komunitetin arsimor në përgjithësi. Për nevoja të mësimin sipas skenarëve B dhe C, organizimi i procesit mësimor në kushte pandemie, vazhdon të mos jetë i unifikuar në nivel vendi, ku komunat dhe shkollat, përkatësisht mësimdhënësit, shfrytëzojnë platforma dhe qasje të ndryshme të mësimdhënies dhe vlerësimit të nxënësve, në mungesë të një platforme në shkallë vendi. e-Mësimi është një mundësi për të unifikuar mësimin sipas skenarëve online të mësimin, por që nuk raportohet se i shërben mjaftueshëm nevojave për organizimin e mësimin online nga ana e mësimdhënësve.

Kthimi në shkollë dhe zbatimi i kurrikulës në rrethanat e organizimit të mësimin gjatë pandemisë. Kthimi në shkollë është përcjellë me rritje të rasteve me infektive nga virusi, mungesë të qëndrueshmërisë politike në shkallë vendi, përgatitje jo të mjaftueshme dhe të kohshme, përkushtim dhe angazhim institucional të pamjaftueshëm për përgjigje dhe vendimmarrje të duhur në rrethanat e krijuara, të cilat janë tepër kritike dhe të ndjeshme.

Kthimi në shkollë i nxënësve, personelit mësimdhënës, menaxhues dhe akterëve tjerë, ashtu si edhe në vendet e tjera, edhe në Kosovë u bë me frikë dhe shqetësim nga virusi dhe përhapja e infeksioneve. Kujdesi për mirëqenien e fëmijëve dhe të personelit shkollor gjatë pandemisë ishte parim pune, masë preventive dhe parimi kryesor për vazhdimin e mësimin në shkollë.

Kthimi në shkollë përshkruhet me dallime nga shkolla në shkollë, nga komuna në komunë, në mënyrën e organizimit të mësimin, kohës mësimore, adaptimin me këtë qasje të organizimit të mësimin, nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies, përballjes me sfida në organizimin e mësimin, etj.

Kthimi në shkollë nuk përcillet me masat e përcaktuara me Master Planin për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës dhe Udhëzuesin e përgjithshëm të MASH-TI-it për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë Covid-19. Problemet e shfaqura me gjetjen e zëvendësimeve të mësimdhënësve të infektuar gjatë kësaj periudhe me virus dhe shkurtimet nga buxheti i aprovuar për vitin 2021 janë vetëm disa nga ikjet përtej planifikimeve për kthimin në shkollë.

Zbatimi i kurrikulës në kushte pandemie. Ashtu siç ka ndryshuar rutinën e organizimit të punës së shkollës, Covid-19 ka ndryshuar edhe mënyrën e punës së mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollë dhe gjatë mësimit në distancë, duke krijuar një rutinë të re në përpjekje për të përmbushur pritshmëritë në mësim të përcaktuara me dokumentet kurrikulare.

Shkollat lidhur me zbatimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë kanë marrë vetëm Udhëzuesin e përgjithshëm të MASHTI-it për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020-2021 - në kushtet e pandemisë Covid19, dhe planifikimet vjetore dhe për periudha mësimore (për lëndë dhe fusha kurrikulare) nga grupet profesionale të DKA së Prishtinës. Referuar dokumenteve e raporteve nga MASHTI, planifikimi i përmbajtjes programore për t'u realizuar për vitin shkollor 2020-2021, për klasat 1-9 është paraparë të jetë 75%, pra është i reduktuar për 25%.

Realizimi i planifikimeve mësimore është përshkruar si një proces mjaft sfidues, për shkak të mospërshtatjes me specifikat dhe mundësitë e shkollave të tjera për ta realizuar atë, por edhe për shkak të skenarëve me të cilët shkollat janë detyruar të punojnë kur kanë pasur raste të infektiveve.

Mësimi me dy ndërrime për një paralele të nxënësve, me një orar 25-30 minuta për orë mësimi, ishte sfidë në vete, sepse siç përshkruhet nga përfaqësuesit e shkollave pjesëmarrës në këtë hulumtim, më shumë shpejtohej me realizimin e programit zyrtar, ndërsa nxënësit në masë të madhe nuk kanë arritur të marrin sasinë e duhur të mësimave, kjo edhe për faktin se për shkak të kushteve të pandemisë nuk ka pasur ndërveprim të mjaftueshëm në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve.

Mungesa e mbështetjes sistemore për zbatimin e kurrikulës së re, është reflektuar në masë të madhe si një problem në vete, i cili ka ndikuar që mësimdhënësit dhe shkollat të ndihen të vetmuar në këtë proces, si dhe të këtë paqartësi në mesin e mësimdhënësve dhe shkollave lidhur me zbatimin e kurrikulës në kushtet e pandemisë. Kjo është vështirësuar edhe me mungesën e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore.

Humbjet mësimore. Pandemia Covid-19 pritet të ketë ndikim domethënës në performancën e nxënësve, humbjet mësimore dhe në krijimin e pabarazive në mësim. Në nivel të institucioneve arsimore akoma nuk është bërë ndonjë studim i veçantë, i cili do të ishte si një pikënisje për të parë nivelin e humbjeve mësimore, ndërmarrjen e masave për evitimin e pasojave dhe përkrahjen e nxënësve në kompensimin e humbjeve mësimore.

Në raport me skenarët e mësimit më të cilët kanë punuar shkollat, pritet të reflektohen edhe nivelet dhe shkallët e humbjeve mësimore. Nëse marrim për bazë punën e shkollave me orar të shkurtuar të orëve mësimore, për punë me dy ndërrime me klasë të njëjta, ku orët mësimore janë mbajtur max. 25-30 min. i bie që rreth 33% pritet të reflektohen humbjet mësimore në raport me kohën mësimore sipas orarit mësimor. Kjo kohë mësimore më pak, mund të jetë mbuluar te pjesa e angazhimit individual të nxënësve, pasi që grupet e klasave kanë qenë nga 15-20 nxënës, si dhe në bazë të mjedisit të nxënësve të krijuar nga shkolla/mësimdhënësit dhe familja. Për këtë nevojitet një studim i veçantë.

Aktualisht nuk është zhvilluar një sistem i veçantë i raportimit dhe monitorimit përmes së cilit do të mund të përcaktohej një shkallë e përafërt e humbjeve mësimore, pra ende nuk dihet me saktësi se sa janë ato në gjithë sistemin arsimor. Në mungesë të një sistemi standard për matjen e humbjeve, edhe mbështetja eventuale është me rrezik të jetë *ad hoc* dhe jo e bazuar në nevojat e nxënësve. Fillimi i mësimit plotësues, mund të jetë një pikënisje për të parë humbjet mësimore.

Përfshirja e fëmijëve nga grupet e cenueshme. Pandemia Covid-19 dhe sfidat e përcjella kanë prekur të gjithë fëmijët, e më së shumti fëmijët nga grupet e cenueshme, përfshirë fëmijët me status të ulët socio-ekonomik, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore si dhe fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Gjetjet kryesore tregojnë se fëmijët nga grupet e marginalizuara janë ballafaquar me mungesën e pajisjeve të TI për nxënës, (ku shumë familje nga grupet e marginalizuara nuk kanë asnjë laptop, tablet ose kompjuter, e shpesh disa fëmijë të një familje e kanë poseduar vetëm një telefon të mençur në dispozicion për rastet e mësimin në distancë), njëkohësisht ata janë ballafaquar edhe me shqetësim e stres, kryesisht për shkak të pamundësisë teknike. Nuk ka të zhvilluar një politikë të veçantë për të shmangur thellimin e pabarazive arsimore gjatë pandemisë.

Zhvillimi profesional i mësimit gjatë pandemisë. Pandemia sheshoi edhe dukurinë sesi trajnimet dhe kurset e deritashme janë ndjekur shumë formalisht nga ana e mësimit. Kjo ka ndodhur edhe me trajnimin për ECDL ku mijëra mësimit e kanë ndjekur por asnjëherë nuk është vlerësuar kompetenca e tyre, sikurse ndodh edhe me trajnimet tjera.

Programet e trajnimit të menaxhuara nga MASHTI (si trajnimi për zbatimin e kurrikulës dhe trajnimi për udhëheqje arsimore) janë ofruar në shkolla/qendra të trajnimit, ndërsa trajnimet dhe format tjera të zhvillimit profesional të ofruara nga partnerët dhe OJQ-të kryesisht janë mbajtur online.

Përveç Udhëzuesit të përgjithshëm, duket se nuk ka ndonjë plan të detajuar për trajnimin e mësimit gjatë pandemisë, i cili do të duhet të ishte ndarë me DKA-të dhe institucionet tjera arsimore e organizata që merren me ZHPM.

Nga të dhënat e mbledhura për ZHPM në kohë pandemie, shihet se nuk ka një sistem të raportimit të bazuar në indikatorët matës, përmes të cilit do të mund të zhvillohen raporte të detajuara për përfshirjen e mësimit gjatë pandemisë në trajnime sipas komunave dhe shkollave, programet e ndjekura, ofruesit e programeve, etj. Nuk janë evidentuar veprime domethënëse për mbështetjen e të gjithë mësimit gjatë pandemisë në kohën e sfidave të shumta, në anën tjetër ngarkesat e mësimit gjatë pandemisë janë shtuar tej mase gjatë mësimin në kushtet e pandemisë.

Mësimi në kushte pandemie dhe roli i prindërve. Në përgjithësi, sistemi nuk ofron udhëzime dhe mbështetje të veçantë për prindër, lidhur me qasjet që duhet praktikojnë në punën me fëmijët e tyre në kushtet e pandemisë. Po ashtu nuk janë zhvilluar udhëzues të veçantë për prindër, video-incizime, si dhe nuk është krijuar një link i veçantë në faqen zyrtare të MASHTI-it ku prindërit do të kishin qasje më të lehtë, do të përdorej nga shkollat dhe prindërit për të ndërtuar një partneritet më të qëndrueshëm dhe përkrahje reciproke në kushtet e pandemisë. Mbështetja e prindërve kryesisht është realizuar nga vetë shkollat, diku-diku me mbështetjen e komunave përmes platformave mësimore, në mënyrën se si kanë mundur të organizohen dhe të ndihmojnë vetë prindërit, pa ndonjë ndihmë të veçantë nga sistemi.

Monitorimi i arsimit parauniversitar dhe raportimi gjatë pandemisë. Inspektorati i Arsimit në bazë të përgjegjësisë ligjore që ka, edhe në kushtet e organizimit të mësimin, ishte mekanizimi kryesor për monitorim dhe inspektim në arsimin parauniversitar, i cili i kryen detyrat përmes inspektimit të përgjithshëm, tematik, emergjent, ri-inspektimit si dhe inspektimit të cilësisë.

Bazuar në tri prioritetet e përcaktuara me udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollosor 2020-2021 dhe respondentët e përfshirë në këtë studim, fokusi kryesor i monitorimit dhe inspektimit në arsimin parauniversitar, vihet tek aspektet logjistike dhe organizative, jo në përmbajtjen e procesit mësimor, qasjet në mësimin dhe cilësinë e mësimin në kushtet e pandemisë, etj.

Në mungesë të indikatorëve matës të raportimit, nga raportet aktuale të Inspektoratit të Arsimit, është vështirë të nxirren përfundime për cilësinë e mësimin në kushte të pandemisë. Për më shumë, një format i tillë i raportimit nuk është kërkuar as me Udhëzuesin e përgjithshëm për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021, kapitullin e gjashtë: Monitorimi dhe Inspektimi.

Përmbledhje e sfidave në përballje me pandeminë Covid 19. Pandemia Covid-19 vazhdon të sfidojë sistemet arsimore, duke ndryshuar rutinën e organizimit të procesit mësimor dhe të organizimit të punës së institucioneve arsimore, duke rritur shkallën e ngarkesës së komunitetit arsimor, përfshirë mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit, dhe njëkohësisht duke ndikuar në thellimin e pabarazive në arsim.

Në kontekstin e Kosovës, vetë mënyrat e organizimit të mësimin në kushte pandemie, si mësimi në shkollë në kushtet e pandemisë, mësimi i kombinuar apo mësimi në distancë, u përcoll me sfida të shumta, si për mësimdhënësit ashtu edhe për prindërit, nxënësit dhe komunitetin arsimor në përgjithësi. Vlerësohet se e gjithë energjia gjatë përballjes me pandeminë është përqendruar në organizimin e procesit mësimor, pjesëmarrjen fizike në shkollë, realizimin e programeve mësimore, ndërkaq, shumë pak është ofruar këshillim dhe mbështetje emocionale për fëmijët gjatë kësaj periudhe.

Disa nga sfidat më të mëdha me të cilat është përballur arsimit parauniversitar gjatë pandemisë, janë si në vijim:

- Aftësia për të trajtuar problemet ekzistuese në sistemin arsimor, siç është pjesëmarrja e ulët në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara, kapacitetet e limituara të udhëheqësisë në zbatimin e reformave përmes një qasjeje të koordinuar dhe koherente, mungesa e llogaridhënies, mos-zbatimi i autonomisë së shkollës, cilësia e mësimdhënies, kapacitetet e limituara për implementimin e kurrikulës së re etj.
- Niveli i përgatitjes së sistemit dhe shoqërisë për ballafaqim me situata të jashtëzakonshme, siç është pandemia, mungesa e kompetencave dhe teknologjisë digjitale, mungesa e një platforme të standardizuar për mësim në distancë dhe e materialeve mësimore digjitale të bazuara në kurrikulën shtetërore, vazhdojnë të jenë sfida me të cilat përballlet arsimit parauniversitar në Kosovë.
- Fillimi i vitit të ri shkollor në kushtet e kufizimeve prej pandemisë - me maska, matje temperature, dezinfektim, distancim fizik bazuar në protokollin përkatës. Vet procesi i organizimit të mësimin në kushte pandemie, me tre skenarë të mësimin, pa përgatitje të mjaftueshme për reagime strukturore ndaj cilit do skenar të mësimin, si dhe rreziku i vazhdueshëm nga infeksioni, ishte sfidë në vete.
- Menaxhimi i situatës me personel gjatë pandemisë. Zëvendësimi i personelit arsimor i cili gjatë kësaj kohe ka qenë i infektuar me Covid-19. Pamundësia për mbulueshmërinë e orëve mësimore në rastet kur ka pasur mësimdhënësit të cilët kanë qenë të infektuar me Covid-19.
- Cilësia e mësimdhënies dhe e mjedisëve të nxënimit në raport me skenarët e organizimit të mësimin, puna me orar mësimor të reduktuar, në kohëzgjatje 25-30 minuta, ndarja e nxënësve në dy grupe, cilësia e punës së mësimdhënësve me grupet e dyta të së njëjtës klasë, puna e mësimdhënësve me nxënës në skenarët e mësimin B/C.
- Mungesa e një mekanizmi institucional qendror që merret me digjitalizimin e arsimit, me fokusin e veprimtarisë në përgatitjen dhe mbështetjen e sistemit me platformë digjitale të arsimit, burime e materiale mësimore digjitale, zhvillim të kompetencës digjitale, ofrim të shërbimeve digjitale, etj.

- Përshtatja e mjediseve të të nxëniet në kushtet e pandemisë në funksion të zhvillimit të kompetencave, gjetja e modaliteteve përkrahëse për nxënës për të siguruar një kalim të lehtë të mësimin në mjedise të ndryshme të nxëniet, nga një skenar i mësimin në një skenar tjetër të mësimin;
- Përgjigja në kohë dhe në mënyrën e duhur ndaj nevojave dhe kërkesave të grupeve të marginalizuara me masa mbështetëse për të siguruar qasje dhe përfshirje aktive në procesin e të nxëniet, kompensim të humbjeve mësimore dhe parandalim të pabarazive në arsim, si tendencë në rritje që mund të ndikojë edhe në shkallën e analfabetizmit funksional;
- Mungesa e një sistemi mbështetës për prindër/kujdestarë, për të ofruar udhëzime dhe orientime për prindër/kujdestar se si t'i qasen punës me fëmijët e tyre në aspektet psikologjike, pedagogjike, metodike, gjatë orarit mësimor në shtëpi, përkrahjes gjatë mësimin për të siguruar informacione dhe materiale mësimore, mbrojtje nga rreziqet e internetit gjatë mësimin online, etj.
- Shërbime jo të mjaftueshme psikologjike në shkolla, për përgjigje të nevojave e kërkesave të shpërfaqura nga pandemia, siç është ngarkesa e nxënësve, mësimdhënësve, prindërve, etj.
- Mungesa e sistemit të raportimit për ZHPM të bazuar në indikatorët matës, përmes të cilit do të mund të zhvillohen raporte të detajuara për përfshirjen e mësimdhënësve në trajnime sipas komunave dhe shkollave, programet e ndjekura, ofruesit e programeve, përfshirja në programet e trajnimit për mësim online, apo në fushat e kompetencave digjitale për mësimdhënës, etj.
- Mungesa e një kornize të monitorimit të institucioneve arsimore për procesin e mësimin në kushtet e pandemisë dhe raportimit, përmes së cilës do të mund të raportohet me indikatorë matës, të cilët do të mund të krahasoheshin dhe do të mund të përgatiteshin raporte në shkallë vendi për indikatorë të caktuar, duke përfshirë edhe përfshirjen e grupeve të cënueshme në mësim, humbjet mësimore, etj.
- Kapacitetet e pamjaftueshme për monitorimin e procesit mësimor në kohë pandemie. Vendosi e fokusit kryesor e të gjithë mekanizmave mbështetës në aspektet logjistike dhe organizative, largimi nga përmbajtja e procesit mësimor, qasjet në mësimdhënie dhe cilësinë e mësimin në kushtet e pandemisë.

Mundësitë që duhet shfrytëzuar në përgjigje më të mirë rrethanave të krijuara nga Covid-19. Organizimi i mësimin në kushtet e pandemisë, veçanërisht organizimi i mësimin në distancë, përveç sfidave, u vlerësua se përbën një mundësi të mirë për të kuptuar rëndësinë dhe përparësinë e shfrytëzimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe përfshirjen e mësimin online në arsimin parauniversitar të Kosovës.

Pandemia shihet si mundësi për të reflektuar, për të vendosur dhe për të vepruar, me një qasje tjetër, drejt ndryshimeve që do të adresonin problemet afatgjata të sistemit arsimor në Kosovë, përfshirë udhëheqësia, llogaridhënia në arsimin parauniversitar, edukimi në fëmijërinë e hershme dhe gjithëpërfshirja në arsim, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, cilësia e mësimdhënies, menaxhimi i cilësisë në arsimin parauniversitar etj.

Zhvillimi i kuadrit të masave për ngritjen e arsimit parauniversitar, bazuar në dokumentet e organizatave ndërkombëtare që merren me zhvillimet në arsim, po ashtu përbën një mundësi që duhet shfrytëzuar, bazuar në kontekstin dhe nevojat e sistemit tonë arsimor. Një mundësi e tillë ishte edhe referimi në raportet e institucione-

ve e organizatave ndërkombëtare prestigjioze, siç janë për shembull dokumentet e zhvilluara nga UNICEF dhe raportet e Bankës Botërore që pasqyrojnë vlerësime për ndikimin e Covid-19 mbi arsimin dhe orientime për ndërmarrjen e masave nga sistemet arsimore në nivel politikash arsimore për të zbutur ndikimin e pandemisë.

Vetë mësimet e dala nga kjo përvojë e organizimit të sistemit arsimor në përgjigje ndaj rrethanave të krijuara, janë një mundësi e mirë për të mësuar më shumë për përparësitë e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie, për modalitetin e mësimin në distancë, dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe integrimin e mësimin online në sistemin arsimor të Kosovës. Përvoja me pandeminë krijoi mundësi për të vendosur kuadrin e orientimeve dhe fokusit të reformës në të ardhmen, me qëllim ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar. Pandemia ka përshpejtuar proceset e integritit të teknologjisë në sistemet arsimore, duke ofruar mundësi të reja për qasje ndryshe në procesin mësimor.

11.2 REKOMANDIMET

Të gjitha mundësitë e identifikuar duhet të kthehen në masa dhe veprime konkrete nga institucionet arsimore për përgjigje më të mirë rrethanave të krijuara nga Covid-19. Në anën tjetër, disa nga rekomandimet më specifike, bazuar në sfidat dhe nevojat për adresimin e tyre, si dhe në mundësitë që duhet shfrytëzuar, janë si në vijim:

- MASHTI duhet të rishikojë dhe përmirësojë mekanizmat e këshillimit dhe mbështetjes së shkollave, si dhe duhet të vendos një mekanizëm institucional në nivel qendror që merret me digjitalizimin e arsimit, pedagogjinë digjitale, planifikimin, monitorimin dhe raportimet që lidhen me progresin në digjitalizimin e arsimit;
- MASHTI dhe organet përkatëse duhet të trajtojnë urgjentisht mangësitë në sistemin arsimor, të cilat janë anashkaluar me vite dhe kanë dalë në pah gjatë pandemisë. Ndryshimet kritike që duhen adresuar përfshijnë përmirësimin e shërbimeve arsimore në fëmijërinë e hershme, ngritja e një sistemi të llogaridhënies në të gjitha nivelet, fuqizimi i autonomisë së shkollës - përfshirë autonominë financiare, implementimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve, ngritja e kompetencave profesionale me qëllim të jetësimit të kurrikulës, hartimi i teksteve shkollore cilësore të përshtatura me kurrikulën etj.
- Koordinimi ndërmjet mekanizmave që kanë rol në arsimin parauniversitar duhet të fuqizohet në mënyrë që kapacitetet ekzistuese të shfrytëzohen në mënyrë efektive për adresimin e sfidave, pasojave të shkaktuara nga pandemia dhe për udhëheqjen e përmirësimit në arsimin parauniversitar. Në këtë kuadër, rformatizimi i Inspektoratit të Arsimit duhet të jetë prioritet, duke marrë parasysh rolin e tij në sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar.
- MASHTI duhet të dinamizojë veprimet institucionale për miratimin dhe zbatimin e strategjisë digjitale në arsim, duke vendosur të gjitha masat për të investuar në digjitalizimin e arsimit në mënyrë të strukturuar, të koordinuar dhe me fokus në të veçantë në ngritjen kompetencave digjitale tek komuniteti arsimor;
- Mbështetja profesionale për mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit për të zhvilluar kompetencën digjitale, duhet të jetë prioritet i veçantë, për të mundësuar përgatitjen më të mirë për zhvillimin e mësimin digjital në kushte normale të organizimit të procesit mësimor.
- MASHTI duhet të priorizojë punën me DKA dhe Shkollat në adresimin e humbjeve mësimore, për një periudhë më të gjatë. Tashmë është e qartë se humbjet mësimore të shkaktuara nga ndikimi i pandemisë

janë evidente dhe mund të shkojnë drejt rritjes dhe thellimit të pabarazive në arsim. Për të parandaluar humbjet e mëtejshme mësimore dhe për të mbështetur përmirësimet, duhet të zhvillohet një mekanizëm efektiv dhe i përshtatshëm në ndihmë shkollave për identifikimin e shkallëve të humbjeve mësimore, duke marrë për bazë edhe mjedisin e të nxënësve dhe mundësitë e zhvillimit. Për këtë nevojiten plane dhe veprime konkrete, koordinim institucional dhe përmirësim të financimit në arsimin parauniversitar për të ofruar punë shtesë për nxënës në kompensimin e humbjeve mësimore dhe mbështetje institucionale afatgjate.

- MASHTI duhet të përmirësojë sistemin për menaxhimin e informatave, duke përfshirë menaxhimin e informatave për zhvillimin profesional të mësimit dhe monitorimin e arsimit parauniversitar, duke vendosur indikatorë matës, të cilët ofrojnë mundësi për analiza krahasuese dhe nxjerrje të vendimeve të bazuara në të dhëna.
- Me qëllim të bashkërendimit të masave dhe veprimeve në situata e rrethana të jashtëzakonshme, dhe me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në përgjigje të rrethanave të pandemisë, duhet të rritet bashkëpunimi institucional e rajonal dhe më gjerë.
- DKA-ve u rekomandohet që të bëjnë një analizë të kontekstit të organizimit të mësimin në nivel të komunës, në kushtet e pandemisë, nevojave të komunitetit të shkollave dhe mbi bazën e nevojave reale të zhvillojë një plan të veçantë dhe të punojnë së bashku me shkollat në adresimin e të gjitha problemeve të shpërfaqura nga pandemia. DKA-të duhet të kenë në fokus të veçantë pajisjen e shkollave me mjete të TIK-ut, sigurimin e qasjes së shkollave me internet të qëndrueshëm, ngritjen e kapaciteteve të mësimit në kompetencat digjitale etj. Në këtë mënyrë ato mbështesin shkollat në zbatimin e autonomisë së tyre, përfshirë menaxhimin e financave të veta, aktivizimin e organeve të shkollës që përfshijnë prindërit dhe nxënësit etj.
- Institucionet arsimore/shkollat, në dritën e pritshmërive për punën e tyre, rekomandohen që ta analizojnë punën e bërë gjatë pandemisë, arritjet, sfidat dhe problemet me të cilat janë ballafaquar, si dhe mundësitë reale që mund t'i shfrytëzojnë për riorganizimin e punës së tyre, shfrytëzimin e plotë dhe efikas të autonomisë së shkollës, udhëheqjen e proceseve në nivel institucioni/shkolle, si dhe të vendosin agjendë të qartë për maksimizimin e veprimeve për punën me nxënës dhe përkrahjen e tyre për kompensimin e humbjeve mësimore, përfshirë ngritjen e kompetencave digjitale në mësimdhënie. Institucionet arsimore/Shkollat duhet t'u kushtojnë kujdes të veçantë fëmijëve që vijnë nga grupet e cënueshme për të cilët kërkohet qasje individuale në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta dhe të adresohen dallimet në mes të fëmijëve në arritjen e rezultateve të të nxënësve të parapara me programet mësimore.
- Sistemi ka nevojë për më shumë përgjegjësi dhe llogaridhënie, si dhe për bashkim sinergjik për ta përmirësuar cilësinë e sistemit arsimor. Zhvillimi i pandemisë në muajt e ardhshëm është i vështirë të parashikohet. Situatat emergjente siç ishte pandemia COVID 19 mund të ndodhin edhe në të ardhmen, prandaj nga kjo duhet të nxirren mësim me qëllim të ballafaqimit më të lehtë të situatave të papritura, duke marrë veprime të mirë harmonizuara për përgjigje efektive ndaj situatave të tilla.

REFERENCAT

Banka Botërore (2020). Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Vlerësim i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundër përgjigjja e vendeve. <https://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>

COVID-19 DHE FEMIJËT: Pandemia globale si ndryshojë jetën e fëmijëve në Shqipëri & Kosovë <https://www.coe.int/en/web/education/responses-from-schools#%7B%2264139460%22%3A%5B%5D%2C%2264139546%22%3A%5B%5D%7D>

Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) Zyra Rajonale për Evropën dhe Azinë Qendrore (2020). Ngritja e Sistemeve Arsimore të Qëndrueshme pas Pandemisë COVID-19: Konsiderata për vendimmarrësit e institucioneve arsimore në nivel kombëtar, vendor dhe shkolle. [https://www.unicef.org/albania/media/3116/file/ECAR%20guidelines%20FOR%20EDUCATION%20PROVISION%20\(ALB\)%20.pdf](https://www.unicef.org/albania/media/3116/file/ECAR%20guidelines%20FOR%20EDUCATION%20PROVISION%20(ALB)%20.pdf)

Implikimet e koronavirusit të ri (COVID-19) në arsim dhe trajnime: Gjendja në shtetet anëtare (Implications of the novel coronavirus (COVID-19) on education and training: State-of-play in Member States), Presidencia Kroate e Këshillit të Bashkimit Evropian, Versioni i 9-të i 31.03.2020.

Instituti Pedagogjik i Kosovës (2020). Mësimi në distancë/e-mësimi në arsimin parauniversitar në Kosovë, në rrethanat e krijuara nga pandemia COVID – 19. IPK, Prishtinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr.04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

Marsh, J. Colin. (2009). Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin. Botimi i katërt në shqip, Tiranë, Qendra për Arsim Demokratik.

Mattheës, B./ Ross, L (2010): METODAT E HULUMTIMIT. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Qendra për Arsim Demokratik (CDE). Tiranë.

Mehmeti, S. (autor), Rraci, E. & Bajrami, K. (2019). Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve në Kosovë. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN. http://www.keen-ks.net/site/assets/files/1467/zhvillimi_profesional_i_mesimdhenesve_ne_kosove_alb-1.pdf

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2020). Master plani për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2020). Udhëzues i përgjithshëm i MASH për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë COVID 19. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezuesi-final-file-10-09-2020.pdf>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2020). Udhëzues për qasjen dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta për vitin shkollor 2020-2021. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2020_01). Udhëzues për vlerësimin e nxënësve në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e pandemisë COVID 19. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/10/udhezuesi-per-vleresim-2020_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimin në distancë. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për drejtoritë komunale të arsimit për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta (SHML). https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për DKA për realizimin e mësimin online për shkollat e mesme të larta profesionale (SHML) dhe Qendrat e Kompetencës. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Përdorimi i platformës Zoom – Zoom – us. https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezues-per-zoom-mashti_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Qendrat Burimore për realizimin e mësimin në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Vendimi 25/01B për procedurat realizimit të vlerësimin të nxënësve gjatë mësimin në distancë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/vendim-procedurat-e-realizimit-te-vleresimit-te-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance-ne-te-gjitha-nivelet-e-arsimit-parauniversitar-ne-kosove-24042020.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (2020). Master plani për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës. <https://masht.rks-gov.net/e-mesimi>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Udhërrëfytyesi për zbatimin e kurrikulës 2016-2021, Prishtinë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/udherrefyfyesi-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2017). Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë. MASHT. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf>

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.(2016). Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar). Prishtinë.

Motivimi i fëmijëve gjatë mësimin nga shtëpia, UNESCO 2020, <https://en.unesco.org/news/resources-parents-and-teachers-motivating-supporting-children-during-remote-learning>

Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit. (prill 2021). Raporti për Arsimin Parauniversitar për periudhën Shtator 2020 – Prill 2021. Raport i pabotuar.

Qeveria e Republikës së Kosovës (11 mars 2020). Vendim për ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet, <https://kryeministri-ks.net/dokumente/page/3/>

Udhëzues mbi mësimin në distancë & COVID19, versioni i 7 prillit 2020, Banka Botërore <http://documents.worldbank.org/curated/en/531681585957264427/pdf/Guidance-Note-on-Remote-Learning-and-COVID-19.pdf>

Udhëzuesi mbi përgjigjen emergjente: Televizioni Edukativ & COVID0-19, versioni i 17 prillit 2020, Banka Botërore <http://documents.worldbank.org/curated/en/659411587145759242/pdf/Rapid-Response-Guidance-Note-Educational-Television-COVID-19.pdf>

UNICEF (2020a). Manuali i Mësuesve të Platformës ‘LearnIn’ për të Nxënëit gjatë Emergjencave - Krijimi i mënyrave të personalizuara të të nxënëit për nxënësit. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-3-krijimi-i-menyrave-te-personalizuara-te-te-nxenit.pdf>

UNICEF (2020b). Manuali i Mësuesve të Platformës ‘LearnIn’ për të Nxënëit gjatë Emergjencave - Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-2-mirepritja-e-nxenesve-serishe-shkolle.pdf>

UNICEF (2020c). Manuali i Mësuesve të Platformës ‘LearnIn’ për të Nxënëit gjatë Emergjencave - Mbështetja e nxënësve gjatë izolimit në shtëpi. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-1-mbeshtetja-e-nxenesve-gjate-izolimit-ne-shtepi.pdf>

Yllka Komani Nuqi. (2021). Ndikimet e COVID-19 në motivimin për punë, stresin dhe konsumimin të edukatorëve në institucionet e edukimit të hershëm. Ekspoze e temës së masterit në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës. <https://drive.google.com/file/d/1qVQBmHgV9y93-pn-H8lmgQNzZbnjUd7Z/view>

Zamira Hyseni Duraku & Mirjeta Nagavci (2020). Ndikimi i pandemisë COVID-19 në edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar.

Gentiola Madhi dhe Francesco Trupia (2021). Reformimi apo rikonceptualizimi i arsimit postpandemik në Ballkanin Perëndimor - Analizë për Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë. Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, KFOS. <https://kfos.org/storage/app/uploads/public/604/08b/814/60408b8146acd816019318.pdf>

Manninen, J. (2014). Evaluation report: Qualitative stakeholder evaluation of the first year of implementation of në Kosovo curriculum. Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE dhe menaxhuar nga zyra e BE-së në Kosovë.

Qendra për Arsim e Kosovës. (2021). Arsimi në Kosovë gjatë pandemisë COVID-19. EDITORIAL. http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2021/04/Editorial_Arsimi-n%C3%AB-Kosov%C3%AB-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-COVID-19-FINAL.pdf

Bardha Qirezi (15.04.2020). Mbajtja në jetë e sistemit arsimor: Si po zhvillohet mësimi online në kohë pandemie? <https://d4d-ks.org/editorial/mbajtja-ne-jete-e-sistemit-arsimor-si-po-zhvillohet-mesimi-online-ne-kohe-pandemie/>

Shtojca 1: Lista e zyrtarëve arsimor, partnerëve dhe njohësve të arsimit të intervistuar

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni/Organizata	Vendi/Komuna	Pozita	Data
1	Fatos Osmani	MASHTI	Prishtinë	Këshilltar politik në Kabinetin e Ministres së Arsimit	12.05.2021
2	Shqipe Bruqi	MASHTI - DAP	Prishtinë	Zv. e drejtorit të DAP	23.04.2021
3	Lulavere Behluli	MASHTI - Divizioni i Arsimit Gjithëpërfshirës	Prishtinë	Udhëheqëse e Divizionit	21.04.2021
4	Labëri Luzha	MASHTI - Divizioni për edukim parashkollor /	Prishtinë	Udhëheqëse e divizionit për edukim parashkollor	29.04.2021
5	Refik Azemi	Drejtoria Komunale e Arsimit	Mitrovicë	Udhëheqës i Sektorit të Arsimit	20.04.2021
6	Suzana Gjergji	Drejtoria Komunale e Arsimit	Klinë	Zyrtare për arsim	19.4.2021
7	Rexhep Zeka Fatime Pllana	Drejtoria Komunale e Arsimit	Obiliq	Drejtor i DKA Zyrtare për arsim	30.04.2020
8	Flutur Këpuska	Drejtoria Komunale e Arsimit	Gjakovë	Zyrtare për shkolla të mesme të larta dhe Konvikt	23.04.2021
9	Ardiana Ismaili	Drejtoria Komunale e Arsimit	Prishtinë	Zyrtare e lartë për arsim	26.04.2021
10	Teuta Berisha	Drejtoria Komunale e Arsimit	Lipjan	Zyrtare për arsim parafillor- fillor	21.04.2021
11	Rrahman Jasharaj	SBASHK	Prishtinë	Kryetar i SBASHK-ut	20.04.2021
12	Majlinda Mazelliu	British Council Kosova	Prishtinë	Koordinatorë Nacionale e Projektit "Shkollat e Shek. 21"	7 maj 2021
13	Valid Zhubi	Save the Children	Prishtinë	Koordinator i Programit të Edukimit	7 maj 2021
14	Muhamet Arifi	Balkan Sunfloëers Kosova	Prishtinë	Drejtor Ekzekutiv	27.04.2021
15	Ismet Potera	Instituti Pedagogjik i Kosovës	Prishtinë	Hulumtues, shef sektori	29 Prill 2021
16	Haxhere Zylfiu	Instituti Pedagogjik i Kosovës	Prishtinë	Hulumtuese për arsim jo formal	23.04.2021
17	Lindita Boshtrakaj	Konsulente e pavarur	Prishtinë	Konsulente e jashtme për Sigurim të Cilësisë në AAP	27-04-2021
18	Osman Buleshkaj	EU-TPD dhe GIZ CDBE	Prishtinë	Bashkëpunëtor/ekspert i jashtëm	26.04.2021
19	Rinor Qehaja	Instituti EdGuard	Prishtinë	Drejtor Ekzekutiv	25-04-2021
20	Zyla Osmani	SHFMU "Hilmi Rakovica"	Prishtinë	Zëvendës drejtoreshë Kordinatorë e përgjithshme për eMësimin	14.05.2021
21	Besim Mustafa	Oda Ekonomike e Kosovës	Prishtinë	Drejtor i Departamentit për Arsim Profesional	14.05.2021

Shtojca 2: Lista e mësimdhënësve dhe drejtorëve të shkollave pjesëmarrës në fokus grupe dhe intervista me shkrim

Nr.	Emri dhe mbiemri	Niveli i Arsimit	Pozita	Komuna
1	Indira Huruglica	Edukimi parashkollor	Drejtoreshë	Prishtinë
2	Ilirjana Mulliqi	Edukimi parashkollor	Pedagogje	Pejë
3	Berat Bejtullahu	Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	Drejtor	Gjakovë
4	Sedat Shkurti	Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	Drejtor	Prizren
5	Salih Uka	Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	Drejtor	Lipjan
6	Liridon Mulliqi	Gjimnaz	Drejtor	Podujevë
7	Vjollca Jupolli	Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	Drejtoreshë	Prishtinë
8	Fatjona Bislimi	Arsimi fillor	Mësuese klase	Ferizaj
9	Luljeta Rama	Arsimi fillor	Mësuese klase	Mitrovicë
10	Ibe Demolli	Arsimi i mesëm i ulët	Mësimdhënëse	Prishtinë
11	Burim Avdiaj	Arsimi i mesëm i ulët	Mësimdhënës	Deçan
12	Milazim Avdylaj	Arsimi i mesëm i ulët	Mësimdhënës	Prizren
13	Syzana Bytyqi	Gjimnaz	Mësimdhënëse	Drenas
14	Bashkim Hoti	Gjimnaz	Mësimdhënës	Klinë
15	Melihate Zeqiri	Arsimi dhe Aftësimi profesional	Mësimdhënëse	Prishtinë



Funded by
the European Union

